**VENDIM**
**Nr. 466, datë 30.7.2021**

# PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE, *2021–2030*, DHE TË PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT

*(Ndryshuar me VKM nr. 501, datë 10.9.2025; nr. 616, datë 30.7.2026)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Bizneseve dhe Investimeve, ***2021–2030***, dhe të planit të saj të veprimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngritjen e grupit ndërinstitucional për monitorimin e Strategjisë, nën drejtimin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Funksionet, përbërja dhe detyrat e këtij grupi caktohen me urdhër të Kryeministrit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE, ***2021–2030***,
Tiranë, maj 2021

**Përmbajtja**

**Shkurtimet**
I. PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK
1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik
2. Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet strategjike
3. Arritjet, analiza dhe sfidat
Situata e përgjithshme ekonomike
Struktura e ndërmarrjeve dhe sektorëve
Klima e të bërit biznesit dhe mbështetja për NVM-të
Tregu i punës dhe punësimi
Arsimi, formimi dhe aftësitë
Veprimtaria e *startup*-eve dhe inovacionit
Tregtia
Investimet e huaja direkte (IHD)
II. PJESA II. QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT PRIORITARE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË
Politika I
III. PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI
IV. PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE.

1.1 Analiza e buxhetit për zbatimin e SZHBI-së, 2021–2027
ANEKSI 1: FORMATI I PLANIT TË VEPRIMIT I PËRMBLEDHUR

**Shkurtimet**

| | |
|---|---|
| SZHBI | Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve |
| NVM | Ndërmarrje të vogla dhe të mesme |
| IHD | Investime të huaja direkte |
| ERP | Programi i reformave ekonomike |
| AIDA | Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve |
| AKPA | Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim |
| AKKSH | Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit |
| AKSHI | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit |
| GNP | Grupi ndërinstitucional i punës |
| MASR | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë |
| MEPJ | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| MIE | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| MTM | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| NJVV | Njësi e vetëqeverisjes vendore |
| OJF | Organizatë jofitimprurëse |
| QFP | Qendra e Formimit Profesional |
| RSH | Republika e Shqipërisë |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| TKP | Treguesit kryesorë të performancës |
| BDHTI | Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë |

**Përmbajtja e tabelave dhe e grafikëve**

TABELA
Tabela 1. Rritja e PBB-së reale (ndryshimi vjetor në %)
Tabela 2. Treguesit sipas grupit të madhësisë së ndërmarrjeve 2018
Tabela 3. Vlera e shtuar sipas aktivitetit ekonomik 2018
Tabela 4. Pikët dhe renditja në raportin lehtësia e të bërit biznes
Tabela 5. Shërbimet e mbështetjes së biznesit për NVM-të (vlerësimi i Indeksit të Politikave për NVM-të 2019)
Tabela 6. Produktiviteti si PBB për person të punësuar në vitin 2017, PPP konstante në $. Vlera e shtuar sipas aktivitetit ekonomik 2018
Tabela 7. Aftësitë sipërmarrëse (Rezultati i Indeksit të Politikave për NVM-të 2019)
Tabela 8. Pjesë nga Indeksi i Konkurrueshmërisë Globale 2019 - Shqipëria Aftësitë sipërmarrëse (rezultati i indeksit të politikave për NVM-të 2019)
Tabela 9. Eksportet sipas produkteve 2020
Tabela 10. IHD sipas vendit të origjinës (tremujori i tretë)

Tabela 11. Masat në fushën e ndërhyrjes "Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi"
Tabela 12. Masat në fushën e ndërhyrjes "Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni"
Tabela 13. Masat në fushën e ndërhyrjes "Zhvillimi i kapitalit njerëzor"
Tabela 14. Analiza e fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve kyçe
GRAFIKË
Grafiku 1. Pengesat në mjedisin e biznesit (10 më të rëndësishmet)
Grafiku 2. Shkalla e papunësisë (%)
Grafiku 3. Përqindja (%) e punësimeve në profesione që kërkojnë njohuri të thelluara 2018
Grafiku 4. Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve
Grafiku 5. Fluksi i IHD-ve (milionë euro)

I. PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

**1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik**

Bazuar në një qasje koherente dhe të zbatueshme, Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (SZHBI) përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afatmesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si edhe investimet. *Ministria përgjegjëse për ekonominë* me mbështetjen e GIZ Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – ka hartuar një Strategji të re dhe Planin e Veprimit për periudhën 2021–2027, e cila reflekton rekomandimet e Komisionit Evropian në Raportin për Shqipërinë për vitin 2020[1].

Procesi i hartimit të kësaj Strategjie është udhëhequr nga parimet si vijojnë:

**- Bashkëpunimi** – duke përfshirë konsultime të vazhdueshme me palët e interesit;

**- Strategji e bazuar në analizë** – përmes vlerësimit të plotë dhe në përshtatje, sipas nevojave specifike në faza të ndryshme;

**- Vlerësim i përvojës ndërkombëtare** – duke marrë në konsideratë dhe duke integruar praktikën e mirë;

**- Qasje specifike sipas kontekstit** – duke përshtatur strategjinë dhe veprimet me kontekstin specifik të vendit dhe veprimtaritë ekzistuese;

**- Qasje koherente** – duke siguruar një ndërveprim efektiv ndërmjet strategjive, fushave të ndërhyrjes dhe veprimeve të ndryshme;

**- Qasje e zbatueshme** – me fokus mbi masat efektive dhe realiste, duke marrë në konsideratë burimet dhe kapacitetet e disponueshme.

Kjo strategji është përgatitur bazuar në konsultime intensive me palët e interesit dhe ekspertët kryesorë. Tetë takimet me grupet e ekspertëve në periudhën ndërmjet shtatorit dhe nëntorit 2020 krijuan elementin bazë të këtij procesi. Gjithashtu, u zhvilluan më shumë se 25 intervista dhe tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të Grupit Ndërinstitucional të Punës, ministrive, agjencive, akademisë, sektorit privat, partnerët ndërkombëtarë dhe aktorë të tjerë. Përpara ndërprerjes së procesit, si pasojë e mbylljes, shkaktuar nga pandemia COVID-19, *workshop*-i për hartimin e strategjisë i zhvilluar në shkurt 2020, shërbeu për të qartësuar rolin, qëllimin dhe fokusin e SZHBI-së së re, si dhe për të identifikuar objektivat dhe fushat e ndërhyrjes.

Bazuar në konsultimet e mëtejshme me institucionet e përfshira në zbatim, strategjia e re dhe plani përkatës i veprimit janë hartuar në fillim të vitit 2021. Me qëllim zbatimin efektiv të saj, fokusi kryesor ka qenë përcaktimi i përgjegjësive, TKP-ve dhe burimeve të nevojshme.

[1] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania_report_2020.pdf

SZHBI 2021–2027 është në linjë me strategjitë dhe programet gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar, të tilla si Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II 2015–2020[2], Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), Programi i Reformës Ekonomike (ERP)[3], si dhe në nivel ndërkombëtar si Plani i Veprimit për Tregun e Përbashkët 2021–2024 (CRM)[4] për Ballkanin Perëndimor dhe Strategjia e re e BE-së për NVM-të[5]. Kuadri strategjik dhe plani i veprimit i SZHBI-së së re është hartuar me qëllim për të zhvilluar dhe plotësuar masat dhe iniciativat për zbatimin e këtyre strategjive dhe programeve.

Duke marrë parasysh rezultatet e diagnostikimit fillestar, si dhe diskutimet në grupet e punës me ekspertët, *workshop*-in për hartimin e strategjisë dhe intervistat me ekspertë, SZHBI-ja e re është projektuar si një strategji ombrellë e zhvillimit ekonomik kryesisht për NVM-të dhe investimet:

- Duke përcaktuar transformimin strukturor të synuar dhe trajektoren e zhvillimit ekonomik;
- Duke u fokusuar në objektivat e qartë të politikës dhe fushat e ndërhyrjes që trajtojnë mundësitë dhe sfidat kryesore për zhvillim ekonomik;
- Duke krijuar një lidhje qendrore brenda kuadrit strategjik përmes shpalosjes së potencialeve duke ndërlidhur programet dhe planet e veprimit, pa i mbivendosur me ato ekzistuese;
- Duke vendosur theksin në nivelin horizontal dhe kombëtar;
- Duke dhënë udhëzime për strategjitë e ardhshme tematike, rajonale dhe sektoriale përmes zhvillimit të veprimeve prioritare model, që mund të ndërmerren dhe të plotësohen.

Procesi i draftimit të strategjisë u organizuar në 5 faza: 1. Faza përgatitore ku janë zhvilluar konsultime paraprake për metodologjinë e punës dhe formatin e strategjisë, si dhe janë formuar grupet e punës për hartimin e Strategjisë; 2. Analiza e situatës, e cila ka rezultuar me identifikimin e problemeve kryesore në fushën e biznesit dhe investimeve që do të trajtohen nga Strategjia; 3. Përcaktimi i sistemit të objektivave dhe veprimtarive kryesore të Strategjisë; 4. Kostimi i Strategjisë dhe hartimi i planit të zbatimit; dhe 5. Konsultimi publik dhe finalizimi i dokumentit.

**VIZIONI: Një ekonomi shqiptare konkurruese, e nxitur nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe më cilësore, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron transformimi digjital dhe transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, me theksin mbi zhvillimin e qëndrueshëm, integrimin evropian dhe atë rajonal.**

Ky vizion është zbërthyer në një qëllim të politikave: "Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës".

Qëllimi i politikës është zbërthyer në tre objektiva:

- Objektivi specifik 1.1: Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi
- Objektivi specifik 1.2: Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni
- Objektivi specifik 1.3: Zhvillimi i kapitalit njerëzor

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve zbatohet në periudhën 2021–2027, ndërsa roli udhëheqës në zbatimin e saj i takon *Ministrisw përgjegjëse për ekonominë* si institucion përgjegjës për fushën e biznesit dhe investimeve. Përgjegjësia për zbatimin e secilës masë është përcaktuar me planin e veprimit dhe ndahet midis *Ministrisë përgjegjëse*

---

[2] http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim
[3] https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Economic-Reform-Programme-2021-2023.pdf
4 https://www.rcc.int/pages/143/common-regional-market
5 https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-sme-strategy-march-2020_en.pdf

*për ekonominë,* institucioneve të varësisë, pushtetit vendor dhe aktorëve të tjerë. Për shkak të natyrës së masave duhet të ekzistojë një bashkërendim i mirë me nismat e partnerëve për zhvillim të qeverisë, ku bëjnë pjesë donatorët, si dhe organizatat vendëse dhe ndërkombëtare që, në një mënyrë ose tjetër, shprehin gatishmëri për t'i kontribuar në zbatimin e Strategjisë. Kostoja indikative për zbatimin e Strategjisë është 9,605,535,640 lekë.

**2. Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet strategjike**

Qeveria e Shqipërisë prej vitesh tashmë ka vënë në prioritet fuqizimin e kuadrit ligjor dhe institucional, në lidhje me zhvillimin e biznesit dhe investimeve, duke synuar njëkohësisht dhe harmonizimin e këtij kuadri ligjor kombëtar me atë ndërkombëtar, duke mbajtur në konsideratë veçanërisht dy dokumente udhëheqëse: 1. Akti i biznesit të vogël për Evropën (KE 2008); dhe 2) Strategjia e NVM-ve për një Evropë të qëndrueshme dhe digjitale (KE 10 mars 2020).

Akti i biznesit të vogël në Evropë thekson 10 parime kryesore, si vijon:

1. të krijohet një mjedis ku sipërmarrësit dhe bizneset familjare të zhvillohen;
2. të sigurohet që sipërmarrësve të ndershëm që kanë falimentuar t'u jepet pa humbur kohë një shans i dytë;
3. të hartohen rregulla sipas parimit "Në fillim mendo për diçka të vogël"[6];
4. të bëhet administrata publike përgjegjëse për nevojat e NVM-ve;
5. Të miratohen instrumentet e politikave publike për nevojat e NVM-ve: të lehtësohet pjesëmarrja e NVM-ve në prokurimet publike dhe të përdorem më mirë mundësitë që ka shteti për të ndihmuar NVM-të;
6. Të lehtësohen mundësitë e NVM-ve për të siguruar financim dhe të zhvillohet një mjedis ligjor dhe biznesi që të mbështetë pagesat në kohë për transaksionet tregtare;
7. Të ndihmohen NVM-të të përfitojnë më shumë nga mundësitë që ofrohen nga tregu i vetëm;
8. Të promovohet ngritja e aftësive të NVM-ve dhe të gjitha formave të novacionit;
9. Të bëhet e mundur që NVM-të t'i kthejnë sfidat mjedisore në mundësi;
10. Të nxiten dhe mbështeten NVM-të për të përfituar nga rritja e tregjeve.

Ndërkohë, Strategjia e BE-së për NVM-të për një Evropë të qëndrueshme dhe digjitale mbështetet të NVM-të Evropiane përmes forcimit të kapaciteteve të tyre për t'iu përshtatur sfidave të neutralitetit të klimës, për t'i ndihmuar ata të përfitojnë nga proceset e digjitalizimit, të ulin barrën rregullatore me të cilën përballen NVM-të dhe të përmirësojnë mundësitë e tyre për aksesin në financë.

**2.1 Kuadri ligjor kombëtar**

Ndër ligjet kryesore për sa i takon çështjes së nxitjes së biznesit dhe investimeve mund të përmendim:

**Ligji nr. 7764, datë 2.11.1993, "Për investimet e huaja", i ndryshuar**, i cili përcakton rregullat dhe procedurat për tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri.

**Ligji nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë"** dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilat synojnë nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendëse dhe të huaja, në sektorët e ekonomisë, të identifikuar prej këtij ligji si sektorë strategjikë, nëpërmjet vendosjes së procedurave të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përshpejtuese të mbështetjes e të shërbimeve ndaj investitorëve.

**Ligji 8957 datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", i ndryshuar**, i cili ka si objekt rregullimin e masat dhe politikave shtetërore për klasifikimin, nxitjen e krijimit

[6] Parimi "Në fillim mendo për pak" nënkupton se politikbërësit i marrin plotësisht parasysh NVM-të në fazën e hershme të zhvillimit të politikave për të siguruar që zëri i tyre të dëgjohet, që interesat e tyre të marren parasysh prej tyre dhe që mjedisi i biznesit të jetë i favorshëm për zhvillimin e NVM-ve.

dhe të zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Qëllimi i këtij ligji është të ndihmojë ndërmarrjet mikro, e vogla dhe të mesme, nëpërmjet krijimit të një kuadri institucional, rregullator dhe financiar.

**Ligji nr. 9640, datë 9.11.2006, "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrive", i ndryshuar**, i cili ka për objekt përcaktimin e rregullave të organizimit, funksionimit dhe veprimtarisë së Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë.

**Ligji nr. 10303 datë 15.7.2010, "Për krijimin dhe organizimin e Agjencisë Shqiptare për zhvillimin e investimeve"**, i cili rregullon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

**Ligji nr. 54/2015, datë 28.5.2015 "Për disa ndryshime dhe ndryshime në ligjin nr. 9789, datë 19.7.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike",** i cili rregullon krijimin, funksionimin, mbikëqyrjen e zonave ekonomike, të drejtat dhe detyrimet e institucioneve përgjegjëse, të zhvilluesve, operatorëve, përdoruesve, që veprojnë në to, llojin e veprimtarive, që kryhen brenda tyre, si dhe mënyrën e përcaktimit të trojeve e të kufijve.

**Ligji nr. 32, datë 7.6.2018, "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës",** që ka për objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe ka për mision sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare, në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në strategjinë kombetare për diasporën, nëpërmjet promovimit, inkurajimit dhe nxitjes së prirjeve filantropike dhe investimeve në mbështetje të zhvillimit të diasporës në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.

**2.2 Kuadri institucional**

Në Shqipëri ka disa struktura të cilat trajtojnë çështjet e nxitjes së biznesit dhe investimeve.

Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik (DPZHE) në Ministrinë përgjegjëse për ekonominë ka si mision përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional nëpërmjet hartimit të politikave dhe reformave ekonomike në kuadër të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të vendit, në përputhje me programet e Qeverisë, mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014–2020, Strategjinë "Për mbrojtjen e Konsumatoreve dhe Mbikëqyrjen e tregut, 2020", si dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015–2020, MSA, MAP REA etj., duke u fokusuar në çështjet e nxitjes së biznesit, tërheqjen e investimeve të huaja direkte, lehtësimit të tregtisë, të kontrollit të ndihmës shtetërore, lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, të mbrojtjes së konsumatorëve, me qëllim rritjen e konkurueshmërisë, standartizimin dhe mbikëqyrjen e tregut.

Funksionet kryesore që kryen kjo drejtori përshin çështjet që lidhen me nxitjen e biznesit dhe investimeve si vijon:

1. Udhëzon dhe propozon strategji, politika dhe programe për: i) nxitjen e konkurrueshmërisë së NVM-ve, IHD-ve dhe eksporteve bazuar në kapitujt negociues për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, konkretisht kapitullit 6 "Legjislacioni për shoqëritë tregtare" dhe kapitulli 20 "Ndërmarrjet dhe politikat industriale". ii) përafrimin e legjislacionit në fushën e NVM-ve; iii) nxitjen e konkurrueshmerisë iv) fuqizimin e bizneseve ekzistuese dhe internacionalizimin e tyre;
2. Këshillon dhe propozon ndryshime dhe përmirësime në kuadrin ligjor që mbështet sektorin privat, në funksion të krijimit të një klime të favorshme për biznesin, investimet, eksportet dhe rritjes së punësimit;
3. Mbikëqyr zbatimin e planit kombëtar për integrimin evropian në fushën e NVM-ve dhe investimeve me legjislacionin e BE-së;
4. Këshillon dhe harton politika për nxitjen e kreditimit, instrumente të reja financiare, në bashkëpunim me donatorët, institucionet financiare e jofinanciare, për NVM-të;

5. Mbikëqyr nismat rajonale për bashkëpunim në fushën e NVM-ve dhe investimeve për projekte të perbashketa të zhvillimit në rajon, si MAP REA, SEE2020, SME policy index, OECD Competetiveness Outlook etj.;

Sipas ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, "Për krijimin dhe organizimin e Agjencisë Shqiptare për zhvillimin e investimeve", Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka për mision të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, të forcojë potencialin eksportues të vendit, të promovojë mbështetjen e investimeve të huaja të direkte në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit. AIDA, maksimizon investimet e brendshme dhe të hua-ja, nëpërmjet krijimit të iniciativave ndihmuese rrit aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve në Shqipëri, përmirëson kapacitetet teknologjike dhe rinovimin e tyre me qëllimet e kombinuara që të rris investimet e huaja direkte, të forcojë kapacitetet e biznesit Shqiptar, si edhe të ndërtojë një imazh të denjë të Shqipërisë me fokus tërheqjen e investitorëve të ndryshëm.

Agjencia ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe duke ndihmuar subjektet treg-tare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si edhe duke ndërmjetësuar e duke bashkëpunuar me investitorët e organet shtetërore. Veprimtaria e Agjencisë përqendrohet, kryesisht, në:

- lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë;
- rritjen e aftësisë konkurruese dhe inovative të ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- nxitjen dhe ndihmën ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve;
- nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendëse dhe të huaja.

Aktualisht AIDA strukturohet në pesë drejtori:

1. Drejtoria e Investimeve;
2. Drejtoria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Projekteve;
3. Drejtoria e Marketing dhe Kërkim Analizë;
4. Drejtoria e Koordinimit;
5. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në funksion të përmbushjes së interesave strategjikë kombëtarë dhe rritjes se nivelit të përgjithshëm të bashkëpunimit ekonomik me vendet e tjera, ka si mision promovimin ndërkombëtar të interesave tanë ekonomikë, potencialeve për investime, tregti dhe bashkëpunim ekonomik dhe tregtar, sensibilizim dhe tërheqjen e investitorëve potenciale të huaj, nxitjen e eksporteve dhe lehtësimin e zgjerimit të firmave shqiptare në tregjet e huaja.

Roli dhe veprimtaria e saj është e ndërlidhur dhe koordinohet me përfaqësitë diplomatike, misionet dhe ambasadat tona jashtë, ministritë dhe agjencitë e tyre të varësisë, organizatat, aktorë dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm ekonomikë, grupet e bizneset dhe Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës.

Si një urë ndërlidhëse, komunikuese dhe koordinuese drejtoria vepron, ndërmerr, nxit dhe ndërmjetëson aksione dhe veprime konkrete që synojnë të lehtësojnë, përshpejtojnë dhe kontribuojnë në:

1. Forcimin dhe zgjerimin e kuadrit të bashkëpunimit ekonomik ndërshtetëror dhe ndërinstitucional;
2. Nxitjen dhe promovimin e këtyre marrëdhënieve në nivel bilateral;
3. Promovimin e potencialeve interesave të ekonomisë kombëtare;
4. Nxitjen, sensibilizimin dhe tërheqjen e investimeve të huaja direkt, si dhe partneriteteve për biznes dhe tregti, *know-how*;
5. Lehtësimin dhe mbështetjen e kompanive shqiptare që duan të hyjnë/zgjerohen në tregjet e huaja;

6. Adresimin e problematikave që lidhet me bashkëpunimin ekonomik me jashtë, në ndihmë si të sektorit publik ashtu edhe të atij privat;

**2.3 Lidhja e SZHBI 2021–2027 me dokumentet strategjike**

**a) Lidhja me SKZHI**

"SZHBI 2021–2027" lidhet dhe harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II, më konkretisht me shtyllën 2 të kësaj strategjie "Rritja ekonomike përmes rritjes së konkurrueshmërisë dhe inovacionit", konkretisht me objektivin strategjik:

1. Rritja e konkurrueshmërisë së biznesit dhe punësimit në vend, duke forcuar kapacitetet institucionale dhe klimën e biznesit, të përqendruar në inovacione;

2. Rritja e eksportit përmes integrimit në tregjet rajonale dhe evropiane;

3. Promovimi dhe zhvillimi i investimeve të huaja direkte dhe investimeve të brendshme.

**b) Lidhja me programin e Qeverisë**

"SZHBI 2021–2027" lidhet me programin qeverisës 2017–2020[7], konkretisht me prioritetin 2 "Rritje e qëndrueshme gjithëpërfshirëse" të këtij programi. Nën këtë prioritet, në mënyrë specifike "SZHBI 2021 – 2027" lidhet me fushat 2.1 "Stabilitet makroekonomik".

**c) Lidhja me PKIE dhe *Acquis* të BE-së**

"SZHBI 2021–2027" lidhet me kapitullin 20 "Ndërmarrjet dhe politikat industriale" të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. Politikat e BE-së për ndërmarrjet dhe industrinë kërkojnë të promovojnë strategjitë industriale, që rrisin konkurrencën, duke përshpejtuar përshtatjen ndaj ndryshimeve strukturore, duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për krijimin dhe rritjen e biznesit në të gjithë BE-në, si dhe investimet e brendshme dhe të huaja. Ato, gjithashtu, synojnë të përmirësojnë mjedisin e përgjithshëm të biznesit në të cilin veprojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

**ç) Lidhja me OZHQ-të**

"SZHBI 2021–2027" ka një lidhje të ngushtë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm[8]. Në mënyrë specifike, ajo lidhet me:

- SDG nr. 8: Promovo rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.

Sipas qëllimi, rritja e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike është një parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm, i cili mund të kontribuojë në përmirësimin e jetesës për njerëzit në të gjithë botën. Rritja ekonomike mund të çojë në mundësi të reja dhe më të mira punësimi dhe të sigurojë siguri më të madhe ekonomike për të gjithë. Për më tepër, rritja e shpejtë, veçanërisht midis vendeve më pak të zhvilluara dhe vendeve të tjera në zhvillim, mund t'i ndihmojë ata të ulin hendekun e pagave në krahasim me vendet e zhvilluara, duke zvogëluar kështu pabarazitë e dukshme midis të pasurve dhe të varfërve.

- SDG nr. 9: Ndërto infrastrukturë adekuate, promovo industrializim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxit inovacionin.

- Qëllimi 9 i zhvillimit të qëndrueshëm adreson tri aspekte të rëndësishme të zhvillimit të qëndrueshëm: infrastruktura, industrializimi dhe inovacioni. Infrastruktura siguron lehtësitë themelore fizike thelbësore për biznesin dhe shoqërinë; industrializimi nxit rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës, duke ulur kështu pabarazinë në të ardhura; dhe inovacioni zgjeron aftësitë teknologjike të sektorëve industrialë dhe çon në zhvillimin e aftësive për ekonominë digjitale apo transformimin digjital.

- SDG nr. 17: Forco mjetet e zbatimit dhe rigjallëro partneritetin global për zhvillim të qëndrueshëm

[7] https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf

[8] http://www.senior-a.al/docs/17SDGs_Shqip.pdf

Nevojitet një angazhim më i fortë për partneritet dhe bashkëpunim për të arritur SDG-të. Arritja e objektivave do të kërkojë politika koherente, një mjedis të mundshëm për zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha nivelet dhe nga të gjithë aktorët, dhe një partneritet global të ringjallur për zhvillim të qëndrueshëm. Në drejtim të këtij qëllimi, Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë identifikuar fushat e mëposhtme si kritike: mobilizimi i burimeve, teknologjia, ndërtimi i kapaciteteve, tregtia, koherenca e politikave dhe institucioneve, partneritetet me shumë aktorë dhe të dhënat, monitorimi dhe përgjegjësia. Përmbushja e mjeteve të synimeve të zbatimit është thelbësore për realizimin e Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm.

**3. Arritjet, analiza dhe sfidat**

**Situata e përgjithshme ekonomike**

Shqipëria është vend me të ardhura të mesme të larta, me një prodhim të brendshëm bruto (PBB) pak më të lartë se 15.3 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2019. Përpara se Shqipëria të goditej nga pandemia COVID-19 në mars të vitit 2020, ekonomia shfaqi një ecuri rritjeje të konsoliduar. Rritja e PBB-së reale ishte ndërmjet 2.2% dhe 4.1% në tri vitet e fundit përpara krizës së COVID-19. Produkti i brendshëm bruto (PBB) në tremujorin e katërt të vitit 2020 vlerësohet me rritje prej 2,99%, kundrejt tremujorit të katërt të vitit 2019. Me vlerësimin e tremujorit të katërt, INSTAT-i jep një vlerësim paraprak të PBB-së për vitin 2020, i cili mbështetur në vlerësimet tremujore, pësoi një rënie prej 3,31 % krahasuar me vitin 2019[9].

Tabela 1. Rritja e PBB-së reale (ndryshimi vjetor në %)

| Vendi | 2017 | 2018 | 2019 |
|---|---|---|---|
| Shqipëri | 3.8 | 4.1 | 2.2 |
| Bosnjë-Hercegovina | 3.2 | 3.7 | 2.6 |
| Kosova | 4.2 | 3.8 | 4.2 |
| Mali i Zi | 4.7 | 5.1 | 4.1 |
| Maqedonia e Veriut | 1.1 | 2.7 | 3.6 |
| Serbia | 2.0 | 4.4 | 4.2 |

*Burimi: Banka Botërore, Raporti i Rregullt Ekonomik*

Me një popullsi totale prej 2.9 milionë, kjo e çon PBB-në për frymë në rreth 5,350 dollarë amerikanë – e dyta më e ulët në Ballkanin Perëndimor. PBB-ja për frymë u rrit ndërmjet 2.7 dhe 4.3% nga viti në vit gjatë tri viteve të fundit. Shpërndarja e PBB-së për frymë në Shqipëri ndryshon shumë në varësi të rajonit. Më e larta është në Tiranë, e ndjekur nga Fieri, Gjirokastra dhe Durrësi, ndërsa më e ulëta në Kukës, Elbasan dhe Shkodër.[10]

**Struktura e ndërmarrjeve dhe e sektorëve**

Në fund të vitit 2019 numërohen 162,342 ndërmarrje aktive të regjistruara, një rritje me 1% nga viti 2016. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) përbëjnë 99.8% të të gjitha ndërmarrjeve, mbi 85% të numrit total të të punësuarve dhe 69% të vlerës së shtuar - më shumë se në pjesën më të madhe të vendeve të rajonit. Vlera e shtuar për NVM-të u rrit me 18% në periudhën ndërmjet vitit 2016 dhe 2018. Ndërmarrjet e vogla përbëjnë pjesën më të madhe të NVM-ve.[11]

[9] http://www.instat.gov.al/media/8171/pbb-tr4-2020.pdf
[10] Instituti i Statistikave në Shqipëri.
[11] Instituti i Statistikave në Shqipëri.

Ekonomia shqiptare karakterizohet nga një pjesë e madhe shërbimesh në PBB dhe një rol mjaft të rëndësishëm në punësim e zë sektori i bujqësisë. Rreth 37% e ndërmarrjeve aktive prodhojnë mallra dhe 63% prodhojnë shërbime. Në vitin 2019, sektori i shërbimeve ka kontribuar me 48.6% të PBB-së, e ndjekur nga industria (përfshirë ndërtimin) me 20.1% dhe bujqësia, pylltaria dhe peshkimi me 18.6%. Megjithatë, bujqësia ka dhënë një kontribut me rreth 36% të punësimit, shumë më tepër se kontributi i saj në PBB.[12]

Tabela 2. Treguesit sipas grupit të madhësisë së ndërmarrjeve 2018

| Madhësia e ndërmarrjes (nr. i të punësuarve) | Numri i ndërmarrjeve | Numri i të punësuarve | Vlera e shtuar (milionë lekë) |
|---|---|---|---|
| Mikro (1-9) | 100,876 | 194,867 | 116,099 |
| Të vogla (10-49) | 5,246 | 102,950 | 130,690 |
| Të mesme (50-249) | 1,147 | 113,911 | 143,799 |
| Të mëdha (250+) | 181 | 103,979 | 174,890 |

*Burimi: Instituti i Statistikave në Shqipëri*

Në përgjithësi, niveli i specializimit është relativisht i ulët. Industritë e rëndësishme përfshijnë, ndër të tjera, ndërtimin, ushqimin, pijet dhe duhanin, tekstilet dhe modën, tregtinë, transportin dhe shërbimet e akomodimit dhe ushqimit. Në kontekstin e krizës së COVID-19, shumë sektorë, përfshirë tregtinë, transportin, shërbimet turistike, industrinë dhe ndërtimin u ndikuan negativisht nga masat kufizuese dhe mbyllja. Vetëm bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, si dhe aktivitetet e pasurive të paluajtshme shënuan një trend rritës.[13]

Tabela 3. Vlera e shtuar sipas aktivitetit ekonomik 2018

| Aktiviteti ekonomik | Vlera e shtuar (milionë lekë) | Pjesë nga totali (%) |
|---|---|---|
| Të gjithë prodhuesit në treg | 565,478 | 100 |
| Miniera dhe gurore | 34,414 | 6.1 |
| Manifaktura | 85,269 | 15.1 |
| Elektricitet, gaz, furnizimi me ujë dhe menaxhimi i mbetjeve | 49,567 | 8.8 |
| Ndërtimi | 75,719 | 13.4 |
| Tregtia | 124,546 | 22.0 |
| Shërbimet e akomodimit dhe ushqimit | 24,546 | 4.3 |
| Transporti dhe informacioni dhe komunikimi | 63,794 | 11.3 |
| Shërbimet | 108,121 | 19.1 |

*Burimi: Instituti i Statistikave në Shqipëri*

**Klima e të bërit biznesit dhe mbështetja për NVM-të**

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash për të ulur barrierat administrative dhe përmirësuar mjedisin e biznesit. Siç konfirmohet nga renditja e Bankës Botërore për lehtësinë e të bërit biznes, është bërë progres në drejtim të rritjes së aksesit ndaj

[12] Të dhënat e Bankës Botërore.
[13] Instituti i Statistikave në Shqipëri.

kredive dhe forcimit të procedurave për zgjidhjen e paaftësisë paguese. Gjithashtu, Shqipëria e ka lehtësuar procesin e lidhjes me rrjetin e energjisë elektrike, zbatimin e lejeve të ndërtimit dhe pagesën e taksave. Albania u rendit e 82-ta nga 190 vende pjesë e raportit për lehtësinë e të bërit biznes të vitit 2020, duke u renditur më lart se Bosnja dhe Hercegovina (90), por më poshtë se Maqedonia e Veriut (17), Serbia (44), Mali i Zi (50) dhe Kosova (57). Totali i pikëve ishte 67.7, me një rritje prej 7.2 pikë krahasuar me raportin e vitit 2016, ku Shqipëria u rendit e 97-ta.

Tabela 4. Pikët dhe renditja në raportin lehtësia e të bërit biznes

| Tregues | Raporti 2016 | | Raporti 2020 | |
|---|---|---|---|---|
| | Pikët | Renditja | Pikët | Renditja |
| Nisja e një biznesi | 90.1 | 58 | 91.8 | 53 |
| Zbatimi i lejeve të ndërtimit | 0.0* | 189 | 52.7 | 166 |
| Lidhja me rrjetin e energjisë elektrike | 43.7 | 162 | 71.0 | 107 |
| Regjistrimi i pronës | 58.5 | 107 | 63,4 | 98 |
| Marrja e kredisë | 65.0 | 42 | 70.0 | 48 |
| Mbrojtja e investitorëve në minorancë | 73.3 | 8 | 46.0 | 111 |
| Pagesa e taksave | 62.0 | 142 | 65.2 | 123 |
| Tregtia përtej kufijve | 91.6 | 37 | 96.3 | 25 |
| Zbatimi i kontratave | 57.4 | 96 | 53.5 | 120 |
| Zgjidhja e paaftësisë paguese | 63.4 | 42 | 67.7 | 39 |

** Nuk disponohen pikët. Burimi: Banka Botërore, lehtësia e të bërit biznes në Shqipëri 2016/2020*

Gjithashtu, Shqipëria ka ridimensionuar procesin e regjistrimit të biznesit dhe procesin e aplikimit për licenca, duke reduktuar numrin e dokumenteve dhe hapat e nevojshëm për shqyrtim. Sipërmarrësit në Shqipëri i regjistrojnë bizneset e tyre dhe aplikojnë për licenca dhe leje në Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila operon si një *one-stop-shop* (qendër me një ndalesë) në 33 bashki dhe komuna. Gjithashtu, Shqipëria ka konsoliduar digjitalizimin e shërbimeve qeveritare. Që prej fillimit të vitit 2020, bizneset dhe qytetarët kanë akses në 474 aplikime *online* për shërbime publike përmes platformës *e-Albania*, p.sh., për leje ndërtimi, shërbim klienti dhe pagesën e taksave. Është ndërtuar një sistem i dedikuar për ndërveprimin e institucioneve, me qëllim shkëmbimin elektronik të të dhënave dhe dokumenteve me firmë elektronike.

Pa disa
penge mit të
ndërn shijnë
niveli ë në
infras
Në htuar,
veçan lshme

**Grafiku 1 Pengesat në mjedisin e biznesit (10 më të rëndësishmet)**




[14] Banl

(rreth 80% e investimeve), ndërkohë që vetëm 12% e bizneseve i financojnë investimet e tyre përmes bankave. Financimet përmes institucioneve financiare jobanka mbeten mjaft të kufizuara. Mikrokreditë, qiraja financiare dhe faktoringu janë mjete të disponueshme dhe mbështeten nga një bazë ligjore e konsoliduar, por penetrimi mbetet i ulët. Mikrokreditë përbëjnë sy të tretat e të gjitha kredive nga institucionet financiare jobanka, ndërsa qiraja financiare përbën më pak se 30% të tyre. Faktoringu zë një pjesë të pakonsiderueshme. Megjithëse volumi i qirave financiare dhe faktoringut është rritur gjatë viteve të fundit, përdorimi i këtyre instrumenteve mbetet i ulët. Faktorët që kanë ndikuar janë niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe mungesa e një qasjeje sistematike ndaj edukimit financiar. Niveli i ulët i njohurive financiare, veçanërisht të NVM-të mbetet pengesa kryesore për aksesin në financë. Shqipëria ka rezultat të dobët në sondazhin për njohuritë financiare të *Standards & Poor's*, ku më pak se 14% e popullsisë në moshë madhore ka njohuri financiare, krahasuar me një mesatare prej 27.5% në rajon. Gjithashtu, NVM-të e kanë të vështirë të marrin informacion rreth mundësive të financimit pasi nuk ekzistojnë platforma të centralizuara.[15] Me asistencën e BERZH-it, Ministria përgjegjëse për ekonominë është duke zhvilluar një portal informativ të centralizuar që ofron informacione mbi të gjitha instrumentet financiare për NVM-të. Ky portal është ngritur tashmë dhe është funksional në website e AIDA-s, që prej maj 2021

Përveç përmirësimeve në mjedisin e biznesit, Shqipëria ka përmirësuar, gjithashtu, dhe performancën në dimensionin e "Shërbimeve të mbështetjes së biznesit për NVM-të" të indeksit të politikave për NVM-të, i kryer nga OECD-ja. Që prej vlerësimit të fundit në vitin 2016, vlerësimi i Shqipërisë u rrit nga 2.65 në 3.61. Pavarësisht këtij progresi, Shqipëria mbetet ende nën mesataren e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë prej 3.89.[16]

Tabela 5. Shërbimet e mbështetjes së biznesit për NVM-të
(vlerësimi i indeksit të politikave për NVM-të 2019)

| Vendi | Vlerësimi i përgjithshëm i shërbimeve mbështetëse për NVM-të | Nënndarjet | |
|---|---|---|---|
| | | Shërbimet e mbështetjes së biznesit nga qeveria | Iniciativat e qeverisë për të nxitur shërbimet private të mbështetjes së biznesit |
| Shqipëri | 3.61 | 3,01 | 4.21 |
| Bosnjë dhe Hercegovina | 3,41 | 2.98 | 3.85 |
| Kosova | 3.64 | 3.35 | 3.94 |
| Mali i Zi | 4.03 | 3.83 | 4.23 |
| Maqedonia e Veriut | 3.96 | 3.52 | 4.39 |
| Serbia | 4.12 | 4.33 | 3.91 |
| BP dhe Turqia mesatarja | 3.89 | 3.63 | 4.14 |

*Burimi: OECD, Indeksi i Politikave për NVM-të 2019*

[15] OECD/ETF/BE/BERZH (2019), indeksi i politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019, vlerësimi i zbatimit të ligjit për biznesin e vogël për Evropën.
[16] OECD/ETF/BE/BERZH (2019), indeksi i politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019, vlerësimi i zbatimit të ligjit për biznesin e vogël për Evropën.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është institucioni publik qendror i dedikuar që ofron shërbime të mbështetjes së biznesit (SHMB) për NVM-të. AIDA jep informacione të përgjithshme, p.sh., mbi legjislacionin përkatës mbi hapjen e një biznesi, mbi zhvillimin e një plani biznesi dhe mbi SHMB-të financiare dhe jofinanciare të disponueshme. Mbështetja e mëtejshme për NVM-të përfshin lehtësimin e pjesëmarrjes në panairet tregtare kombëtare dhe ndërkombëtare, duke identifikuar tregjet e reja, partnerët eksportues, nevojat për trajnime dhe certifikim të produkteve, si dhe mbështetje përmes projekteve të ndryshme me donatorët.

Përveç dhënies së informacionit, AIDA ofron mbështetje financiare për bizneset. Megjithatë, kërkesa deri tani ka qenë relativisht e ulët. Gjatë periudhës 6-vjeçare nga viti 2014 më 2019, 373 NVM kanë marrë grante nga fondet e AIDA-s me një shumë totale prej 264 milionë lekë. Sipas indeksit të politikave, NVM-të i perceptojnë si frenuese procedurat e aplikimit për fondet e AIDA-s. Përveç kësaj, grantet që jepen përmes këtyre fondeve janë relativisht të vogla. Kjo duket se i frenon më tej aplikuesit e mundshëm që të kryejnë procesin e gjatë të aplikimit. Për të aplikuar, NVM-të duhet të takohen personalisht me stafin e AIDA-s në zyrën e saj në Tiranë. Kjo raportohet si një pengesë për NVM-të që ndodhen në rrethe të tjera, dhe përbën një faktor për hezitimin e tyre për të aplikuar për shërbimet financiare të AIDA-s.[17] Në shtator të vitit 2020, Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe AIDA u asistuan nga një mision *online* i TAIEX-it që synonte rikonceptimin e skemave ekzistuese të granteve. Ligji për NVM-të siguron kuadrin ligjor për format e ndryshme të mbështetjes financiare për NVM-të, përfshirë garancitë e kredive. Por përveç granteve klasike, momentalisht asnjë skemë tjetër financiare nuk i ofrohet NVM-ve.

Ekzistojnë projekte të tjera të financuara nga donatorët, të tilla si programi BE për Inovacionin. 23 kompani kanë përfituar deri tani nga grantet e dhëna nga ky program. Për shkak të kritereve të pranimit, përqindja e pjesëmarrjes në këtë program është disi e ulët. Gjithashtu, programi i GIZ ProSEED mbështet skemën e IDEA-s gjatë periudhës 2018 deri më 06/2021, me një shumë totale prej 750,000 € për grante, që synojnë bizneset e reja (jo më gjatë se 2 vite në treg). Grantet variojnë nga 4,000 € për individët deri në 7,000 € për grupimet. Projekte të tjera mbështetëse/me donatorë, që lehtësojnë aksesin në financë përfshijnë Programin e Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF) të BERZH-it, dhe Programin Italo-Shqiptar për zhvillimin e NVM-ve në Shqipëri. Ky i fundit ka ofruar një skemë granti me ndarje të kostos për mbështetjen e NVM-ve që synonin të kishin akses në kredi, duke mbuluar 50% të kostos për përgatitjen e një plani biznesi. Rreth 12 NVM përfituan nga kjo skemë.

**Tregu i punës dhe punësimi**

Në muajin janar 2020, popullsia e Shqipërisë ishte 2,845,955 banorë, me një rënie prej 0.6% krahasuar me muajin janar 2019 dhe 0.1% krahasuar me vitin 2016. Shqipëria është prej vendeve me popullsinë më të re në Evropë, ku mosha mesatare në vitin 2019 ishte 37.2 vjeç. Më shumë se 31% e popullsisë është nën 24 vjeç.[18]

Tregu i punës në Shqipëri ka shënuar një trend pozitiv gjatë viteve të fundit. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është rritur nga 67.3% në vitin 2016 në 69.8% e totalit të popullsisë së moshës 15–64 vjeç gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, dhe është më e larta në

[17] OECD/ETF/BE/BERZH (2019), Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019, Vlerësimi i zbatimit të ligjit për biznesin e vogël për Evropën

[18] Instituti i Statistikave në Shqipëri.

rajon. Për burrat, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës (77.9%) është 16.1 pikë përqindje më e lartë se sa për gratë (61.8%). Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 53.3%.[19]

**Grafiku 2 Shkalla e papunësisë (%)**




*Burimi Instituti i Statistikave në Shqipëri*

Ecuria pozitive reflektohet, gjithashtu, në uljen e shkallës së papunësisë gjatë viteve të fundit në nivelin 12.0% në tremujorin e dytë 2019. Në veçanti, shkalla e papunësisë për të rinjtë është ulur nga 29.9% në vitin 2016, në 20.9% në vitin 2019. Shkalla e papunësisë për burrat është disi më e lartë (12.1%) se sa për gratë (11.8%). Kriza e COVID-19 e ndërpreu këtë trend pozitiv. Shkalla e papunësisë u rrit nga 11.9% në tremujorin e parë në 12.5% në tremujorin e dytë të vitit 2020 - i njëjti trend vihet re dhe në vendet e tjera të rajonit. Shkalla e papunësisë për të rinjtë u rrit nga 20.0% në 21.4%. Burrat u prekën më shumë nga kriza, ku papunësia ndër ta u rrit nga 11.5% në 12.6%, ndërsa papunësia për gratë mbeti e pandryshuar në normën 12.4%.[20]

**Grafiku 3 Përqindja (%) e punësimeve në profesione që kërkojnë njohuri të thelluara 2018**




*Burimi Indeksi Global i Inovacionit*

[19] Instituti i Statistikave në Shqipëri.
[20] Instituti i Statistikave në Shqipëri.

Gjatë viteve të fundit, shumë vende pune janë zhvendosur nga bujqësia drejt veprimtarive me produktivitet më të lartë. Në vitin 2016, 39.8% e punësimeve totale ishin në sektorin e bujqësisë. Kjo përqindje është ulur në 36.1% në vitin 2020. Në të njëjtën kohë, punësimet në sektorin e industrisë u rritën nga 19% në 20.2% dhe punësimet në sektorin e shërbimeve nga 41.2% në 43.7%.[21] Pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, përqindja e punësimeve në profesione që kërkojnë njohuri është më e ulëta në rajon me 17.5%[22] ndërsa punësimi informal mbetet ende një sfidë për tregun e punës në Shqipëri. Punësimi informal në sektorët jobujqësorë zë rreth 30%.[23] Gjithashtu, Shqipëria është goditur ashpër nga fenomeni i largimit të trurit, duke qenë ndër 15 vendet me emigracion më të lartë të shtetasve me arsim të lartë. Në vitin 2019, 43,835 persona emigruan nga Shqipëria, çka përbën një rritje prej 13.3% krahasuar me vitin e kaluar.[24] Të emigruarit janë më së shumti profesionistë të rinj, përfshirë inxhinierë, specialistë TI-je, mjekë dhe infermiere, por, gjithashtu, dhe lektorë në institucionet e arsimit të lartë, kërkues dhe studentë. Aktualisht rreth 36% e popullsisë jeton jashtë vendit.[25]

Tabela 6. Produktiviteti si PBB për person të punësuar
(në vitin 2017, PPP konstante në $)

| Vendi | 2016 | 2019 |
|---|---|---|
| Shqipëri | 32,673 | 34,603 |
| Bosnja dhe Hercegovina | 44,571 | 46,187 |
| Mali i Zi | 52,316 | 56,603 |
| Maqedonia e Veriut | 44,046 | 43,501 |
| Serbia | 42,093 | 45,053 |

*Burimi. Të dhënat e Bankës Botërore*

Kostot e punës në Shqipëri janë më të ulëtat në rajon, megjithatë, në të njëjtën kohë, Shqipëria regjistron produktivitetin më të ulët. Pagat mesatare në vitin 2018 ishin 396 €, krahasuar me 504 € në Kosovë, 571 € në Serbi, 597 V në Maqedoninë e Veriut, 599 € në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe 769 € në Malin e Zi.[26] PBB-ja për çdo të punësuar ishte rreth 34,603$ në vitin 2019, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me 32,673$ në vitin 2016, por mbetet ende më e ulët se në vendet e tjera të rajonit.[27]

DIASPORA DHE REMITANCAT

Remitancat, ose dërgesat në para të migrantëve drejt vendlindjes, kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

[21] Të dhënat e Bankës Botërore.
[22] Universiteti Cornell, INSEAD, WIPO (2019), Indeksi Global i Inovacionit 2019.
[23] Komisioni Evropian (2019), Programi i Reformës Ekonomike për Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Turqinë, Bosnjën dhe Hercegovinë dhe Kosovën - Raporti i Komisionit dhe Vlerësimi i Vendit.
[24] Instituti i Statistikave në Shqipëri.
[25] BERZH (2019), Diagnostikimi i Shqipërisë.
[26] Këshilli Shqiptar i Investimeve (2019) Vështrim mbi Treguesit e Zhvillimit Ekonomik të Shqipërisë, janar–qershor 2019.
[27] Të dhënat e Bankës Botërore.

Shqipëria renditet në listën e vendeve me varësi të lartë te remitancat, siç njihen ndryshe dërgesat në para. Remitancat përfaqësojnë rreth 9–15% të PBB-së së vendit dhe rreth 15% e të ardhurave të familjeve shqiptare.

Remitancat janë përdorur kryesisht për konsumin e përditshëm të familjeve shqiptare dhe më pak për investime (përjashtim bën blerja apo ndërtimi i banesave).

Një rëndësi të veçantë në vlerësimin e remitancave si cilësi e ekonomisë së vendit ka pasur fillimi i botimeve vjetore nga Banka e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikave (INSTAT). Ato do të jenë të përvitshme, duke shënuar një hap cilësor në informacionin zyrtar për diasporën shqiptare.

Raportet vjetore të Bankës së Shqipërisë kanë qenë për vitin 2018, "Remitancat: Një mbështetje për zhvillim, 2018," për vitin 2019, "Diaspora dhe pagesat, 2019" dhe për vitin 2020, "Pandemia dhe remitancat."

Raportet vjetore të Institutit të Statistikave (INSTAT) janë si më poshtë për vitin 2018, "Diaspora e Shqipërisë në shifra 2018," për vitin 2019 "Diaspora e Shqipërisë në shifra 2019" dhe për vitin 2020 "Diaspora e Shqipërisë në shifra 2020".

TENDENCA E REMITANCAVE NË VITE




**Burimi:** Banka e Shqipërisë 2019

Dinamika e të ardhurave nga remitancat në Shqipëri ka kaluar tri faza:

1. Rritjen e tyre nga viti 1991 deri në vitin 2007;
2. Rënien në periudhën 2008–2013; dhe
3. Ripërtëritjen që prej vitit 2014.

Remitancat vazhduan të rriteshin nga viti 1991 deri në vitin 2007, ku ato arritën nivelin e tyre maksimal. Në vitin 2007, në Shqipëri vlera e prurjeve monetare të remitancave ishte 952 milionë euro. Kjo e bënte atë vendin me varësinë më të madhe ndaj dërgesave në para në rajon, me më shumë se 300 euro për banor. Pas këtij viti, remitancat ranë duke arritur pikën e tyre më të ulët në vitin 2013, në shifrën nën 500 milionë euro. Kjo rënie shkaktoi rritje të varfërisë në Shqipëri.

Sipas të dhënave nga Banka Botërore, remitancat u rritën sërish në vitet 2018–2019, duke shënuar vlerën 1455 milionë dollarë në vitin e fundit.

Përfshirja e diasporës shqiptare në zhvillimin ekonomik të vendit do të përqendrohet kryesisht në:

- Forcimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës;

- Zhvillimin e një kuadri ligjor për investimet nga diaspora shqiptare;
- Realizimin e të rrjeteve të profesionistëve të diasporës shqiptare.

Qëllimi i angazhimit të diasporës shqiptare do të jetë inkurajimi i investimeve, krijimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme në disa fusha, përfshirë bujqësinë, industrinë e ushqimit dhe zhvillimin e zonave rurale. Kjo do të realizohet duke krijuar një klimë të favorshme për investimet nga diaspora nëpërmjet aktiviteteve për stimuj fiskalë, shpërndarje informacioni, duke ulur korrupsionin dhe risqet apo duke përmirësuar elementë të tjerë nxitës.

**Arsimi, formimi dhe aftësitë**

Shpenzimet e qeverisë për arsimin në vitin 2017 ishin në nivelin 3.1% të PBB-së. Investimet e Shqipërisë në arsimin fillor janë të krahasueshme me investimet në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, duke garantuar shanse të arsyeshme për pjesëmarrje në arsim bazë cilësor. Në të kundërt, investimet si në arsimin e mesëm dhe lartë janë dukshëm më të ulëta se në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.[28]

Në vitin 2015, reforma afatgjatë e sistemit arsimor prezantoi të mësuarit në bazë të kompetencave në të gjitha nivelet arsimore. Ndër të tjera, sipërmarrja u konsiderua si një nga kompetencat kyçe në të gjitha programet parauniversitare dhe kurrikulat e arsimit dhe formimit profesional. Në praktikë, zbatimi nuk është realizuar plotësisht në të gjitha institucionet arsimore në vend. Megjithatë, ka raste suksesi, kryesisht në institucionet dhe programet e mbështetura nga donatorët siç janë Kulturkontakt Austria dhe Junior Achievement. Gjithashtu, promovimi i aftësive digjitale është përfshirë në agjendën e politikës, duke u reflektuar në disa strategji dhe nisma kombëtare si dhe rritjen e mbështetjes nga donatorët. Por mësimi i aftësive digjitale është ende në fazë të hershme. Kërkohen përmirësime të mëtejshme duke marrë në konsideratë modelin e parashikimit të aftësive të Qendrës Evropiane për Zhvillimin e Formimit Profesional, i cili parashikon se në të ardhmen, rreth 85% e të gjitha punëve në BE do të kenë të nevojshme të paktën nivelin bazë të aftësive digjitale.

Shqipëria ka nivel të lartë arsimimi dhe reformat arsimore kanë çuar në një rritje të regjistrimeve në arsimin e lartë, duke siguruar rrjedhë të qëndrueshme të talenteve. Rreth 139.000 studentë regjistrohen në institucionet e arsimit të lartë çdo vit. Në vitin 2019, 34.891 studentë u diplomuan nga institucionet e arsimit të lartë, një rritje me 9.4% nga viti 2016.[29] Tradicionalisht preferohen programet e studimit në shkenca sociale, shkenca ekonomike dhe drejtësi, dhe 41% e të diplomuarve kanë diplomë në shkenca sociale, shkenca ekonomike dhe drejtësi. Megjithëse reformat në arsim vazhdojnë dhe numri i të diplomuarve në institucionet e arsimit të lartë rritet, më shumë se 40% e popullsisë në moshë pune janë me arsim fillor ose të mesëm. Gjithashtu, niveli i ulët i investimeve në arsimin e mesëm dhe të lartë rezulton në një shkallë të lartë studentësh që largohen nga shkolla apo kursi i formimit, i cili – pavarësisht se është ulur ndjeshëm kohët e fundit - ende është mbi 16 % për grup-moshën 18–24 vjeç. Në vendet e tjera të rajoni kjo shkallë varion ndërmjet 5% dhe 9%.[30]

Progresi i Shqipërisë reflektohet, gjithashtu, në përmirësimet e mëdha në dimensionin e "Aftësive sipërmarrëse" të Indeksit të Politikave për NVM-të. Në këtë dimension, Shqipëria renditet mbi nivelin mesatar. Ky rezultat del nga vlerësimi i kombinuar i: 1. zhvillimeve në hartimin dhe planifikimin e politikave; 2. mundësive për trajnim që ofrohen aktualisht për NVM-të; dhe 3. masave përkatëse të monitorimit dhe të vlerësimit. Me një vlerësim të përgjithshëm prej 3.40–0.73 pikë më lart se në vitin 2016 – Shqipëria është ndër vendet me

[28] Banka Botërore (2019) Diagnostikimi Sistematik për Shqipërinë.
[29] Instituti i Statistikave në Shqipëri.
[30] Eurostat.

rezultat më të lartë në rajon. Vlerësimi mesatar për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë është në nivelin 2.87. Vetëm Serbia (3.95) dhe Turqia (3.54) kanë arritur rezultatin më të lartë. Sipas raportit, ky përmirësim reflekton, ndër të tjera, Analizën e Nevojave për Aftësi të vitit 2017, e cila u krye nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Megjithatë, ka ende disa sfida, duke përfshirë përmirësimin e mëtejshëm të inteligjencës së aftësive, zgjerimin e ofrimit të trajnimeve për të garantuar një ofertë të përshtatshme aftësish në tregun e punës, dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet arsimit dhe biznesit përmes lehtësimit të aksesit ndaj informacionit.[31]

Tabela 7. Aftësitë sipërmarrëse (rezultati i indeksit të politikave për NVM-të 2019)

| | Planifikimi dhe hartimi | Zbatimi | Monitorimi dhe vlerësimi | Mesatarja e ponderuar |
|---|---|---|---|---|
| Shqipëri | 3.50 | 3.50 | 3.00 | **3.40** |
| Bosnja dhe Hercegovina | 3.50 | 2.50 | 2.00 | **2.70** |
| Kosova | 4.17 | 2.25 | 2.00 | **2.78** |
| Mali i Zi | 1.50 | 1.50 | 1.00 | **1.40** |
| Maqedonia e Veriut | 3.17 | 2.00 | 2.00 | **2.35** |
| Serbia | 4.50 | 4.00 | 3.00 | **3.95** |
| Turqia | 3.33 | 4.06 | 3.00 | **3.54** |
| Mesatarja për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë | 3.38 | 2.83 | 2,29 | **2.87** |

*Burimi: OECD, indeksi i politikave për NVM-të 2019*

Pavarësisht progresit të sipërpërmendur, bizneset shqiptare ende vërejnë se fuqia punëtore e pakualifikuar është një pengesë për biznesin. Bizneset janë të kënaqura me nivelin e aftësive të fuqisë punëtore që kanë të punësuar, por hasin vështirësi në rekrutimin e punonjësve të rinj, veçanërisht për pozicione pune që kërkojnë nivel më të lartë aftësish. Bizneset raportojnë mungesën e njohurive më të fundit dhe aftësive praktike, veçanërisht tek aplikantët e rinj dhe ata që hyjnë për herë të parë në tregun e punës. Nevojat e bizneseve për aftësi duket se ndryshojnë nga ajo çfarë mësohet aktualisht në institucionet e arsimit të lartë dhe në qendrat e aftësimit dhe formimit profesional (AFP). Arsyet gjenden më së shumti në ndërveprimin e kufizuar ndërmjet biznesit dhe institucioneve arsimore, dhe në mësimin në shkollat e përgjithshme dhe ato profesionale pa ekspozim në eksperiencën në punë. Gjithashtu, shpesh firmat nuk ofrojnë trajnim në vendin e punës dhe nuk bashkëpunojnë me shkollat profesionale apo qendrat e formimit profesional për të adresuar mungesën e aftësive të fuqisë së tyre punëtore. Për shkak të përmasave të tyre të vogla, veçanërisht NVM-të e kanë të vështirë të plotësojnë nevojat e tyre për arsim dhe trajnim dhe investojnë shumë pak në drejtim të zhvillimit të aftësive se sa firmat e mëdha.[32] Niveli i trajnimeve është shumë i lartë në ndërmarrjet e huaja apo të përbashkëta se sa në bizneset lokale.[33]

[31] OECD/ETF/BE/BERZH (2019), Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019, Vlerësimi i zbatimit të ligjit për biznesin e vogël për Evropën.

[32] Banka Botërore (2018), Kërkesa për aftësi në Shqipëri. Një analizë e aftësive drejt punësimit dhe studim i produktivitetit.

[33] Banka Botërore (2018), Kërkesa për aftësi në Shqipëri. Një analizë e aftësive drejt punësimit dhe studim i

**Veprimtaria e *startup*-eve dhe inovacionit**

Shqipëria renditet e 110-ta nga 141 vendet në 'Shtyllën e inovacionit' të Indeksit i Konkurrueshmërisë Globale të Forumit Ekonomik Botëror (GCI), një prej instrumenteve kryesore për krahasimin e konkurrueshmërisë. GCI-ja përcakton konkurrueshmërinë e vendeve bazuar në performancën e tyre të matur në dymbëdhjetë shtylla. "Shtylla e inovacionit" reflekton dhjetë indikatorë në tri masa agregate: ndërveprimi dhe diversiteti, kërkimi, zhvillimi dhe komercializmi. Shqipëria mori 29.8 pikë në vitin 2019, një rënie nga niveli 37.7 në vitin 2018. Në një krahasim rajonal, Shqipëria renditet më lart se Bosnja dhe Hercegovina (në vendin e 117), por më poshtë se Maqedonia e Veriut (në vendin e 97), Mali i Zi (69) dhe Serbia (59).[34]

Tabela 8. Pjesë nga Indeksi i Konkurrueshmërisë Globale 2019 – Shqipëria

| Tregues | Vlera | Pikët | Renditja |
|---|---|---|---|
| **Shtylla e 12-të aftësitë inovative** | - | 29.8 | 110 |
| **Ndërveprimi dhe diversiteti 0–100** | - | 32.5 | 114 |
| Diversiteti i fuqisë punëtore 1–7 (më e larta) | 4.0 | 49.7 | 115 |
| Situata e zhvillimit të klusterave 1–7 (më e larta) | 2.8 | 30.4 | 133 |
| Shpikjet e përbashkëta ndërkombëtare për milionë copë | 0.10 | 2.9 | 84 |
| Bashkëpunim me shumë aktorë 1–7 (më e larta) | 3.8 | 47.1 | 57 |
| **Kërkim dhe zhvillim 0–100** | - | 17.2 | 126 |
| Botime shkencore pikët | 57.3 | 60.2 | 128 |
| Aplikimet për patentë për milionë copë | 0.22 | 3.6 | 89 |
| Shpenzimet për kërkim dhe zhvillim % PBB | 0.2 | 5.1 | 98 |
| Dominimi i institucioneve kërkimore 0–100 (më e larta) | 0.00 | 0.0 | 117 |
| **Komercializimi** | - | 49.2 | 95 |
| Sofistikimi i blerësve 1–7 (më e larta) | 3.1 | 34.5 | 107 |
| Aplikimet për makra tregtare për milionë copë | 379.36 | 63.9 | 81 |

*Burimi: Indeksi i Konkurrueshmërisë Globale*

Një prej arsyeve, për dinamikën e ulët të inovacionit në Shqipëri krahasuar me rajonin e Ballkanit Perëndimor, mund të lidhet me shpenzimet e ulëta në fushën e Kërkimit dhe Zhvillimit (K&ZH). Sipas tabelës , shpenzimet për K&ZH janë në masën 0.2 % të PBB-së, të krahasueshme më Bosnjën dhe Hercegovinën dhe më të ulëta se në Malin e Zi (0.4%), Maqedoninë e Veriut (0.4%, Serbi (0.9%) dhe se mesatarja e BE-së (2.19%).[35] Rreth 0.1% e popullsisë ka punuar në fushën e kërkimit në vitin 2018, që është më pak se një e treta e mesatares së BE-së.[36] Ato pak veprimtari kërkimi dhe zhvillimi janë të përqendruara në një

produktivitetit.

[34] Forumi Ekonomik Botëror (2019/2018), Raporti i Konkurrueshmërisë Globale.

[35] Forumi Ekonomik Botëror (2019/2018), Raporti i Konkurrueshmërisë Globale.

[36] Komisioni Evropian (2019), Programi i Reformës Ekonomike për Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Turqinë, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kosovën – Raporti i Komisionit dhe Vlerësimi i

numër të kufizuar institucionesh të arsimit të lartë dhe kompanish (të mëdha) dhe fokusohen në, midis të tjerash, shkencat e natyrës, bioekonomi, shkencat humanitare dhe në teknologjinë e gazit dhe motorëve (me djegie). Fokusi në këto fusha reflektohet (ndër të tjera) në botimet akademike dhe patentat e dhëna në Shqipëri.[37]

Sipas një raporti të fundit të programit BE-së për inovacionin, institucionet e arsimit të lartë kanë kufizime për sa u përket strukturave të qëndrueshme për kërkime mbi inovacionin. Transferimi i njohurive, kërkimi i aplikuar dhe të mësuarit bazuar në projekte është i rrallë dhe ndodh vetëm në disa institucionet e arsimit të lartë private mjaft sipërmarrëse. Institucionet e arsimit të lartë nuk janë të integruara mirë në programet ndërkombëtare të kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit (KZHI), të tilla si Horizon 2020. Dobësi të tjera të ekosistemit janë mungesa e mundësive për financim për projektet inovative dhe mungesa e transferimit të teknologjisë dhe parqeve shkencore dhe teknologjike.[38]

Disa agjenci janë përfshirë në zbatimin e politikave inovative, duke përfshirë AIDA-n dhe Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI). Ndërkohë që AIDA fokusohet në pjesën e biznesit, AKKSHI fokusohet në institucionet kërkimore, duke lehtësuar shkëmbimin e njohurive dhe mbështetjen financiare për projekte kërkimi. Megjithatë koordinimi midis këtyre agjencive është i vogël dhe të dyja ato kanë burime të kufizuara për zbatimin e programeve.

Siç është konfirmuar dhe në konsultimet me palët e interesit dhe raportet e kohëve të fundit, ekosistemi i *startup*-eve është relativisht i ri dhe në fazë të hershme. Tregu lokal shqiptar i vogël në kombinim me largimin e trurit dhe mungesën e bashkëpunimit dhe bashkëkrijimit çojnë në një rritje të ngadaltë të numrit të *startup*-eve. Rreth 250 *startup*-e – rreth 88 për një milion banorë – janë aktivë në Shqipëri. Pjesëmarrja e grave në sipërmarrje është rritur gjatë viteve të fundit, por mbetet ende në nivele të ulëta.[39]

Në të kaluarën e afërt, është rritur numri i organizatave mbështetëse dhe i projekteve të donatorëve, duke ofruar më shumë mundësi për përfshirjen e sipërmarrësve aspirantë. Shembuj të tillë janë *Tech Space, Oficina* dhe *Yunus Social Business* në fushën e përshpejtimit/inkubacionit. Gjithashtu, programi BE për Inovacionin dhe Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve organizojnë një sërë aktivitetesh dhe projektesh për promovimin e veprimtarive të *startup*-eve. Shumica e organizatave janë të përqendruara në Tiranë. Për shkak të komunitetit të vogël të *startup*-eve, organizatat mbështetëse kanë vështirësi për tërheqjen e masës kritike të *startup*-eve me potencial zhvillimi, në mënyrë që të ndërtohen struktura mbështetëse të qëndrueshme. Mbështetja e qeverisë për zhvillimin e sektorit të *startup*-eve dhe niveli i bashkëpunimit midis organizatave mbështetëse dhe qeverisë është ende i dobët.

Megjithatë, palët e interesit theksojnë se gjatë viteve të fundit janë bërë një sërë përmirësimesh në ekosistemin e *startup*-eve dhe të inovacionit. Ata shohin mundësi premtuese për rritjen e veprimtarive sipërmarrëse në vend, për shkak të popullsisë relativisht të re në kërkim të punësimit dhe një kontigjent premtues talentesh, përfshirë numrin e madh të të diplomuarve në institucionet e arsimit të lartë dhe përqindjen në rritje të të rinjve që njohin gjuhë të huaja (veçanërisht anglisht, italisht dhe gjermanisht). Sipas konsultimeve me palët e interesit, Qeveria Shqiptare e ka njohur dhe kuptuar potencialin e *startup*-eve dhe të bizneseve inovative për rritjen ekonomike të vendit. Kjo demonstrohet në veprimtaritë për përmirësimin e paketës së politikave. Strategji dhe plane veprimi të ndryshme integrojnë ose fokusohen tek

---

Vendit.

[37] BE për Inovacionin (2019), Hartëzimi RIS3 i Shqipërisë.

[38] BE për Inovacionin (2019), Ekosistemet sipërmarrëse në Shqipëri me fokus në Tiranë.

[39] BE për Inovacionin (2019), Ekosistemet sipërmarrëse në Shqipëri me fokus në Tiranë.

inovacioni, për shembull, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, Plani i Veprimit për Sipërmarrjen e Grave dhe Plani i Veprimit i Spirales së Trefishtë. Me përpjekje të përbashkëta dhe nën drejtimin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Ministrisë përgjegjëse për ekonominë është hartuar një kuadër ligjor për *startup*-et inovative. Gjithashtu, Shqipëria aktualisht po zhvillon një strategji për specializimin inteligjent bazuar në një qasje pjesëmarrëse.

**Tregtia**

Shqipëria ka një sërë Marrëveshjesh për Tregtinë e Lirë, të cila ofrojnë akses në tregje sipas preferencave. Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe ka nënshkruar Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), e cila mbulon ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe Moldavisë. Procesi i zbatimit të Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal 2021–2024, në Ballkanin Perëndimori dakordësuar nga kryeministrat e Ballkanit Perëndimor, në Samitin e Sofjes, në nëntor 2020, do të rrisë bashkëpunimin ekonomik rajonal, duke forcuar tregtinë, investimet, integrimin digjital si dhe mobilitetin brenda rajonit. Negociatat për aderimin në Bashkimin Evropian do të hapin tregje të reja dhe do të harmonizojnë kuadrin ligjor dhe rregullator. Më shumë se 90% e produkteve shqiptare tashmë kalojnë në tregun evropian pa detyrime doganore. Gjithashtu, Shqipëria ka Marrëveshje për Tregtinë e Lirë (MTL) me vendet e EFTA-s (Islandën, Lihtenshtajnin, Norvegjinë dhe Zvicrën) dhe Turqinë dhe operon sipas Sistemit të Përgjithshëm të Preferencave (SPP) me SHBA-të, Australinë, Japoninë, Zelandën e Re, Federatën Ruse, Bjellorusinë dhe Kazakistanin.

Tregtia e mallrave dhe shërbimeve në vitin 2019 përbën 77% të PBB-së dhe volumi i përgjithshëm i tregtisë është rritur vazhdimisht gjatë viteve të fundit. Megjithatë, Shqipëria eksporton më pak se shumica e vendeve në rajon, ku eksportet e mallrave dhe të shërbimeve përbëjnë 31.6% të PBB-së krahasuar me 40.1% në Bosnjë dhe Hercegovinë, 43.7% në Malin e Zi, 51.0% në Serbi dhe 62.3% në Maqedoninë e Veriut.[40] Eksportet janë rritur gjatë viteve të fundit (nga 29% në vitin 2016) por kanë shfaqur pak larmi për sa u përket produkteve dhe tregjeve.

Grafiku 4. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve




Vendet evropiane zënë 94% të eksporteve totale në vitin 2020. Italia është destinacioni kryesor i eksporteve, duke marrë më shumë se 45.4% të eksporteve të mallrave, e ndjekur nga Kosova (9.6%), Spanja (6.1%), Gjermania (5.8%), Greqia (4.8%) dhe Maqedonia e Veriut (3.3%).[41]

[40] Të dhënat e Bankës Botërore.
[41] Instituti i Statistikave në Shqipëri.

Tabela 9. Eksportet sipas produkteve 2020

| Produktet | Milionë lekë | % - pjesë tregu |
|---|---|---|
| Ushqime, pije, duhan | 39,050 | 14,4 |
| Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike | 39,915 | 14,7 |
| Produkte kimike dhe plastike | 7,409 | 2,7 |
| Lëkurë dhe prodhime lëkure | 1,811 | 0,7 |
| Prodhime druri dhe artikuj prej letre | 8,643 | 3,2 |
| Tekstile dhe këpucë | 102,344 | 37,6 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 41,809 | 15,4 |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi | 22,396 | 8,2 |
| Të tjera | 8577 | 3,2 |
| **Totali** | **271 955** | **100** |

*Burimi: Instituti i Statistikave në Shqipëri*

Fokusi i mallrave të eksportuara është mbi tekstilet dhe këpucët, materialet e ndërtimit, mineralet, lëndët djegëse dhe energjia elektrike, ushqimet, pijet dhe duhani. Eksportet e mjeteve të komunikimit dhe të teknologjisë së lartë përbëjnë 3.6% të mallrave të eksportuara, një normë shumë më e ulët se në vendet e tjera të rajonit e cila varion nga 23.5% në Malin e Zi në 59.6% në Maqedoninë e Veriut. Vlera e eksporteve të shërbimeve është tri herë më e lartë se ajo e eksporteve të mallrave. Shërbimet e udhëtimit dominojnë eksportet e shërbimeve.[42]

Pandemia COVID-19 dhe recensioni ekonomik që ajo solli në BE rezultoi në uljen e kërkesës nga vendet e rëndësishme të destinacionit, si: Italia, Spanja dhe Kosova. Eksportet ranë me 9% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Ndikimi negativ u ndie më shumë te mineralet, lëndët djegëse dhe energjia elektrike (-20%), lëkura dhe prodhimet e lëkurës (-6%) dhe tekstilet dhe këpucët (-13%). Ndërsa eksportet e ushqimeve, pijeve dhe duhanit (+10%) dhe makinerive, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit (+7%) shënuan rritjeve në vitin 2020. Kufizimet e udhëtimeve patën ndikim negativ në eksportin e shërbimeve turistike.[43]

**Grafiku 5 Fluksi i IHD-ve (milionë Euro)**




*Burimi Të dhënat e Bankës Botërore*

[42] Instituti i Statistikave në Shqipëri/ Të dhënat e Bankës Botërore.
[43] Instituti i Statistikave në Shqipëri.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive gjatë viteve të fundit, ekonomia shqiptare është integruar vetëm pjesërisht në zinxhirin e vlerave globale. Siç është theksuar në konsultimet me palët e interesit, eksportet mbeten të kushtëzuara nga barrierat jotarifore dhe mbështetja për NVM-të është e kufizuar. Sipas një raporti të fundit të Bankës Botërore, infrastruktura e cilësisë është forcuar, por ka ende disa pengesa, për shembull në fushën e procedurave sanitare dhe fitosanitare. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive të brendshme dhe të jashtme kufitare, kërkesat për dokumentacion, praktikat doganore joeficiente, kostot për procedurat e pajtueshmërisë me rregullat kufitare dhe mangësitë në infrastrukturën e transportit kufizojnë më tej tregtinë.[44] NVM-të mund të marrin mbështetje teknike nga AIDA, duke përfshirë për shembull informacion mbi tregun dhe asistencë në hartimin e planeve të marketingut. Ndihma financiare është dhënë përmes Fondit të Konkurrueshmërisë, i cili mbulonte, për shembull 70% të kostos së eksportit që lidhej me përmirësimin e produkteve dhe pjesëmarrjen në panairet tregtare ndërkombëtare. Përveç aktiviteteve *ad-hoc* të sistemeve të referimit *benchmarking*, Shqipëria ende nuk ka një program zyrtar qeveritar për të mbështetur integrimin e NVM-ve në zinxhirin e vlerave globale.[45]

**Investimet e huaja direkte (IHD)**

Fluksi i IHD-të është rritur ndjeshëm në dhjetë vitet e fundit - i nxitur, ndër të tjera, nga reformat e klimës së investimeve. Në vitin 2019, fluksi i IHD-ve arriti në më shumë se 1 miliard €, duke u rritur me 14.6% nga viti 2016. FDI-të neto zënë 7.6% të PBB-së – një nga vlerat më të larta në vendet e Ballkanit Perëndimor.[46]

Si pasojë e pandemisë COVID-19, fluksi i IHD-ve gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2020 u ul me 13.7% krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2019.[47]

Vendet e BE-ja mbeten burimi kryesor i IHD-ve në Shqipëri dhe në fund të vitit 2020 zënë 54.2% të stokut total të IHD-ve. Vendet kryesore të burimit të IHD-ve përfshijnë Zvicrën (18.9% të stokut), Holandën (16.2%), Kanadanë (12.8 %), Italinë (9.6 %) dhe Turqinë (7.2 %).[48]

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, 12,944 kompani të huaja janë aktive në territorin e Shqipërisë. Rreth 80% e tyre janë 100% me kapital të huaj (10,231), ndërsa pjesa tjetër janë ndërmarrje të përbashkëta (2,713). Pjesa më e madhe e këtyre kompanive (69%) operojnë në qarkun e Tiranës. Pjesa më e madhe e kompanive të huaja në Shqipëri janë me origjinë italiane (40%), të ndjekura nga ato me origjinë kosovare (8.8%), greke (6.4%) dhe turke (5.5%). Kompanitë e huaja/ndërmarrjet e përbashkëta operojnë në fusha të ndryshme të aktivitetit ekonomik.

Tabela 10. IHD sipas vendit të origjinës (tremujori i tretë)

| Vendi i origjinës | Përqindja e stokut të IHD-ve 2020 | Fluksi i IHD-ve (milionë euro) | |
|---|---|---|---|
| | | 2019 | 2020 |
| Zvicra | 18.9 | 39 | 45 |
| Holanda | 16.2 | 77 | 41 |
| Kanadaja | 12.8 | Nuk zbatohet | Nuk zbatohet |

[44] Banka Botërore (2019) Diagnostikimi Sistematik për Shqipërinë.
[45] OECD/ETF/BE/BERZH (2019), Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019, Vlerësimi i Zbatimit të Ligjit për Biznesin e Vogël për Evropën.
[46] Të dhënat e Bankës Botërore.
[47] Banka e Shqipërisë.
[48] Banka e Shqipërisë.

| | | | |
|---|---|---|---|
| Italia | 9.6 | 44 | 35 |
| Turqia | 7.2 | 9 | 21 |
| Austria | 6.6 | 5 | 15 |
| Bullgaria | 6.2 | 3 | 1 |
| Greqia | 5.7 | 3 | 3 |
| Franca | 3.8 | 6 | 17 |

Në fund të vitit 2018, energjia dhe miniera përbënin 40% të stokut total të IHD-ve, të ndjekura nga sektori i informacionit dhe komunikimit (16%) dhe shërbimet financiare (14%). Më pak se 10% e të gjitha IHD-ve në vend janë të fushën e manifakturës.[49] Siç është konfirmuar në diskutimet e grupeve të punës, lidhjet ndërmjet firmave të huaja dhe atyre lokale janë ende relativisht të dobëta.

**Klima e investimeve të huaja**

Klima e investimeve në Shqipëri është përmirësuar gjatë viteve të fundit. Sipas Indeksit 2019 të OECD-së për Kufizimet Rregullatore të IHD-ve, regjimi i IHD-ve në Shqipëri është më pak kufizues se sa mesatarja e OECD-së apo ekonomisë së BE-së, por më pak i hapur ndaj IHD-ve se sa vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Indeksi i IHD-ve mat kufizimet ligjore në investimet e huaja direkte në 22 sektorë të ekonomisë në 69 vende. Kufizimet vlerësohen me një shkallë nga 0 (të hapura) në 1 (të mbyllura) Rezultati i përgjithshëm i Shqipërisë është 0.057 krahasuar me 0.064 që është mesatarja e OECD-së.[50] Legjislacioni shqiptar për investimet është pjesërisht i përafruar me politikat e BE-së, dhe negociatat për aderimin në BE rrisin tërheqjen dhe reputacionin e vendit si destinacion investimi. Përveç regjimit të liberalizuar të investimeve, avantazhet e Shqipërisë përfshijnë pasurinë në vlera dhe burime natyrore për zhvillimin e mëtejshëm të agrobiznesit, turizmit dhe prodhimit të energjisë së rinovueshme, vendndodhjen e afërt me tregjet e mëdha dhe kostot operacionale konkurruese.

Në vitin 2017, Shqipëria prezantoi ligjin për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik (TEDA), me qëllim tërheqjen e IHD dhe promovimin e zhvillimit ekonomik. U përcaktuan një sërë zonash në të gjithë vendin, por ato janë ende në fazën e planifikimit/zhvillimit.

AIDA është agjencia e dedikuar për promovimin e investimeve dhe lehtësimin e dhënies së informacionit, kontakteve dhe mbështetjes për investitorët e mundshëm dhe ekzistues. Me qëllim tërheqjen e IHD-ve, në vitin 2015 qeveria miratoi ligjin për investimet strategjike, i cili përcakton stimujt për investime dhe ofron procedura administrative të shpejta për investitorët strategjikë përmes qendrës së shërbimit me një ndalesë që administrohet nga AIDA. Gjatë periudhës 2016–2020, janë miratuar 19 investime strategjike me një investim total prej 1.2 bilionë €. Projektet fokusohen kryesisht në turizëm, bujqësi, industri dhe energji. Gjithashtu, investitorët në fushën e energjisë dhe minierave, transportit infrastrukturës, turizmit, bujqësisë, manifakturës dhe BPO-së mund të aplikojnë për lehtësi fiskale, kryesisht në formën e përjashtimit nga/ulje të taksave dhe ulje të çmimit të qirasë së tokës. Në fund të vitit 2020, u zhvilluan tetë projekte me interes në fushën e investimeve në Shqipëri, kryesisht nga Gjermania dhe Italia si dhe nga Holanda, Kina dhe Japonia. Vlera totale e këtyre projekteve të investimeve arrin në rreth 94 milionë euro dhe parashikohet të hapen 4,090 vende të reja pune.

[49] BERZH (2019), Diagnostikimi i Shqipërisë 2019.
[50] Indeksi 2019 i OECD-së për Kufizimet Rregullatore të IHD-ve.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive, diskutimet në grupet e punës dhe palët e interesit në intervista kanë theksuar mungesën e një profili të qartë dhe ndërgjegjësimin e ulët të Shqipërisë si destinacion investimi. Gjithashtu, fusha e veprimit e kufizuar e paketës politike, e cila fokusohet në stimujt fiskalë (të bazuar në fitim), oferta e kufizuar e zonave të investimit dhe mungesa e zonave operacionale pengojnë rritjen e investimeve.

Duke ditur se Shqipëria aspiron për t'u bërë një vend kandidat për anëtar i BE-s, *benchmark*-u i BE-së është i rëndësishëm, por, gjithashtu, është i rëndësishëm krahasimi me vendet e Evropës Juglindore (SEE) në aspektin e konkurrueshmërisë.

**Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014–2020**

Në vitin 2014, u miratua Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014–2020 hartuar nga Ministria përgjegjëse për ekonominë. Për monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie janë hartuar tri raporte monitorimi, të cilat vlerësuan nivelin e zbatimit në masën 75%. Më konkretisht:

- Raporti i parë i monitorimit vlerësoi zbatimin e strategjisë, për periudhën 2015–2016;
- Raporti i 2-të i monitorimit vlerësoi zbatimin e strategjisë, për periudhën 2017–2018;
- Raporti i 3-të i monitorimit vlerësoi zbatimin e strategjisë, për vitin 2019 dhe periudhën janar–gusht 2020

Monitorimi për vitin 2020, vlerësoi se janë zbatuar 19 masa, janë 22 masa të zbatuara pjesërisht dhe 7 masa nuk u zbatuan.

Për monitorimin e SZHBI-së u zhvilluan takime në Ministrinë përgjegjëse për ekonominë me përfaqësues të institucioneve, në mënyrë që të njihen masat e Planit të Veprimit, duke qenë se në raportin e monitorimit 2016–2018, kjo strategji nuk ishte e njohur për shumicën e palëve të interesit. Një problem i përgjithshëm me të cilin u përballën të gjitha institucionet, ishte formulimi i paqartë i masave në Planin e Veprimit. Vihen re edhe mangësi, si:

- ndarja e pasaktë e kompetencave të institucioneve për zbatimin e masave;
- mosraportimi periodik i institucioneve për zbatimin ose jo të masave;
- masa me formulim të ndryshëm, por me të njëjtin kuptim.

Disa nga masat që nuk u zbatuan nga kjo Strategji janë përfshirë të zbatohen në Strategjinë e re 2021–2027. Për të shmangur disa nga problematikat e sipërcituara, gjatë hartimit të SZHBI-së 2021–2027 u krijuan katër grupe pune me përfaqësues të institucioneve të ndryshme dhe u punua me ta për propozimin e reformave dhe masave të reja prioritare.

Situata aktuale dhe reformat e vazhdueshme, në lidhje me mjedisin e biznesit janë përmbledhur si më poshtë:

**- Regjistrimi i një biznesi dhe aplikimi për licenca dhe leje është modernizuar.** Pas bashkimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Licencimit për të krijuar Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), më 2016, sipërmarrësit mund të marrin shërbime të tilla, si regjistrimi i biznesit, lejet dhe licencat në vetëm "një ndalesë". Krijimi i QKB-së ka luajtur një rol kryesor në uljen e burokracisë dhe procedurave të panevojshme për NVM-të.

**- Digjitalizimi i shërbimeve qeveritare që ka ulur barrën administrative për NVM-të**. Nga 1 janari 2020, filloi një proces i ri për shërbimet publike ai i ofrimit të 472 aplikimeve të shërbimeve publike për qytetarët dhe bizneset ekskluzivisht *online*. Qytetarët dhe bizneset aplikojnë vetëm *online* përmes platformës *e-Albania* dhe janë punonjësit e administratës publike që u kërkohet të sigurojnë të gjitha dokumentet shoqëruese shtetërore. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet qeveritare tani janë duke u përdorur dhe ripërdorur brenda administratës, duke lehtësuar qytetarët nga barra e mbledhjes së tyre fizikisht në kopje fizike në sportelet e shtetit. Është ngritur një sistem i dedikuar për ndërveprimin e të gjitha institucioneve, me qëllim shkëmbimin e të gjitha dokumenteve të bashkangjitura të dosjes së qytetarit në formë elektronike, pa letër dhe me nënshkrim elektronik. Kjo zvogëlon barrën

mbi qytetarët dhe bizneset në institucione dhe dokumentet e vetme që ata duhet të ngarkojnë janë vetëdeklarimet dhe dokumentet që ata marrin nga subjektet private. Në mënyrë që të zvogëlohen sa më shumë që të jetë e mundur burokracitë e lidhura me shërbimet publike, ata iu nënshtruan një procesi të derregullimit, me qëllim të:

- Reduktimit të numrit të dokumenteve shoqëruese që u kërkohen qytetarëve/bizneseve;
- Riinxhinierimit të të gjithë procesit të sigurimit të tyre, në mënyrë që të reduktohen hapat e proceduralë, të digjitalizohen proceset e brendshme duke ulur kështu burokracitë, kostot dhe kohën për qytetarët.
- Nga 1 janari 2020, Ministria përgjegjëse për ekonominë ofron përmes portalit qeveritar *e-Albania* 194 shërbime, si për biznesin ashtu edhe për qytetarët. Këto shërbime lehtësojnë biznesin e përditshëm, duke kursyer kohë dhe, gjithashtu, përmirësojnë ofrimin e shërbimeve. Pothuajse 100% e kompanive të regjistruara ngarkojnë pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit në internet. Shërbimet e zyrës së taksave 99.5% mund të bëhen *online*. Që nga prilli i vitit 2018 *e-Albanian* mund të mbështesë kompanitë të regjistrohen dhe të bëjnë pagesa në internet, por fatkeqësisht ky aplikacion nuk përdoret shumë nga biznesi, për shkak të qasjes dhe mentalitetit të tyre.

**- Reforma e derregullimit:** Me reformën e derregullimit, u propozua eliminimi i 21 licencave të siguruara nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Për këtë qëllim u hartuan 15 projektligje, që synojnë të ndryshojnë legjislacionin ekzistues të sektorit.

Për më tepër, për të lehtësuar më tej procesin e licencimit, nga QKB-ja janë propozuar si vijon:

- tetë licenca të zhvendosen nga grupi 3 në grupin 1;
- nëntë licenca të zhvendosen nga grupi 3 në grupin 2;
- 17 licenca të zhvendosen nga grupi 2 në grupin 1.

Propozimet për të lëvizur licencat nga një grup në tjetrin synojnë të thjeshtojnë procedurën për të shqyrtuar dhe dhënë një licencë dhe për të zvogëluar barrën dhe koston burokratike. Gjatë vitit 2018, procesi i vlerësimit të shërbimeve publike ka filluar nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara në Shqipëri (ADISA) në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe institucionet e saj në varësi. 15 institucionet vartëse të Ministrisë përgjegjëse për ekonominë ofrojnë gjithsej 511 shërbime publike për qytetarët/bizneset. Procesi i përgatitjes së karteleve informuese është finalizuar për këto shërbime.

**- Forcimi i infrastrukturës së cilësisë ka përmirësuar konkurrueshmërinë e NVM-ve**. Në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, Shqipëria ka bërë hapa të shpejtë në transpozimin e standardeve të Bashkimit Evropian dhe forcimin e kapaciteteve të saj institucionale për infrastrukturën e cilësisë.

**- Sipërmarrjet dhe NVM-të**. Që nga viti 2012, moduli i sipërmarrjes është përfshirë në sistemin e arsimit profesional dhe është akoma në proces përmirësimi. Ekziston një bashkëpunim midis shkollës arsimore profesionale dhe komunitetit të biznesit në mënyrë që të kombinohen nevojat dhe aftësitë e kërkuara nga kompanitë me cilësinë e studentëve të prodhuar nga këto shkolla arsimore profesionale. Çdo shkollë ka të paktën tre përfaqësues nga komuniteti i biznesit në bordin e tyre të menaxhimit.

**- NVM-të inovative.** Përparimi i NVM-ve inovative matet përmes inkubatorit dhe krijimit të klasterave. Gjatë vitit 2019 është themeluar klasteri i drurit. Programi GIZ/Fondi i Hapur Rajonal për Tregtinë e Jashtme ka ndihmuar partnerët shqiptarë për krijimin dhe forcimin e klasterit të Industrisë së Drurit WICA të Shqipërisë. Aktualisht, grupi ka 12 anëtarë themelues. *Green Ideas* është një konkurs vjetor i organizuar nga partnerët në Shqipëri, i cili synon të shërbejë si një inkubator për idetë e zhvillimit të gjelbër në shkallë të vogël në

Shqipëri, duke përdorur burimet lokale dhe duke ringjallur traditat e prodhimit dhe tregjeve të bazuara në komunitet në një mënyrë miqësore me mjedisin

**- Rritja e kapaciteteve institucionale që mbështesin NVM-të:** Gjatë vitit 2019, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) si promovuesi zyrtar i investimeve, zhvillimit të NVM-ve dhe agjencia e nxitjes së eksportit në Shqipëri kaloi në një reformë ristrukturimi. Në qershor 2019, Bordi i AIDA-s miratoi strukturën e re të AIDA-s, duke krijuar njësi dhe funksione të reja që mbulojnë çështje horizontale si koordinimi, kërkimi dhe shërbimet e *after-care*. Njësia e koordinimit është përgjegjëse për koordinimin me organizatat ndërkombëtare dhe aktorët e tjerë të interesuar, si dhe institucionet shqiptare. Kërkimi është përgjegjës për përgatitjen dhe përditësimin e informacionit, shënjestrimin etj. Në të ardhmen e afërt AIDA synon të zgjerojë rrjetin e bashkëpunimit me bashkitë e reja, si dhe me aktorë të tjerë të interesuar, në mënyrë që të jetë më afër biznesit. Gjatë vitit 2019 struktura u rrit nga 29 në 39 punonjës (34% rritje).

**- Grantet për mbështetjen e buxhetit të shtetit që mbështesin NVM-të.** Një nga funksionet kryesore të *Ministrisë përgjegjëse për ekonominë* është të mbështesë biznesin, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Aktualisht, kjo mbështetje sigurohet nga AIDA. Gjatë periudhës 2014–2019 shuma e buxhetit të shtetit ishte gjithsej 264 milionë lekë të dhëna për 373 biznese.

**Liberalizimi i tregtisë së shërbimeve me vendet në rajon**. Protokolli shtesë 6 në CEFTA hyri në fuqi në janar 2021 Aktualisht ka filluar puna për zbatimin dhe monitorimin i tij.

**Regjimi tregtar** nuk ka pësuar ndonjë ndryshim thelbësor dhe ka ruajtur nivelin e tij të përgjithshëm të hapjes gjatë vitit të kaluar. Hapja e tregtisë për vitin 2018, si një pjesë e PBB-së, arriti në 56%, ndërsa koeficienti i mbulimit të eksporteve/importeve tregoi një rritje të lehtë nga 43.6% për 2017 në 48.4% për 2018. Gjatë vitit 2019, eksportet e mallrave në vendet e BE-28 në 228.9 miliardë lekë, ose rreth 76.6% të eksporteve totale. Këto eksporte ranë me rreth 2.9% krahasuar me 2018-ën. Gjatë së njëjtës periudhë, importet e mallrave nga vendet e BE-28 arritën në 379.7 miliardë lekë, duke regjistruar një rënie në terma vjetorë me 3%. Importet nga këto vende zënë rreth 58.4% të importeve totale. Italia është destinacioni kryesor i eksporteve shqiptare, ku gjatë vitit 2019, kanë shkuar 47.9% e eksporteve totale. Për eksportet totale Spanja rezulton me 8%, Gjermania me 4.8% dhe Greqia me 4.3% Vende partnere të rëndësishme brenda BE-28 janë Italia me 62.5%, Spanja 10.5%, Gjermania 6.2% dhe Greqia 5.6%, Franca me 2%. Në të njëjtën kohë, pjesën kryesore në importet nga vendet e BE-28 e zë Italia me 43.2%, Greqia me 14.3% dhe Gjermania me 12.3%. Për importet totale, Italia zë 25.2%, Greqia 8.4% Gjermani 7.2%. Gjatë vitit 2019, eksportet e mallrave në vendet e CEFTA-s arritën në 51.4 miliardë lekë me një rritje vjetore prej 1.3%. Ato përbënin 17.2% të totalit të mallrave të eksportuara. Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 44.5 miliardë lekë ose rreth 6.9% të importeve totale, me një rënie në terma vjetorë prej 1.4%. Sipas të dhënave doganore, eksportet shqiptare në partitë e CEFTA-s janë rritur me 8% në vëllim dhe me 1% në vlerë gjatë vitit 2019 krahasuar me 2018.

**- Komiteti Kombëtar për Lehtësimin e Tregtisë** funksionon që nga viti 2016 si një platformë e brendshme për të lehtësuar çështjet tregtare dhe zbatimin e politikës ekonomike që prekin të gjithë zinxhirin e furnizimit. Gjatë vitit 2018 disa nga arritjet e këtij komiteti janë:

MAP REA u promovua në korrik 2018, si një plan veprimi teknik konkret duke iu referuar të gjitha masave në shtyllën tregtare.

- Studim mbi "Pengesën e eksporteve për produktet bujqësore".
- Inventari tarifor dhe pagesa e zbatueshme për importin dhe eksportin shqiptar.

- Studim paraprak për vlerësimin e kapacitetit të biznesit për të marrë statusin e Operatorit të Autorizuar Ekonomik

- Shqipëria, si kryesuese e CEFTA-s për vitin 2019, ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në mënyrë konstruktive në të gjitha takimet dhe aktivitetet e CEFTA-s. Për më tepër, gjatë kësaj kryesie, nga Takimi i Përbashkët Ministror, i mbajtur më 18 dhjetor 2019 në Tiranë, u miratuan vendime shumë të rëndësishme nga palët e CEFTA, të tilla si: vendimi për njohjen reciproke të statusit të AEO; protokolli AP 6 i Shtesave të Tregtisë së Shërbimit dhe Rekomandimi për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Rrezikut. Që nga viti 2018 zyrat doganore filluan deklaratën me porosi *online,* të cilat sjellin përmirësimin e shërbimit, bashkimin me zyrat e tjera doganore rajonale dhe të BE-së dhe kufizojnë korrupsionin. Kjo funksionon që nga viti 2019.

**Tërheqja e investimeve të huaja direkte**

- 100 spote publicitare, promovime janë realizuar në mediat e shkruara dhe vizive gjatë periudhës 2016–2018 të organizuara në vende të ndryshme të botës. Gjatë vitit 2016–2018 janë organizuar rreth 300 aktivitete promovuese, konferenca, panaire, ekspozita, forume, takime B2B etj.

- AIDA është aktori kryesor në tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri. Agjencia promovon dhe mbështet investimet e huaja direkte në Shqipëri në sektorë të ndryshëm dhe ndërmerr të gjitha iniciativat e nevojshme për zhvillimin e sektorit privat dhe përmirësimin e klimës së biznesit, duke ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e aktivitetit të tyre të biznesit, përmes ndërhyrjes dhe bashkëpunimi me subjektet e tregtisë së jashtme dhe organet shtetërore. Si një Agjenci ndërmjetëse midis investitorëve të huaj dhe Qeverisë së Shqipërisë, AIDA u siguron investitorëve akses në informacionin e azhurnuar, si dhe ndihmë gjatë vizitave të mundshme në terren dhe fazave të ndryshme të zbatimit të projektit. AIDA, gjithashtu, mbështet qëndrueshmërinë e kompanive ekzistuese dhe investimet përmes monitorimit të personalizuar dhe ndihmës së vazhdueshme *after-care*.

***Leading***

Drejtoria e Investimeve dhe *After-care* në AIDA arriti numrin e 13 projekteve kryesore deri në fund të vitit 2019, nga të cilat 2 janë materializuar. Shumica e këtyre projekteve *Lead* vijnë nga Italia dhe Gjermania, pasuar nga kompanitë greke, izraelite, koreane dhe japoneze, të cilat kanë shprehur interesin e tyre për të kryer projekte investimi në Shqipëri. Vlera totale e këtyre investimeve arrin në rreth 470 milionë euro, ndërsa numri i të punësuarve në këto aktivitete vlerësohet të jetë mbi 4400. Lidhur me fushat e veprimtarisë së këtyre projekteve, interesi kryesor ka qenë në sektorët e prodhimit, industrisë së automobilave, si dhe industrive nxjerrëse dhe përpunuese.

***After-care***

AIDA ofroi ndihmë për 26 kompani gjatë vitit 2019, duke identifikuar dhe ofruar zgjidhje për problemet e tyre përkatëse.

**Investimet strategjike**

Ligji nr. 55/2015 për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë ofron garancitë maksimale ligjore për investitorët e huaj. Ky ligj është i bazuar në dy elemente kryesore: zvogëlimin e rreziqeve kontraktuale dhe ligjore për investitorët e huaj dhe vendës dhe miratimin e procedurave "të shpejta". Gjithashtu, ai siguron një sistem efikas dhe efektiv për tërheqjen dhe mbështetjen e investitorëve vendës dhe të huaj në një nga sektorët strategjikë ekonomikë. AIDA (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve) është struktura administrative përgjegjëse, që ofron ndihmë për investitorët përmes një "dritare unike". AIDA mund të ndihmojë investitorët me të gjitha procedurat administrative dhe burokratike deri në përfundimin e projektit të investimit. Për më tepër, AIDA shërben si sekretaria teknike e KIS-

së. Investimet strategjike ndryshojnë në vlerë nga 1 në 50 milionë euro dhe në disa sektorë kërkohet të hapet një numër i caktuar i vendeve të lira të punës. Investimi strategjik është i gjithë investimi privat, publik ose publik - privat në sektorët strategjikë. Rezultatet e zbatimit të ligjit strategjik janë si më poshtë:

- 31 projekte – në proces asistimi nga AIDA;
- 9 projekte në fazë aplikimi;
- 27 projekte të miratuara nga KIS-i;
- 11 projekte të refuzuara nga KIS-i.

AIDA ka ndihmuar më shumë se 14 kompani. Periodikisht, janë zhvilluar takime me përfaqësues të ndryshëm të këtyre kompanive, të cilat kishin interes paraprak për të marrë statusin strategjik nga investitorët vendës dhe të huaj dhe u ndihmuan në përgatitjen e dokumentacionit përkatës. Lidhur me tremujorin e parë të vitit 2020, AIDA vlerësoi tri projekte të reja, kryesisht në turizëm, bujqësi dhe zonat e zhvillimit ekonomik teknologjik. Në procesin e ndihmës janë 17 projekte më shumë ku informacioni, në lidhje me procedurën strategjike të investimeve u shpërndahet kompanive. Për shkak të situatës së krijuar si rezultat i virusit korona në Shqipëri, AIDA, gjatë periudhës mars–prill 2020 ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me investitorë strategjikë. AIDA ka kontaktuar kompanitë përmes postës elektronike dhe telefonatave. Informacion rreth masave dhe planit financiar të miratuar nga Qeveria, të cilat kryesisht synojnë të lehtësojnë ndikimin negativ të situatës me të cilën përballen bizneset, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme u dërguan këtyre kompanive.

Në vitin 2019 është miratuar Strategjia Kombëtare për diasporën, me ligjin nr. 32/2018 për "Fondin Shqiptar të Zhvillimit për Diasporën". Agjencia zbatuese e kësaj strategjie është Fondi Shqiptar i Zhvillimit për Diasporën, i cili synon të sigurojë dhe alokojë burime financiare në kuadrin e promovimit të zhvillimit socio-ekonomik dhe kulturor, inkurajimin dhe promovimin e tendencave dhe investimeve filantropike në mbështetjen e zhvillimit të Diasporës në Republika e Shqipërisë dhe jashtë saj.

Në angazhimin e diasporës shqiptare për zhvillimin ekonomik të vendit është miratuar Strategjia Kombëtare për Diasporën (e rishikuar) me vendimin nr. 585, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave. Në funksion të këtij dokumenti janë miratuar ligji nr. 115, datë 18.12.2017, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës", ligji nr. 16, datë 5.4.2018, "Për diasporën" dhe ligji nr. 32/2018 për "Fondin Shqiptar të Zhvillimit për Diasporën". Agjencitë shtetërore të diasporës dhe veçanërisht Fondi Shqiptar i Zhvillimit për Diasporën, synojnë të sigurojnë burime financiare në kuadrin e promovimit të zhvillimit socio-ekonomik dhe promovimin e tendencave dhe investimeve në ekonominë shqiptare. Në këtë kuadër është miratuar edhe vendimi nr. 419, datë 27.5.2020, "Për miratimin e programit shtetëror për mbështetje në fuqizimin dhe angazhimin e diasporës shqiptare".

**Krijimi i zonave të lira dhe parqeve industriale (TEDA)**

Lidhur me ngritjen e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Elbasan, Ministria përgjegjëse për ekonominë negocioi kontratën me zhvilluesin "Italdruri Elbasan" LLC. Pas kësaj, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin e tij nr. 238, datë 20.3.2020, "Për miratimin e nënshkrimit të kontratës ndërmjet Ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe zhvilluesit', 'Italdruri Elbasan' LLC për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e teknologjisë zona e zhvillimit në Elbasani". Ministria përgjegjëse për ekonominë dhe zhvilluesi i saj "Italdruri Elbasan" nënshkruan kontratën dhe pajisur shoqërinë me licencën e zhvilluesit.

**TEDA në truall shtetëror**

Janë shpallur me vendim të Këshillit të Ministrave “TEDA Spitallë”, me sipërfaqe 49.1 ha dhe “TEDA Koplik” Malësi e Madhe, me sipërfaqe 62 ha. Së shpejti do të fillojnë procedurat për përzgjedhjen e zhvilluesit.

**TEDA me qeverinë qendrore ose zhvilluesin e njësive të qeverisjes vendore**

Bashkia e Tiranës, për projektin e TEDA Kashar, ka aplikuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për të marrë statusin e investitorit strategjik.

**Disa nga sfidat kryesore të evidentuara gjatë vlerësimit të SZHBI 2014–2020:**

- Strategjia e BID-së është një strategji shumë komplekse, që lidhet me objektivat të përgjithshëm (jo SMART) dhe aktivitetet e planifikuara e bëjnë shumë të vështirë për pasqyrimin e duhur të tij.
- Kjo strategji ka realizuar 75% të aktiviteteve, sipas planit të veprimit, por progresi sipas treguesve është shumë i ulët;
- Mungesa e treguesve të monitorimit të progresit. Kjo strategji ka tregues të përgjithshëm. Kjo e bën shumë të vështirë matjen e ndikimit të drejtpërdrejtë të planit të veprimit të strategjisë.
- Një nga aspektet kryesore të suksesit të strategjisë është komunikimi. Kjo strategji ishte e njohur nga disa aktorë gjatë fazës së hartimit dhe nuk kishte asnjë përfshirje gjatë periudhës së zbatimit të tij.
- Shpërndarja e aktiviteteve në dimensione të ndryshme dhe partnerët përgjegjës për zbatimin e tyre nuk ishin shumë të qarta.
- Ka disa aktivitete që përmenden në planin e veprimit, por nuk ka tregues monitorimi për ta matur atë, si për shembull arsimi, trajnimi, flukset e IHD-ve etj.
- Nuk ka një sistem monitorimi dhe vlerësimi sistematik (mujor, 3 muaj, 6 muaj dhe në vit). Për të marrë informacionin e kërkuar për pasqyrën e strategjisë është pothuajse e pamundur, sepse për këtë nevojiten përpjekje shtesë.
- Asnjë masë ndikimi. Kjo strategji ka bërë shumë përmirësime në regjistrimin e biznesit, pagesën e taksave, tregtinë dhe procedurat me porosi etj., por prapëseprapë sipas treguesve të të bërit biznes ne nuk renditemi shumë mirë ose ku duam të arrijmë. Arsyeja është se kjo strategji ka mungesë për matjen e ndikimit e çdo shërbimi që i ofron komunitetit të biznesit. Ky faktor është shumë i rëndësishëm, nëse dëshirojmë të përmirësojmë jo vetëm klimën e biznesit, por edhe kapacitetin e NVM-ve, IHD-të, eksportet etj., në vend dhe të ecim përpara.
- Ekzistojnë tri plane veprimi të hartuar brenda kësaj strategjie; *Triple Helix*, përgjegjësia e Korporatës Sociale dhe fuqizimi i sipërmarrjes së grave dhe nuk zhvillime për asnjë aktivitetet për t’i zbatuar ato.
- Asnjë koordinim jo vetëm brenda partnerëve të përfshirë në zbatimin e strategjisë, por edhe me donatorë dhe organizata të tjera që operojnë në fushën e promovimit të biznesit.

**1. Vizioni dhe misioni i dokumentit**

**Vizioni**

“Një ekonomi shqiptare konkurruese, e nxitur nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe më cilësore, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron transformimi digjital dhe transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, me theksin mbi zhvillimin e qëndrueshëm, integrimin evropian dhe atë rajonal”

**Misioni**

“SZHBI 2021–2027” ka një kohëzgjatje shtatëvjeçare, brenda së cilës synohet të arrihet jo vetëm sukses por dhe qëndrueshmëri në veprimet e planifikuara e të realizuara. Në tërësinë e saj “SZHBI 2021–2027” përbëhet nga një qëllim strategjike kryesor, ku zënë vend edhe objektivat specifikë, që reflektojnë nevojën për ndryshim apo shtimin e dimensioneve të reja drejt të cilave duhet të fokusohet vëmendja për adresimin e duhur të çështjeve të zhvillimit të

biznesit, bazuar dhe në zhvillimet më të fundit, si dhe duke konsideruar çështje të lidhura me zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës apo fushat e reja deri tani të paadresuara apo shumë pak të adresuara, në lidhje me zhvillimin e biznesit (digjitalizimi, kapitali njerëzor etj.).

Procesi i hartimit të kësaj Strategjie është udhëhequr nga parimet e mëposhtme:

**- Proces bashkëpunues** – duke përfshirë konsultime të vazhdueshme me palët e interesit gjatë të gjithë procesit;

**- Strategji e bazuar në prova** – përmes diagnostikimit të saktë, të përshtatur sipas nevojave specifike në faza të ndryshme;

**- Vlerësim i përvojës ndërkombëtare** – duke marrë në konsideratë dhe duke integruar praktikën e mirë në këtë drejtim;

**- Qasje specifike sipas kontekstit** – duke përshtatur strategjinë dhe veprimet me kontekstin specifik të vendit dhe veprimtaritë ekzistuese;

**- Qasje koherente** – duke siguruar një ndërveprim efektiv ndërmjet strategjive, fushave të ndërhyrjes dhe veprimeve të ndryshme;

**- Qasje e zbatueshme** – me fokus mbi masat efektive dhe realiste, duke marrë në konsideratë burimet dhe kapacitetet e disponueshme.

Duke marrë parasysh rezultatet e diagnostikimit fillestar, si dhe diskutimet në grupet e punës me ekspertët, *workshop*-in për hartimin e strategjisë dhe intervistat me ekspertë, SZHBI-ja e re është projektuar si një strategji ombrellë e zhvillimit ekonomik për NVM-të dhe investimet:

Duke përcaktuar transformimin strukturor të synuar dhe trajektoren e zhvillimit ekonomik;

Duke u fokusuar në objektivat e qartë të politikës dhe fushat e ndërhyrjes që trajtojnë mundësitë dhe sfidat kryesore për zhvillim ekonomik;

Duke krijuar një lidhje qendrore brenda kuadrit strategjik përmes shpalosjes së potencialeve, duke ndërlidhur programet dhe planet e veprimit, pa i mbivendosur me ato ekzistuese;

Duke vendosur theksin në nivelin horizontal dhe kombëtar;

Duke dhënë udhëzime për strategjitë e ardhshme tematike, rajonale dhe sektoriale përmes zhvillimit të veprimeve prioritare model, që mund të ndërmerren dhe të plotësohen.

SZHBI 2021–2027 do të luajë rolin siç përshkruhet në vijim:

**Roli dhe qëllimi i SZHBI-së së re brenda kuadrit strategjik përkatës**



Ky vizion është zbërthyer në një qëllim të politikës: "Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës".

Qëllimi i politikës është zbërthyer në tre objektiva:

Objektivi specifik 1.1: Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi

Objektivi specifik 1.2: Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni

Objektivi specifik 1.3: Zhvillimi i kapitalit njerëzor

**Objektivi specifik 1.1: Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi**

Kjo fushë e ndërhyrjes e vendos theksin mbi rëndësinë strategjike të investimeve dhe integrimit në zinxhirin e vlerave dhe tregjet ndërkombëtare për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm. Integrimi në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirin e vlerave ndërkombëtare luan një rol kritik në rritjen dhe diversifikimin e eksporteve dhe forcimin e konkurrueshmërisë dhe aftësive inovative të bizneseve lokale. Investimet mund të nxisin krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e të ardhurave, kontribuojnë në transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin e aftësive, duke stimuluar gjithashtu eksportet.

Megjithatë kushtet aktuale janë të vështira, me shkallën globale të HDI-ve në rënie që prej vitit 2016, rritjen e proteksionizmit në tregjet globale, si dhe nën ndikimin e rëndë të pandemisë COVID-19 në tregtinë ndërkombëtare, flukset e investimeve dhe zinxhirët e vlerave. Në të njëjtën kohë, ndryshimet në modelin e tregtisë dhe investimeve dhe tendencave të tjera që janë përshpejtuar nga pandemia COVID-19, të tilla si transformimi digjital, shpalosin, gjithashtu mundësi të reja. Siç është përmendur, Shqipëria është e pozicionuar mirë për të përfituar nga transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare dhe për të tërhequr grupe të reja investitorësh, pasi kompanitë në BE po riformësojnë zinxhirët e tyre të vlerave dhe po kërkojnë alternativa në vendet fqinje. Transformimi digjital, i cili luan një rol kyç në Strategjinë e re Industriale dhe të NVM-ve të BE-së, hap, gjithashtu, mundësi premtuese për përmirësimin e aksesit në tregje.

Në një situatë të tillë është thelbësore, që:

- Mekanizmat politikekzistues, të tillë si: promovimi i investimeve, masat mbështetëse për investimet strategjike, shërbimi i përkujdesjes së mëtejshme (*after-care*) dhe TEDA-t të jenë sa më efektive;
- Gama e mbështetjes zgjerohet duke kërkuar mënyra të reja, p.sh. promovimi i zgjidhjeve digjitale dhe ndërlidhjeve, me qëllim nxitjen e ndërkombëtarizimit të NVM-ve;
- Vendosja plotësisht në përdorim e sinergjive ndërmjet mjeteve dhe fushave të ndryshme të politikave, p.sh. të promovohet, gjithashtu, integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të sipërmarrjes
- Në këtë kontekst, veprimet në këtë fushë të ndërhyrjes synojnë arritjen e objektivave dhe të rezultateve të pritshme që shfaqen në figurën më poshtë, duke plotësuar dhe specifikuar objektivin e përcaktuar të politikës.

**Objektivat specifikë dhe rezultatet e pritshme[51] të fushës së ndërhyrjes "Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi"**

[51] Gjithashtu, është përcaktuar një strukturë e përqendruar për treguesit kryesorë të performancës (TKP) për çdo veprim prioritar, p.sh., sigurimi i 160 projekteve të riinvestimit në programin e përkujdesjes së mëtejshme, lehtësimi i një vlere prej 75 milionë në nënkontraktimeve për NVM-të lokale në programin e zhvillimit të ofruesve. TKP-të detajohen në fishat e veprimeve në aneks.




Faktori për sukses në rritjen e efektivitetit dhe ndikimit të përpjekjeve për tërheqjen e investimeve qëndron ndërtimin e një qasjeje të targetuar dhe sistematike, duke ndërtuar marrëdhënie me investitorët ekzistues dhe ata potencialë. Në kontekstin e transformimit të zinxhirit të vlerave ndërkombëtare dhe ndikimit të pandemisë COVID-19 në modelet e investimit, është e nevojshme të rishikohet fokusi i grupeve të synuara në masat për tërheqjen e investimeve dhe të zgjerohen instrumentet promovuese (p.sh., duke integruar mjetet digjitale). Fokusi kryesor është që grupet e synuara të rrisin rezistencën dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë në terma afatgjatë dhe të kontribuojnë në arritjen e OZHQ-ve. Përveç promovimit të investimeve të synuara, qasja sistematike ndaj përkujdesjes së mëtejshme ofron një potencial premtues për rritjen e investimeve dhe nxitjen e ndërlidhjeve me ekonominë lokale, me qëllim rritjen e ndikimit të zhvillimit.

Shfrytëzimi i mundësive të TEDA-ve në pikën e lidhjes ndërmjet tërheqjes së investimeve dhe integrimit ndërkombëtar luan, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në këtë kontekst. TEDA-t priten mirë nga investitorët dhe përdoren nga zonat më konkurruese. Aktualisht, ka ende një mungesë të zonave të përshtatshme dhe operacionale në Shqipëri, çka përbën një barrierë të madhe për investimet. Është e nevojshme të përshpejtohet zbatimi dhe të rritet efektivitetin e programit të TEDA-ve për të krijuar një portofol të orientuar drejt nevojave për grupe të ndryshme.

Në të njëjtën kohë është e nevojshme dhe ka potencial për zgjerimin e fushës së veprimit të politikës, si për shembull, për sa i përket prezantimit të trajnimeve, stimujve fiskale lidhur me K&ZH dhe kredi me interes zero për eksportuesit dhe investitorët. Gjithashtu, ka një potencial premtues për të eksploruar hapësira dhe sinergji të reja për të përmirësuar aksesin në tregje dhe për të nxitur integrimin e NVM-ve dhe sipërmarrjes në zinxhirin e vlerave dhe ekosistemet ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, ndërkombëtarizimi nuk trajtohet i veçuar, por në kontekstin e instrumenteve të tjera politike dhe fushave të ndërhyrjes. Promovimi i ndërlidhjeve ndërmjet investitorëve dhe ofruesve lokalë, si dhe zgjidhjeve digjitale për të mbështetur aksesin në treg konsiderohen si hapësira alternative efektive për të mbështetur eksportet dhe procesin e ndërkombëtarizimit të NVM-ve. Kjo zbatohet edhe për integrimin ndërkombëtar të ekosistemit të sipërmarrjes, për të nxitur dhe shkallëzuar aktivitetin e *startup*-eve dhe inovacionit, i cili përshkruhet në detaje të mëtejshme në kapitullin tjetër.

Intensifikimi i bashkëpunimit dhe i dialogut ndërmjet aktorëve konsiderohet një faktor gjithëpërfshirës për sukses. Kjo lidhet, ndër të tjera, me zgjerimin e mëtejshëm të përpjekjeve për bashkëpunim në fushën e diplomacisë ekonomike dhe forcimit të dialogut ndërmjet sektorit publik dhe atij privat – mbështetur nga Komiteti Kombëtar i Lehtësimit të Tregtisë – për të identifikuar dhe gjetur zgjidhje për problematikat e eksportit.

Tabela nr. 11 paraqet një panoramë të veprimeve prioritare të parashikuara në këtë fushë të ndërhyrjes të SZHBI-së 2021–2027. Detaje të mëtejshme (objektivat dhe TKP-të, institucionet përgjegjëse dhe burimet e nevojshme) gjenden në aneksin nr. 1.

Tabela 11. Masat në fushën e ndërhyrjes "Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi"

| Veprimet prioritare | Përshkrim përmbledhës |
|---|---|
| Promovimi /lehtësimi sistematik i investimeve të synuara | Fokusi kryesor i këtij prioriteti është intensifikimi i masave për promovimin dhe lehtësimin e investimeve specifike, sipas grupeve të synuara, duke reflektuar praktikën e mirë ndërkombëtare. Në kontekstin e transformimit të vazhdueshëm të zinxhirit të vlerave ndërkombëtare dhe ndikimit të fuqishëm të pandemisë COVID-19 në fluksin e investimeve, pika e nisjes do të jetë rishqyrtimi i hollësishëm i grupeve të synuara në përpjekjen për tërheqjen e investimeve.<br>Duke marrë parasysh ndryshimet në zhvillim në modelet e investimeve, rishikimi do të vlerësojë nevojën për të përshtatur ose plotësuar fokusin ekzistues të grupit të synuar, siç parashikohet në kornizën ligjore dhe strategjike (p.sh. TIK/BPO, automotive, agropërpunimin) dhe integrimin e mundësive të diasporës. Aktivitetet përkatëse nën Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal do të merren parasysh për të gjeneruar sinergji. Duke ndjekur një qasje të orientuar drejt zbatimit, përzgjedhja e ndryshuar e grupit të synuar jo vetëm që do t'i japë përparësi industrive, por segmenteve dhe pikave specifike. Bazuar në rishikimin do të zhvillohet një strategji koherente e promovimit të investimeve, e cila, gjithashtu, përshkruan propozimet specifike të vlerës për grupin e synuar dhe masat e komunikimit. Bazuar në eksperiencën e mëparshme, rishqyrtimi dhe zhvillimi i strategjisë së promovimit dhe mjetet e nevojshme të komunikimit janë parashikuar të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me partnerët dhe ekspertët ndërkombëtarë. Theks i veçantë do të vihet mbi mjetet digjitale. Gjithashtu është parashikuar që për argumentim të përdoret krahasimi i përfitueshmërisë së projekteve model të investimit dhe profilet e ambienteve industriale. Për më tepër do të integrohen masat për ngritjen e kapaciteteve në përputhje me nevojat.<br>Përmes një qasje sistematike dhe proaktive, fushata specifike, sipas grupeve të synuara do të zhvillohen rregullisht dhe gjatë të gjithë periudhës deri në vitin 2027. Në bazë të segmentimit të parashikuar do të kombinohen mjete dhe veprimtari të ndryshme promovimi (p.sh., fushata marketingu *"lead generation"* dhe |

| | |
|---|---|
| | evente virtuale) për të ndërtuar marrëdhënie me investitorët potencialë dhe për të tërhequr IHD në Shqipëri si edhe promovimin e investimeve për transformimin digjital, automatizimin e industrisë dhe investimet për ekonominë e gjelbër.<br>Bashkëpunimi ndërorganizativ luan një rol kritik për të arritur suksesin. Kjo lidhet, ndër të tjera, me zgjerimin e mëtejshëm të përpjekjeve për bashkëpunim nga AIDA, MEPJ-ja, ministri i Shtetit për Diasporën dhe ambasadave shqiptare në fushën e diplomacisë ekonomike. Gjithashtu, koordinimi ndërmjet ministrive, agjencive dhe aktorëve të tjerë në fushën e lehtësimit të investimeve duhet të forcohet, me qëllim sigurimin dhe ndjekjen e investimeve. |
| **Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme** | Kohët e fundit, roli i përkujdesjes së mëtejshme është përforcuar në të gjithë globin, në kushtet e ndërprerjes serioze të zinxhirëve ndërkombëtarë të vlerave, tregtisë dhe fluksit të investimeve që shkaktoi pandemia COVID-19. Megjithatë, përkujdesja e mëtejshme ofron një potencial premtues që shkon përtej krizës aktuale. Ajo konsiderohet si një mënyrë kosto-efektive për ruajtjen e investimeve, sigurimin e riinvestimeve dhe rritjen e ndikimit në zhvillim.<br>Siç e vërteton eksperienca praktike, deri në 70% e projekteve të IHD-ve lidhen me zgjerimin e riinvestimeve. Përkujdesja e mëtejshme sistematike ndihmon për të kuptuar ndikimin që kanë vendimet për vazhdimin e investimeve, të cilat mund të përfshijnë, gjithashtu, veprimtari me vlerë më të lartë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e strukturës industriale.<br>Në këtë kuadër, masat për përkujdesjen e mëtejshme do të përforcohen sipas këtij plani veprimi, bazuar në një qasje të strukturuar. Duke u bazuar në aktivitetet ekzistuese, p.sh., nga specialistët e AIDA-s për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme dhe eksperienca e marrë nga masat, në kuadër të mbështetjes nga donatorët, do të rritet ndjeshëm numri i investitorëve që do të marrin shërbim.<br>Do të përdoren kritere të mirëpërcaktuara për të vendosur nivelet dhe prioritetet e shërbimit brenda mjedisit të investitorit, të tilla si potenciali për riinvestime dhe punësim, roli i investitorëve në zinxhirin e vlerave, mundësitë për ndërlidhje, si dhe kontributi i tyre në eksport dhe dinamika e inovacionit.<br>Portofoli i shërbimeve të përkujdesjes së mëtejshme do të zgjerohet, duke u fokusuar veçanërisht në gjenerimin e sinergjive me veprimet e tjera prioritare. Kjo përfshin shërbimet në fushën e zhvillimit të aftësive dhe rekrutimit, promovimit të ndërlidhjeve dhe zhvillimit të ofruesve, gjetjen e hapësirave dhe ambienteve për zgjerim.<br>Do të zhvillohen/përditësohen vazhdimisht mjetet e nevojshme. Këto përfshijnë mjetet e komunikimit *online* dhe të drejtpërdrejta (p.sh., informacion mbi shërbimet e përkujdesjes së mëtejshme në |

| | |
|---|---|
| | faqen e internetit të AIDA-s, *webinare* me theksin mbi përfitimet nga perspektiva e investitorëve, bazuar në histori suksesi, aktivitete të mediave sociale, sistem MMK).<br>Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërorganizativ konsiderohet si një faktor kyç për sukses. Ka një gamë të gjerë institucionesh që ofrojnë shërbime mbështetëse për investitorët ose që luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e këtyre shërbimeve (p.sh. BDHTI, dhomat e tregtisë, shoqatat, bashkitë). Shërbimet e përkujdesjes së mëtejshme do të zgjerohen, duke ndjekur një qasje bashkëpunuese për të shmangur dublikimin dhe konfuzionin tek investitorët ekzistues. Theks i veçantë do të vendoset në forcimin e ndërlidhjeve midis qeverisjes qendrore dhe bashkive nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit që do të lidhen me AIDA-n dhe bashkitë. |
| **Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve** | Shfrytëzimi i mundësive të TEDA-ve luan një rol kritik në rrugën e dëshiruar për zhvillim, në veçanti për sa i përket shpalosjes së potencialeve në kontekstin e transformimit të zinxhirit të vlerave ndërkombëtare. TEDA-t priten mirë nga investitorët dhe përdoren nga zonat më konkurruese. Duke tërhequr investime në sektorin e eksporteve, TEDA mund të japin një kontribut të rëndësishëm në integrimin në zinxhirin e vlerave dhe tregjet ndërkombëtare. Aktualisht ka ende një mungesë të zonave të përshtatshme dhe operacionale në Shqipëri, çka përbën një barrierë të madhe për investimet. Si rezultat, është e nevojshme që të ndiqet zbatimi i shpejtë dhe të rritet efektiviteti i TEDA-ve.<br>Në këtë kuadër, ky veprim prioritar ka si pikënisje kryerjen e një vlerësimi të thelluar të programit të TEDA-ve në bashkëpunim të ngushtë me një partner ndërkombëtar. Është parashikuar që një ekip ekspertësh ndërkombëtarë të kryejë vlerësimin, duke përfshirë, ndër të tjera, një krahasim me vendet fqinje dhe një analizë të nevojave të investitorëve dhe praktikës së mirë ndërkombëtare.<br>Do të zhvillohet një strategji për reformën bazuar në vlerësimin e mundësive për rritjen e efektivitetit të TEDA-ve – me theksin në dimensionet e mëposhtme:<br>**- Fokusi strategjik:** përcaktimi i objektivave, TKP-ve, prioriteteve strategjike dhe llojeve të zonave të parashikuara (p.sh., Zonat e Inovacionit të Bashkisë) nga një këndvështrim dinamik ku fokusi përputhet me zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë dhe merr parasysh strategjitë përkatëse siç është Strategjia e Specializimit Smart.<br>**- Oferta:** kalimi përtej stimujve, duke vendosur theks të veçantë mbi infrastrukturën dhe shërbimet e orientuara sipas grupeve të synuara (p.sh. qendrat e formimit "modelet gjysmë të gatshme" *(plug and play*) me objekte të ndërtuara më parë).<br>**- Kuadri ligjor dhe institucional:** vlerësimi i nevojës për përshtatje të kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional, duke marrë, |

| | |
|---|---|
| | gjithashtu, në konsideratë modelet e ndryshme të PPP-ve, me detyra të ndara qartë (p.sh. lidhur me infrastrukturën dhe shërbimet brenda dhe jashtë zonës) dhe duke qartësuar rolin e Korporatës Shqiptare të Investimeve.<br>- **Promovimi:** dhënia e rekomandimeve mbi mënyrën e intensifikimit të promovimit të TEDA-ve duke përdorur sinergjitë ndërmjet zonave dhe institucioneve të tjera (p.sh., AIDA).<br>- Gjithashtu**, për një TEDA** – që do të përzgjidhet duke pasur në konsideratë përshtatshmërinë e vendndodhjes, potencialin për investime dhe fizibilitetin financiar – do të hartohet një koncept zhvillimi. Duke reflektuar nevojat e grupeve të synuara, ky koncept siguron bazën për zhvillimin e infrastrukturës brenda zonës dhe jashtë saj (p.sh.: rruga hyrëse, lidhja me shërbimet, lehtësirat teknike), duke marrë në konsideratë mundësitë për të vijuar me qasjen me faza. Koncepti i zhvillimit duhet të japë udhëzime për caktimin e zonave të tjera. |
| | |

| ***Veprimet prioritare*** | ***Përshkrim përmbledhës*** |
|---|---|
| ***Vlerësimi i modelit të diplomacisë ekonomike*** | *Modeli ekzistues i diplomacisë ekonomike do të vlerësohet bazuar në takime teknike me ekspertë dhe palë të interesuara (si, p.sh., ministritë, agjencitë, misionet diplomatike, shoqatat e biznesit dhe ekspertët ndërkombëtarë), si edhe në një analizë të përvojës dhe praktikës më të mirë ndërkombëtare. Objektivat që synohen janë:*<br>*- Rritja e efektivitetit dhe eficiencës së aktiviteteve të diplomacisë ekonomike;*<br>*- Promovimi i interesave ekonomike dhe marrëdhënieve që nxisin integrimin rajonal dhe në BE.*<br><br>***Aktiviteti"** Vlerësimi i modelit ekzistues të diplomacisë ekonomike dhe identifikimi i opsioneve të reformës në periudhën 2025–2027.*<br>***Institucionet përgjegjëse:** MEPJ, MEKI dhe AIDA* |

***Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara***

| ***Treguesit*** | **Baza bazë (viti 2024)** | ***Vlera e synuar*** | | |
|---|---|---|---|---|
| | | ***2025*** | ***2026*** | ***2027*** |
| *Vlerësimi i kryer* | | *Vlerësimi u finalizua* | | |
| *Kuadri ligjor/rregullator për modelin e reformuar të diplomacisë ekonomike* | | | *Miratuar* | |
| | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Strategjia e eksportit** | Integrimi në tregjet ndërkombëtare luan një rol kritik në rritjen dhe diversifikimin e eksporteve dhe nxitjen e konkurrueshmërisë së bizneseve lokale. Një shportë e larmishme eksportesh forcon më tej qëndrueshmërinë ekonomike. Në të kaluarën, shumë vende kanë zgjeruar paketate tyre të politikave për të mbështetur veprimtaritë e eksporteve dhe proceset e ndërkombëtarizimit bazuar në strategji eksporti që u japin përparësi industrive, produkteve dhe tregjeve.<br>Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë do të hartohet strategjia e eksporteve. Kjo strategji do të fokusohet në rritjen e sofistikimit të eksporteve për firmat vendëse në industritë me potencial të lartë për rritjen e eksporteve.<br>Studimet dhe raportet e fundit nga organizata ndërkombëtare si Banka Botërore do të përbëjnë pikën e nisjes për të analizuar performancën aktuale të eksporteve për sa i përket cilësisë, volumit, produkteve/shërbimeve dhe destinacioneve të rëndësishme si dhe faktorëve kryesorë që nxisin apo pengojnë konkurrueshmërinë e bizneseve eskportuese.<br>Përmes përdorimit të metodologjive të provuara ndërkombëtarisht, të tilla si hapësira e produkteve apo harta e eksporteve e Qendrës Ndërkombëtare të Tregtisë dhe duke u bazuar në analizat ekzistuese (p.sh. "Çlirimi i Potencialit të transformimit për zhvillim në Ballkanin Perëndimor" nga OECD-ja), do të evidentohen industritë lider në eksport me perspektivë të madhe për rritje/diversifikim dhe ku Shqipëria mund të konkurrojë ndërkombëtarisht.<br>Për industritë e zgjedhura do të kryhen vlerësime të tjera tregu për të identifikuar nxitësit kryesorë të avantazhit konkurrues, potencialet e tjera për diversifikimin e produkteve, tregjet e synuara, dhe strategjitë për pozicionimin e duhur dhe hyrjen në treg.<br>Potenciali i masave të mëtejshme të promovimit dhe lehtësimit të eksportit do të vlerësohet bazuar në praktikën e mirë ndërkombëtare. Nismat/veprimet kryesore të kërkuara për të nxitur rritjen e eksportit mund të përfshijnë masa për të eliminuar pengesat e eksportit, si dhe stimuj dhe masa për ndërtimin e kapaciteteve, për shembull trajnime të orientuara drejt nevojave, ose një markë tregtare *"Made in Albania"*. Mjetet dhe zgjidhjet digjitale janë me rëndësi kryesore për rritjen e efektivitetit dhe nxitjes së eksportit. Mjetet digjitale mund të përfshijnë informacione dhe platforma të aplikimit në internet, *webinare*, panaire virtuale tregtare dhe eksplorim të tregut digjital.<br>Iniciativat do të detajohen duke u fokusuar, ndër të tjera, në arritjen e objektivave, përgjegjësive dhe burimeve të nevojshme kombëtare lidhur me performancën e eksporteve, gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë.<br>Procesi i hartimit të strategjisë do të përdoret, gjithashtu, për të | | | |

| | |
|---|---|
| | intensifikuar dialogun ndërmjet sektorit publik dhe privat, me qëllim identifikimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për problemet e eksportit. Komiteti Kombëtar për Lehtësimin e Tregtisë do të marrë një rol proaktiv dhe do të mbështesë konsultimet në baza të rregullta - edhe përtej zhvillimit të strategjisë së eksporteve. |
| **Iniciativa e zhvillimit të tregtisë elektronike dhe digjitalizimit të bizneseve** | Ekziston një potencial për të eksploruar hapësira të reja për përmirësimin e aksesit në tregje dhe konkurrueshmërisë përmes transformimit digjitale. Tregtia elektronike (*e-Commerce*) dhe *e-Business* po shndërrohen me shpejtësi në një pjesë integrale të ekonomisë globale dhe ekonomia digjitale ka potencialin të luajë një rol të rëndësishëm në kapërcimin e pengesave madhore për tregtinë. Tendenca drejt mjeteve dhe transformimit digjitale është theksuar në strategjitë e fundit të BE-së si Strategjia për NVM-të dhe Strategjia Industriale. Pandemia COVID-19 po e përshpejton më tej këtë trend digjitalizimi.<br>Një kornizë e plotë ligjore dhe aftësitë e forta digjitale janë një përbërës thelbësor për zhvillimin e tregjeve *online* të Shqipërisë dhe zbatimin e proceseve digjitale në NVM-të.<br>Në këtë kuadër dhe në bazë të draftraportit "Mbështetje për digjitalizimin e NMVM-ve në Shqipëri për të zbutur ndikimin negativ ekonomik të COVID-19" të hartuar me asistencën e BERZH-it dhe të "Raportit diagnostifikues për tregtinë elektronike" të hartuar nga Banka Botërore dhe planit të veprimit të zhvilluar nga grupi ndërministror i punës për tregtinë elektronike, ky veprim prioritar fokusohet në hartimin e iniciativës së zhvillimit të *e-Busines* për të mbështetur sipërmarrësit dhe NVM-të, përmes përdorimit të sinergjive me masat e parashikuara në Agjendën e re Digjitale dhe Planin e Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal.<br>Kjo iniciativë do të zhvillohet dhe zbatohet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, duke u bazuar në praktikën e mirë ndërkombëtare dhe duke kombinuar lloje të ndryshme ndërhyrjesh për të rritur aftësitë e NVM-ve në tregtinë elektronike dhe biznesin elektronik, përfshirë, dhe jo vetëm:<br>- Fushata ndërgjegjësuese të organizuara nga AIDA për të inkurajuar më shumë NVMM për të filluar tregtinë elektronike.<br>- Publikimi në faqen e internetit të AIDA-s i instrumentit digjital të vetëvlerësimit për NVM-të , i cili do të japë informacion që shpjegon se çfarë duhet të marrin parasysh kompanitë kur miratojnë zgjidhjet e tregtisë elektronike dhe të *e-Busines*. Ai do të përmbajë informacion për legjislacionin në fuqi dhe programet mbështetëse, një mënyrë vetëvlerësimi digjitale, një udhëzues me hapa mbi vendimet dhe investimet që do të marrë biznesi dhe raste studimore të bizneseve vendëse që kanë zbatuar me sukses aplikacione të tregtisë elektronike dhe *e-Busines*.<br>- Publikimi në faqen e internetit të AIDA-së i një udhëzuesi se si të ndihmohen NVM-të që të fillojnë tregtinë elektronike<br>- Trajnime mbi tregtinë elektronike të ofruara nga AIDA për të |

| | |
|---|---|
| | ndihmuar NVM-të të fillojnë tregtinë elektronike, duke ofruar programet e trajnimit për NVM-të. Programet e trajnimit do të përfshijnë tema si strategjitë e ndërtimit të faqes së internetit, ERP *software*, modalitetet e pagesave, sigurinë kibernetike, fatura elektronike dhe module specifike sipas grupeve të synuara (p.sh. shitjen e shërbimeve të mikpritjes). Pjesëmarrësit mund të përfitojnë nga udhëzimet shtesë kur zbatojnë zgjidhjet e tyre individuale të tregtisë elektronike dhe biznesit elektronik.<br>- Krijimi i një portali të tregut digjital me një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse të ofruesve të shërbimeve të specializuara dhe produkteve të tyre. Sipërmarrjet mund të përdorin bazën e të dhënave për të kërkuar kompani për t'i ndihmuar ata në transformimin digjital.<br>- Gjatë hartimit të skemave të granteve për SME-të, sipas përcaktimeve në objektivin 1.2 do të mbahet në konsideratë përfshirja e financimeve edhe të kostove të pranueshme që lidhen me *e-Busines*/tregtinë elektronike.<br>- Në kuadër të Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal është parashikuar adaptimi i një vendimi në nivel CEFTA për lehtësimin e tregtisë elektronike.<br>- Për të siguruar një bazë të plotë ligjore për zhvillimin e biznesit elektronik, aspektet e bazës ligjore do të rishikohen dhe rregullohen aty ku është e nevojshme. |

**Objektivi specifik 1.2: Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni**

Fusha e dytë e ndërhyrjes e Strategjisë së re njeh dhe pranon kontributin e rëndësishëm që mund të japin NVM-të – si shtylla kurrizore e ekonomisë – dhe *startup*-et për një ekonomi më inovative dhe të bazuar në njohuri, duke krijuar vende pune cilësore dhe përmirësuar strukturën ekonomike. Ajo pranon, gjithashtu, se ekosistemi sipërmarrës dhe inovativ është ende në fazë të hershme, dhe pavarësisht disa mjediseve optimale dhe rasteve të suksesit, "masa kritike" që i lejon organizatat mbështetëse të ndryshojnë portofolin e tyre dhe të bëhen të pavarura nuk është arritur ende.

Pra, është e nevojshme që veprimtaritë e *startup*-eve dhe ato inovative të rriten gradualisht dhe të promovohet specializimi dhe ndërlidhjet, me qëllim që të arrihet "masa kritike", duke u fokusuar në sektorët dhe zinxhirët e vlerave me potencial më të lartë. Në këtë kontekst, në këtë fushë të ndërhyrjes është parashikuar një qasje e targetuar që promovon bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe specializimin inteligjent.

Objektivi i politikës, si dhe objektivat specifikë në këtë fushë të ndërhyrjes, që shfaqen në figurën më poshtë marrin në konsideratë faktin se kushtet aktuale janë të vështira për *startup*-et dhe NVM-të. Ndër të tjera, kjo lidhet me aksesin në financë dhe në tregje, ndikimin e pandemisë COVID-19, si dhe sfidat në kontekstin e transformimit të gjelbër dhe atij digjital.

**Objektivat specifikë dhe rezultatet e pritshme[52] të fushës së ndërhyrjes "Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni"**




Duke marrë në konsideratë nevojat e ndryshme, fokusi kryesor i objektivit të parë strategjik është te zhvillimi dhe shfrytëzimi i potencialit për inovacion dhe rritje, ndërsa objektivi i dytë adreson më në thellësi ekosistemin e sipërmarrjes dhe *startup*-eve. Në të gjithë fushën e ndërhyrjes, një theks i veçantë vendoset në promovimin e aftësive sipërmarrëse të grave dhe krijimin e një klime favorizuese për rritjen e numrit të grave sipërmarrëse dhe madhësisë së bizneseve ekzistuese që drejtohen nga gratë.

Masat për përmirësimin e aksesit në financë konsiderohen me rëndësi kritike për forcimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve dhe *startup*-eve. Është e nevojshme të shtohen skemat e granteve për NVM-të dhe të hartohen mjete dhe instrumente të reja financiare, të tilla si: garancia shtetërore, kapitali sipërmarrës dhe financimi *crowdfunding*. Kjo kërkon ndryshim të kuadrit ligjor.

Kushtet aktuale janë sfiduese për *startups* dhe NVM-të. Ndër të tjera, kjo lidhet me qasjen në financa dhe ndikimin e pandemisë COVID-19. Në mënyrë që të zhbllokojë plotësisht potencialet e sipërmarrjes, nevojitet një qasje me bazë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse, e cila zgjeron mbështetjen për grupet e synuara përtej "*startups inovative*" dhe kombinon ndihmën financiare me mbështetjen e trajnimit dhe mentorimit.

Për të mbështetur NVMM-të që përballen me situatën e përgjithshme sfiduese gjatë krizës COVID-19, pjesë e këtij veprimi prioritar është GIZ Advisory Facility CoSolve-19, program dyvjeçar, i cili ofron shërbime këshilluese dhe me mundësinë shtesë për të marrë grante të vogla në mënyrë që të përshtaten operacionet e biznesit me situata e re për SME-të. Vijimi i programeve të tilla nga donatorët është i mirëpritur.

Eksperienca ndërkombëtare tregon se skemat mbështetëse të përgjithshme për NVM-të dhe sipërmarrjen duhet të plotësohen me masa të cilat promovojnë ndërlidhjet dhe projektet bashkëpunuese. Rrjedhimisht, forcimi i lidhjeve ndërmjet të gjithë aktorëve dhe

[52] Gjithashtu, është përcaktuar një strukturë e përqendruar për treguesit kryesorë të performancës (TKP) për çdo veprim prioritar, p.sh., 60 zgjidhje për tregtinë elektronike që adoptohen nga NVM-të, 100 biznese të reja të regjistruara në vit nga pjesëmarrësit në skemën mbështetëse të sipërmarrjes bazuar në konkurrencë. TKP-të detajohen në fishat e veprimeve në aneks.

komponentëve të ekosistemit të sipërmarrjes dhe inovacionit përbën një faktor gjithëpërfshirës për sukses. Kjo përfshin forcimin e lidhjeve ndërmjet aktorëve të spirales së trefishtë në vend, por, gjithashtu, dhe integrimin ndërkombëtar të ekosistemit për të rritur veprimtaritë e *startup*-eve dhe inovacionit.

Së fundi, për të shpalosur potencialin e specializimit inteligjent dhe për të arritur "masën kritike" për procese zhvillimi të pavarura është e nevojshme të eksplorohen mënyra të reja për t'u përqendruar dhe për të bashkëpunuar në zinxhirët e vlerave, duke përfshirë të gjithë aktorët – nga *startup*-et te kompanitë e mëdha, nga NVM-të lokale tek investitorët ndërkombëtarë, nga akademia te kërkimi, nga institucionet mbështetëse publike te BDHTI-ja dhe shoqatat e tregtisë.

Për të përmbushur rolet e reja, një sektor i ri mbi trajnimin do të shtohet në strukturën e AIDA brenda 2021, i përbërë nga një përgjegjës sektori dhe dy specialistë.

Në këtë kontekst, tabela nr. 12 paraqet një panoramë të veprimeve prioritare të parashikuara në këtë fushë të ndërhyrjes të SZHBI-së, 2021–2027. Detaje të mëtejshme (objektivat dhe TKP-të, institucionet përgjegjëse dhe burimet e nevojshme) gjenden në aneksin nr. 1.

ANEKS NR. 1
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M 1.1.4 – Programi i ekonomisë qarkulluese industriale dhe zhvillimi i parqeve ekoindustriale**

**Objektivat:**

- Zhvillimi i modeleve të bashkëveprimit industrial, përmes ripërdorimit eficient të mbetjeve të ngurta, biombetjeve dhe riciklimit të ujërave të ndotura industriale, në zbatim të detyrimeve të kuadrit rregullator shqiptar të përafruar me *acquis*-in e Bashkimit Evropian për ekonominë qarkulluese.
- Pilotimi i modelit të parqeve ekoindustriale, duke u bazuar në projektet e zhvillimit të *Durana Tech Park* dhe TEDA Tirana, si modele referencë për të gjithë vendin.

**Përshkrimi:** Kjo masë strukturohet si një program i vetëm dhe i integruar i ekonomisë qarkulluese, i cili operon nëpërmjet dy komponentëve ndërlidhës për të nxitur bashkëveprimin dhe eficiencën e burimeve në industrinë përpunuese. Komponenti i parë fokusohet në vlerësimin e kuadrit rregullator për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, biombetjeve dhe riciklimit të ujërave të ndotura në sektorin e industrisë dhe pilotimin e modeleve të bashkëveprimit nëpërmjet skemave nxitëse për eficiencën e burimeve. Komponenti i dytë adreson kuadrin rregullator të parqeve ekoindustriale (EIP) dhe hartimin e studimeve të fizibilitetit për projektet pilote. Ky proces do të zbatohet në partneritet me IFC-në, Korporatën Financiare Ndërkombëtare (grupi i Bankës Botërore) dhe SECO-n, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit MEI – IFC, të nënshkruar më 17 mars 2025.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Vlerësimi i kuadrit rregullator për ekonominë qarkulluese, si edhe pilotimi i modeleve dhe skema e eficiencës së burimeve | 2026–2030 | Ministria e Mjedisit, AIDA, MEI, AKM |

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 2. Korniza EIP dhe fizibiliteti për *Durana Tech Park* e TEDA Tirana | 2026–2028 | MEI, AIC, IFC/IBRD, SECO |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Mbetje industriale të riorientuara nga landfilli drejt riciklimit (të dhënat për matjen referuar DSIP e *Industrial Emission Directive*). | Matja 2026 | 10% (2029) | ≥ 30% |
| NVM me protokolle qarkulluese/plane të gjelbra të zbatuara | 0 (2025) | 15 (2028) | 40 |
| Ndërmarrje në parqet pilot, sipas standardeve EIP | 0% (2025) | 30% (2028) | 60% |

ANEKS NR. 2
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M 1.1.5 – Përgatitja e industrisë për tregun e gjelbër në tregun e përbashkët (MRV, Gatishmëria CBAM dhe eficienca e energjisë në prodhim)**

**Objektivat:**

- Funksionalizimi i kuadrit kombëtar për monitorimin, raportimin, verifikimin dhe akreditimin (MRVA) të emetimeve të gazeve serrë, në përputhje me direktivën 2003/87/KE dhe rregulloret zbatuese (BE) 2018/2066 dhe 2018/2067, mbështetja e ndërmarrjeve industriale për zbatimin e kërkesave të MRVA-së dhe zhvillimi i kapaciteteve kombëtare për ofrimin e shërbimeve të verifikimit.
- Rritja e gatishmërisë teknike të ndërmarrjeve eksportuese për t'u përshtatur me kërkesat e rregullores (BE) 2023/956, e ndryshuar, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 10 maj 2023, për krijimin e mekanizmit të rregullimit të karbonit në kufij (CBAM), përfshirë llogaritjen dhe dokumentimin e emetimeve të trupëzuara, mbështetjen për verifikimin e të dhënave dhe transmetimin e informacionit te importuesit në Bashkimin Evropian.
- Mbështetja e ndërmarrjeve prodhuese për reduktimin e intensitetit energjetik dhe adoptimin e masave të eficiencës, duke lehtësuar integrimin e vetëkonsumit të energjisë së rinovueshme (RES) në proceset e tyre të prodhimit.

**Përshkrimi:** Masa fokusohet në mbështetjen praktike të industrisë shqiptare, veçanërisht të sektorëve me intensitet të lartë karboni, për zbatimin e kuadrit kombëtar për monitorimin, raportimin, verifikimin dhe akreditimin e emetimeve të gazeve serrë (MRVA). Ndërmarrjeve do t'u ofrohet asistencë teknike për ngritjen e sistemeve të brendshme të menaxhimit të të dhënave, hartimin e raporteve të emetimeve dhe për procesin e verifikimit të tyre. Paralelisht, do të mbështetet zhvillimi i kapaciteteve kombëtare për ofrimin e shërbimeve të verifikimit nga organe verifikuese të akredituara, përmes trajnimit të profesionistëve të parë të verifikimit, përgatitjes së organeve verifikuese kandidate dhe ngritjes së kapaciteteve të DPA-së për vlerësimin dhe akreditimin e tyre. DPS-ja do të mbështesë shqyrtimin dhe adoptimin e standardeve teknike përkatëse të Be-së në standardet shqiptare.

Komponenti i gatishmërisë CBAM do të zbatohet si një linjë e veçantë asistence teknike për ndërmarrjet eksportuese në sektorët e përzgjedhur (si çimento, metalurgjia), me qëllim

përshtatjen e tyre me kërkesat e rregullores (BE) 2023/956, e ndryshuar. Mbështetja do të përfshijë llogaritjen dhe dokumentimin e emetimeve të trupëzuara në mallra, përgatitjen dhe verifikimin e të dhënave përkatëse dhe transmetimin e informacionit te importuesit në Bashkimin Evropian. Për të kaluar nga një sistem raportimi (MRV) te reduktimi real i emetimeve, kjo masë do të ofrojë asistencë teknike dhe shërbime këshillimore për ndërmarrjet që të auditojnë konsumin e tyre, të hartojnë planet e veprimit të eficiencës së energjisë (kjo aktualisht është detyruese për konsumatorët e mëdhenj të energjisë, ndërkohë, duke qenë se ndërmarrjet do t'u nënshtrohen auditimit, është e arsyeshme për të kërkuar dhe hartimin e një plani, si dhe ndoshta edhe punësimin e një menaxheri energjie) dhe të aplikojnë skema të vetëprodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme (si p.sh. solare në tarraca apo brenda zonave TEDA/parqeve industriale). Kjo masë do të jetë gjithashtu plotësuese me masën 1.2.9, ku ndërmarrjet që e kalojnë fazën e auditimit të energjisë mund të aplikojnë për grante në projektet e tyre të investimit për teknologji të reja, që synojnë dekarbonizimin. Ndërsa kjo masë synon posaçërisht tranzicionet teknologjike dhe të eficiencës së energjisë brenda proceseve të prodhimit industrial, sipas kapitullit 20, dekarbonizimi më i gjerë dhe tranzicioni i sistemit kombëtar të furnizimit me energji trajtohen nga Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (NECP) nën kuadrin e kapitullit 15. Për më tepër, masa do të mbështesë industritë eksportuese në përshtatjen me kërkesat e tregut ndërkombëtar për certifikata të gjelbra, duke rritur konkurrueshmërinë e tyre brenda Tregut Unik të Bashkimit Evropian nën kuadrin e CBAM-së.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Mbështetja e ndërmarrjeve industriale për zbatimin e kërkesave MRVA dhe ngritja e kapaciteteve kombëtare për ofrimin e shërbimeve të verifikimit, përfshirë asistencën për raportet e emetimeve, trajnimin e profesionistëve të parë të verifikimit të emetimeve, përgatitjen e organeve verifikuese kandidate për akreditim dhe ngritjen e kapaciteteve të vlerësuesve të trupës kombëtare të akreditimit. | 2026–2028 | Ministria e Mjedisit, MEI, MIE, AKM, DPA, DPS, sipas fushës së përgjegjësisë |
| 2. Gatishmëria CBAM për eksportuesit: ofrimi i asistencës teknike për përshtatjen me rregulloren (BE) 2023/956, e ndryshuar, llogaritjen dhe dokumentimin e emetimeve të trupëzuara, mbështetjen për verifikimin e të dhënave dhe transmetimin e informacionit te importuesit në Bashkimin Evropian, në sektorët e përzgjedhur. | 2026–2030 | MEI, Ministria e Mjedisit, MIE, AIDA, AKM, |
| 3. Shërbime këshillimore dhe paketa trajnimi për ndërmarrjet mbi masat e eficiencës së energjisë dhe auditimin energjetik industrial. | 2027-2029 | MEI, MIE, Agjencia e Eficiencës së Energjisë (AEE), AIDA, Ministria e Mjedisit |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Ndërmarrje industriale dhe eksportuese të mbështetura për zbatimin e kërkesave MRVA dhe gatishmëri CBAM | 0 (2025) | 25 (2028) | 60 |

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Kapacitet i ri vetëprodhimi RES i ndërmarrjeve (*MW*) | Baza ERE 2026 | Sipas pasaportës | Përcaktohet me MIE/ERE |
| Intensiteti energjetik i industrisë përpunuese | INSTAT/Eurostat 2025 | -5% (2028) | -10% |

ANEKS NR. 3
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M 1.1.6 – Standardet, certifikimi dhe gatishmëria për tregun e vetëm (me modul ndërkombëtarizimi)**

**Objektivat:**

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe aftësimit profesional për Tregun e Përbashkët Evropian dhe ndërtimi i një ekosistemi të qëndrueshëm këshillimor dhe trajnim për pajisjen e sipërmarrjes dhe të forcës së punës me njohuritë dhe aftësitë për tregun evropian.
- Fuqizimi i ndërmarrjeve shqiptare përmes mbështetjes direkte për standardizim dhe certifikim, aksesit të përmirësuar në instrumente financiare (grante dhe kredi të buta) në përputhje me standarde e tregut të përbashkët.
- Promovimi i produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

**Përshkrimi**: Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian mundëson transformimin e ekonomisë kombëtare, duke kërkuar një konvergjencë strukturore të sipërmarrjes shqiptare me standardet e Tregut të Përbashkët Evropian. Për ndërmarrjet shqiptare, ku NMVM-të përbëjnë shtyllën kurrizore të ekonomisë, ky proces nuk është thjesht një detyrim ligjor, por një ndryshim paradigme. Pavarësisht potencialit, sektori privat përballet me pengesa kryesore, si mungesa në informacion, certifikim, akses në financim dhe kapacitete teknike për t'iu përgjigjur dinamikës së konkurrencës së Bashkimit Evropian. Kjo masë synon të adresojë këto sfida, duke shndërruar procesin e integrimit në një mundësi konkrete, duke ofruar një udhërrëfyes praktik dhe arkitekturë mbështetëse, që lidh reformat institucionale me nevojat reale të biznesit në vend, për të garantuar që ndërmarrjet shqiptare jo vetëm të jenë të përputhshme me kriteret e Bashkimit Evropian, por edhe të zhvillohen në mjedisin konkurrues të tregut të përbashkët. Për të rritur produktivitetin dhe konkurrueshmërinë kombëtare në përballje me sfidat e tregut evropian, Shqipëria po ndërmerr hartimin e një programi kombëtar gjithëpërfshirës për mbështetjen e sipërmarrjes gjatë dhe pas procesit të integrimit. Ky program shërben si një platformë transformuese, duke lidhur reformat institucionale me nevojat konkrete të biznesit për t'u bërë partnerë në Tregun e Përbashkët të Bashkimit Evropian. Për të adresuar sfidat e identifikuara në "Raportin e gatishmërisë", programi kombëtar strukturohet mbi tri shtylla strategjike, që synojnë transformimin e sektorit privat në një forcë konkurruese brenda Tregut të Vetëm të Bashkimit Evropian: së pari, krijimin e një infrastrukture gjithëpërfshirëse informimi dhe ndërgjegjësimi (nëpërmjet platformës digjitale EUBIP), së dyti, ngritjen e një ekosistemi të qëndrueshëm këshillimor dhe trajnues për të rritur ekspertizën vendase, dhe, së treti, zbatimin e programeve të zhvillimit të kapaciteteve, lançimi i skemave të granteve dhe instrumenteve financiare, si dhe zgjerimi gradual i masave mbështetëse për transformimin e ndërmarrjeve. Për më tepër, aktivitetet e mbështetjes financiare dhe këshillimore do të mundësojnë mekanizmat e përputhshmërisë për

certifikatat e gjelbra dhe standardet e qëndrueshmërisë, të cilat kërkohen për të përforcuar kapacitetin eksportues të produkteve shqiptare në zinxhirët e vlerës.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Krijimi dhe funksionalizimi i strukturave të qeverisjes së programit, ngritja e Njësisë së Zbatimit të Programit dhe krijimi i mekanizmave koordinues ndërinstitucionalë | 2026–2027 | MEI, Komitet Ndërministror për Integrimin Ekonomik të Sipërmarrjes, Ekipi Kombëtar për hartimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të programit. |
| 2. Zhvillimi dhe operacionalizimi i Platformës Evropiane të Informimit për Biznesin (EUBIP), si dhe krijimi i sistemeve të komunikimit, monitorimit dhe raportimit | 2026–2027 | MEI, Komitet Ndërministror për Integrimin Ekonomik të sipërmarrjes, Ekipi Kombëtar për hartimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të programit. |
| 3. Informimi dhe ndërgjegjësimi i 48,000 ndërmarrjeve në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe realizimi i vlerësimit të parë të gatishmërisë së tyre dhe operacionalizimi i programeve fillestare të trajnimit | 2026–2027 | MEI, Komitet Ndërministror për Integrimin Ekonomik të Sipërmarrjes, Ekipi Kombëtar për hartimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të programit. |
| 4.Zbatimi i plotë i programeve të zhvillimit të kapaciteteve, lançimi i skemave të granteve dhe instrumenteve financiare, si dhe zgjerimi gradual i masave mbështetëse për transformimin e ndërmarrjeve | 2027–2030 | MEI, Komitet Ndërministror për Integrimin Ekonomik të Sipërmarrjes, Ekipi Kombëtar për hartimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të programit. |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Përqindja e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha eksportuese të certifikuara sipas standardeve të Bashkimit Evropian (CE/ISO) | Vlerësimi fillestar | 25% | 50% |
| Numri i ndërmarrjeve të mbështetura që hyjnë në zinxhirët e vlerës të IHD-ve (*Business Linkages*) | 0 | 50 | 150 |
| Rritja mesatare vjetore e eksporteve drejt Bashkimit Evropian për ndërmarrjet përfituese nga programi | Bazë 2026 | +10% | +25% |

ANEKS NR. 4
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M1.1.8 – Digjitalizimi industrial dhe aksesi në inteligjencë artificiale**
**Objektivat:**

Krijimi dhe fuqizimi i Qendrës Evropiane të Inovacionit Digjital (EDIH) kombëtare, si *Hub*-i Kombëtar i Inovacionit Digjital, nëpërmjet strukturës së saj operacionale, *Digital Innovation Unit* (DIU) si pikë kryesore për ofrimin e shërbimeve të avancuara të digjitalizimit dhe mbështetjes teknike për ndërmarrjet drejt zgjidhjeve teknologjike.

Forcimi i sigurisë së sistemeve të kontrollit ndaj kërcënimeve kibernetike nëpërmjet ekspertizës së specializuar të ofruar nga Qendra Evropiane e Inovacionit Digjital (EDIH) kombëtare.

Integrimi i Shqipërisë në ekosistemin EuroHPC, duke përfshirë pjesëmarrjen në thirrjet e ardhshme për "*AI Factory*"/"*AI Factory Antenna*" dhe aplikimi në thirrjet EuroHPC, për t'u mundësuar SME-ve industriale aksesin në infrastrukturën kompjuterike të Inteligjencës Artificiale (AI) pa pasur nevojë për investime të mëdha private.

**Përshkrimi:** Masa është konceptuar si një platformë e integruar e digjitalizimit industrial, e ndërtuar mbi dy shtylla plotësuese.

Shtylla e parë është ngritja dhe operacionalizimi i Qendrës Evropiane të Inovacionit Digjital (EDIH) kombëtare, e bashkëfinancuar nga programi "*Digital Europe*" (DIGITAL-2023-EDIH-04), për periudhën 2025–2028, e cila vepron si *Hub*-i Kombëtar i Inovacionit Digjital nëpërmjet strukturës së saj operacionale, *Digital Innovation Hub* (DIU). EDIH ofron shërbime "*test before invest*", trajnime, rrjetëzim dhe mbështetje teknike për SME-të, *startup*-et dhe institucionet publike. Me fokus në inteligjencën artificiale, sigurinë kibernetike industriale dhe aftësitë digjitale të avancuara, duke synuar mbulimin e mbi 1,000 subjekteve dhe trajnimin e rreth 2,000 profesionistëve, si dhe integrimin e Shqipërisë në rrjetin evropian të EDIH-ve. Për të siguruar konvertimin e këtij mbulimi në adoptim real, EDIH mbështetet nga një skemë nxitëse (*vauchet*/bashkëfinacim), që lehtëson integrimin e zgjidhjeve digjitale dhe të IA-së në ndërmarrjet prodhuese.

Shtylla e dytë siguron aksesin e ndërmarrjeve vendase në infrastrukturën evropiane të inteligjencës artificiale. Duke u mbështetur në anëtarësimin e Shqipërisë në Ndërmarrjen e Përbashkët EuroHPC (qershor 2025) dhe në rolin e AKSHI-it si pikë kombëtare, ndërmarrjet do të shfrytëzojnë infrastrukturën evropiane të llogaritjes me performancë të lartë (HPC) dhe platformat *Cloud* pa pasur nevojë për investime të mëdha private. Ky komponent përfshin pjesëmarrjen në thirrjet e ardhshme "*AI Factory/AI Antenna*" dhe një studim fizibiliteti për një Qendër Kombëtare HPC; në rast mossuksesi në thirrje, aksesi sigurohet përmes qendrave ekzistuese EuroHPC, në mënyrë që zbatimi i masës të mos kushtëzohet nga rezultati i një thirrjeje të vetme.

Vizioni strategjik bazohet në lidhjen e ekosistemit vendas me rrjetet evropiane EDIH dhe qendrat rajonale të Inovacionit (*AI Factories, AI-on-Demand* dhe Objektet e Testimit e Eksperimentimit), duke i mundësuar industrisë shqiptare të testojë, të vërtetojë dhe të zbatojë zgjidhje të avancuara. Për të garantuar qëndrueshmërinë përtej periudhës së bashkëfinancimit të *Digital Europe* (2028), masa parashikon një plan financiar tranzicioni, që siguron vijueshmërinë e shërbimeve të EDIH-ve deri në vitin 2030 dhe më tej, duke nxitur një avantazh konkurrues të qëndrueshëm dhe integrimin në zinxhirët e vlerës të Bashkimit Evropian.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Krijimi dhe funksionimi i Qendrës Evropiane të Inovacionit Digjital (EDIH) kombëtare, si *Hub*-i Kombëtar i Inovacionit Digjital nëpërmjet strukturës së saj operacionale, *Digital Innovation Unit* (DIU) | 2026–2027 | MEI, DIU |
| 2. Program për trajnimin, rrjetëzimin dhe mbështetjen e SME-ve dhe sipërmarrjeve të reja (*startups*). | 2026–2030 | MEI, DIU |

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 3. Angazhimi në EuroHPC: pjesëmarrje në thirrjet për akses në EuroHPC, studim fizibiliteti për një Qendër Kombëtare HPC, dhe aplikim në thirrjet e ardhshme për "*AI Factory Antenna*". | 2027–2029 | MEI, AKSHI |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| NMVM-të prodhuese me zgjidhje digjitale/AI të integruara përmes skemës | 0 (2025) | 35 gjithsej (kumulative) (2028) | 90 kumulative |
| Kapaciteti i përdorur i EuroHPC (orë bërthamë*/core hours*) | 0 (2025) | 200 000 kum. (2028) | 1 000 000 kum. |
| Ndërmarrjet me rritje të produktivitetit 24 muaj pas ndërhyrjes | - | Matja e parë (2029) | ≥ 30% |

ANEKS NR. 5
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M 1.1.10 – Lehtësimi i veprimtarisë industriale ndërkufitare dhe logjistika**
**Objektivat:**
- Reduktimi i kohës dhe kostos së kalimit kufitar për mallrat industriale;
- Digjitalizimi i dokumentacionit tregtar dhe interoperabiliteti i të dhënave;
- Modernizimi i logjistikës private (zinxhiri i ftohtë) dhe zgjerimi i statusit AEO.

**Përshkrimi:** Kjo masë adreson ndërhyrjet kryesore për lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare të mallrave industriale. Masa synon kalimin drejt dokumentacionit plotësisht të digjitalizuar, realizimin periodik të studimit të kohës së kalimit së mallrave (*Time Release Study* – TRS) dhe menaxhimin operacional të pikave të kalimit kufitar në Shqipëri. Gjithashtu, parashikohet rritja e ndërveprueshmërisë (*interoperability*) së sistemeve doganore, zgjerimi i numrit të ndërmarrjeve me statusin Operator Ekonomik i Autorizuar (AEO) dhe vënia në funksion e një mekanizmi të përhershëm për identifikimin dhe zgjidhjen e barrierave tarifore, në përputhje me vendimet e Komitetit për Lehtësimin e Tregtisë në CEFTA.

Në nivel rajonal e ndërkombëtar, masa synon zbatimin e programit për lehtësimin e tregtisë dhe transportit, duke zgjeruar komponentin e korridoreve dhe korsive të gjelbra (*Green Lanes*) në kuadër të CEFTA-s, si dhe marrëveshjen dypalëshe Itali–Shqipëri për "Korsitë blu". Masa është e dedikuar për sektorin privat dhe do të fokusohet në kryerjen e vlerësimeve të nevojave dhe ofrimin e programeve të trajnimit të dedikuara për operatorët logjistikë vendas, duke u mbështetur në asistencën teknike të partnerëve ndërkombëtarë (si IFC dhe SECO).

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Dokumentacioni digjital dhe interoperabiliteti i të dhënave ndërkufitare | 2026–2029 | MEI, DPD, AKSHI |
| 2. *Time Release Study* dhe optimizimi i pikave | 2026–2028 | DPD, MEI |

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| kryesore kufitare | | |
| 3. Zgjerimi AEO dhe mekanizmi i zgjidhjes së barrierave; zbatimi i komponentit *Green Lanes* | 2026–2030 | DPD, MEI, KKLT |
| 4. Vlerësimet/trajnimet për operatorët privatë të logjistikës | 2026–2027 | MEI, AIDA, IFC, SECO |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Koha mesatare e kalimit kufitar (TRS) | Matja TRS 2026 | -15% (2028) | -30% |
| Operatorë me status AEO | Baza DPD 2025 | +50% (2028) | Dyfishim |
| Dokumentacion tregtar i përpunuar tërësisht digjitalisht | Matja 2026 | 50% (2028) | ≥ 80% |

ANEKS NR. 6
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M 1.1.11 – Rezilienca (qëndrueshmëria) e zinxhirëve të furnizimit dhe diversifikimi i inputeve (përfshirë CRM" Lëndët e para kritike")**

**Objektivat:**

Hartëzimi periodik i varësive nga importet dhe i pikave të dobëta të zinxhirëve të furnizimit për industrinë shqiptare;

Diversifikimi i burimeve të furnizimit (*near-shoring* rajonal/BE, lëndë të para dytësore dhe përdorimit të lëndëve të para dytësore/ricikluara si rezultat i ekonomisë qarkulluese);

Pozicionimi i Shqipërisë në zinxhirët strategjikë të Bashkimit Evropian: lëndët e para kritike (CRM) dhe medikamentet kritike (CM).

**Përshkrimi:** Për të garantuar qëndrueshmërinë zinxhirëve të furnizimit, MEI do të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe INSTAT-in, për analizuar varësinë nga inputet kritike, sipas metodologjisë së Komisionit Evropian (2021), një proces që do të zbatohet si një vlerësim periodik çdo dy vjet.

Një shtyllë kryesore e qëndrueshmërisë industriale është zvogëlimi i varësisë nga importet përmes parimeve të ekonomisë qarkulluese. Kjo masë synon promovimin e lëndëve të para dytësore si zëvendësuese e inputeve të importuara. Përmes nxitjes së "simbiozës industriale" (ku mbetjet e një industrie përdoren si lëndë e parë në një industri tjetër, si p.sh. skrapet industriale) dhe standardizimit të tyre në bashkëpunim me DPS-në, synohet krijimi i një tregu funksional të lëndëve të para dytësore në vend.

AIDA do të mbështetesë këtë proces duke ofruar trajnime të dedikuara për menaxhimin e riskut të zinxhirët e furnizimit. Zbatimi i planeve të veprimit për lëndët e para kritike (CRM) dhe medikamentet kritike (CM) do të realizohet në partneritet të ngushtë me MIE-n, përmes Qendra EIT Elbasan, dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Deri në dhjetor 2027 do të konsolidohen partneritetet e qëndrueshme të zinxhirit të vlerës industriale me BE-në, ndërkohë që aspektet e sigurisë ekonomike do të trajtohen përmes politikave tregtare dhe promovimit të investimeve të huaja.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Vlerësimi i varësive strategjike dhe përditësimi çdo 2 vjet | 2026–2030 | MEI, DPD, INSTAT |
| 2. Zbatimi i planeve të veprimit CRM/CM me partneritetet e Bashkimit Evropian | 2026–2027 (plani); zbatimi deri 2030 | MEI, MIE, MSHMS, Qendra EIT Elbasan |
| 3. Trajnime për menaxhimin e riskut të zinxhirit të furnizimit | 2026–2030 | MEI, AIDA, shoqatat |
| 4. Hartimi i një udhërrëfyesi për promovimin dhe standardizimin e lëndëve të para dytësore në industritë kryesore (si: metalurgji, ndërtim etj.), duke lehtësuar skemat e simbiozës industriale | 2027–2028 | MEI, MIE, Ministria e Mjedisit, DPS |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Indeksi i përqendrimit të importeve për inputet kritike | Raporti i parë (2027) | -5% (2028) | -10% |
| Inpute kritike me më shumë se 2 burime furnizimi | Raporti i parë (2027) | +8 pp (2029) | +15 pp |
| Plane veprimi CRM" Lëndët e para kritike"/CM të miratuara | 0 (2025) | 1–2 (2027) | Në zbatim |

ANEKS NR. 7
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M1.1.12 – Përditësimi i ligjit të investimeve dhe thjeshtimi i procedurave për projektet industriale**

**Objektivat:**

Rishikimi i kuadrit të ri ligjor për investimet përmes miratimit të ligjit të ri "Për investimet".

**Përshkrimi:**

Kjo masë parashikon rishikimin dhe unifikimin e kuadrit ligjor për investimet përmes hartimit dhe miratimit të ligjit të ri "Për investimet". Ligji do të jetë në përputhje të plotë me politikën kombëtare të zhvillimit ekonomik dhe do të rishikojë lehtësitë në sektorët prioritarë të ekonomisë, përcaktimi dhe rishikimi periodik i të cilëve do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Sistemi i nxitjes do të bazohet në kritere objektive, duke mbështetur ato investime, që gjenerojnë transferim teknologjie, punësim të kualifikuar, kapacitet eksportues dhe bashkëpunim me furnizuesit vendas, të mbështetura nga programe plotësuese për modernizimin e ndërmarrjeve vendase. Kriteret dhe paketat nxitëse do të ndërtohen në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore dhe pragjet e intensitetit.

Për të siguruar që investimet të gjenerojnë vlerë të shtuar të lartë për ekonominë vendase, masat lehtësuese do të lidhen me standarde (*benchmarks*) të përshtatshme. Kuadri i ri ligjor do të përfshijë standarde për bashkëpunimin me furnizuesit vendas, duke i pozicionuar

investimet e huaja direkte (IHD) si një përshpejtues për transformimin teknologjik të ekonomisë shqiptare.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1.Rishikimi i projektligjit dhe hartimi i sistemit të pikëzimit sipas ekosistemeve prioritare | 2026 | MEI |
| 2. Konsultimi publik, RIA me SME Test dhe miratimi i projektligjit | 2027 | MEI, KM |
| 3. Krijimi i një regjistri të brendshëm pranë AIDA-s për të monitoruar treguesit kryesorë të performancës së investimeve të lehtësuara | 2028-2030 | MEI, AIDA, INSTAT |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Ligji i investimeve i miratuar | Draft (2026) | Miratim 2027 | Zbatim i plotë |
| Investime të reja në ekosistemet e mbështetura nga kuadri i ri ligjor për investimet | 0 (2026) | ≥ 15 mln EUR (2028) | ≥ 50 mln EUR kum. |
| Pjesa e projekteve të investimit të lehtësuara që plotësojnë kriteret prioritare të zhvillimit | 0% | Matja e parë (2028) | ≥ 40% e e projekteve të miratuara (Burimi: regjistri administrativ i AIDA-s) |

Tabela 12. Masat në fushën e ndërhyrjes "Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni"

| Veprimet prioritare | Përshkrim përmbledhës |
|---|---|
| ***Lidhja mes NMVM-ve dhe startup-eve*** | *Aktualisht nevojitet një integrim më i mirë i ekosistemit të startup-eve në ekonomi, ndaj fokusi kryesor i kësaj mase të re është organizimi i disa aktiviteteve ndërgjegjësuese me biznese startup dhe bizneset e krijuara, NMVM-të (takime me fokus tema të caktuara, si p.sh., Automatizimi, AI etj.). Për të gjeneruar sinergji dhe për të bashkuar në mënyrë efektive komunitetin e startup-eve dhe biznesit, AIDA dhe Agjencia e Startup-eve do të bashkëpunojnë ngushtë në përgatitjen e aktiviteteve të përbashkëta, duke ftuar pjesëmarrës dhe duke rritur ndërgjegjësimin për mundësitë e projekteve dhe rezultateve të inovacionit. Objektivat që synohen janë:*<br>*- Nxitja e lidhjeve midis startup-eve dhe bizneseve të krijuara, duke u fokusuar në potencialet e inovacionit në kontekstin e transformimit digjital, të gjelbër dhe qarkullues;*<br>*- Integrimi më i fuqishëm i ekosistemit startup në ekonomi.* |

| | |
|---|---|
| | ***Aktiviteti:*** *Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese me startup-e dhe i bizneseve NMVM në periudhën 2025–2027.*<br>***Institucionet përgjegjëse:*** *AIDA dhe Agjencia "Startup Albania"* |

***Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara***

| ***Treguesit*** | ***Baza bazë (viti 2024)*** | ***Vlera e synuar*** | | |
|---|---|---|---|---|
| | | ***2025*** | ***2026*** | ***2027*** |
| *Nr. i aktiviteteve të organizuara* | | *1* | *2* | *2* |
| *Numri i pjesëmarrësve (të paktën 30% startup-e dhe biznese të udhëhequra nga gratë)* | | *30* | *60* | *60* |

| | |
|---|---|
| ***Akses në programet e Bashkimit Evropian në fushën e biznesit*** | *Për NMVM-të dhe bizneset startup do të mundësohet pjesëmarrja në aplikimet e programeve të BE-së, si Programi i Tregut të Përbashkët 2021–2027 për të mundësuar bashkëpunimin e bizneseve në nivel ndërkombëtar dhe përmirësuar aksesin në financa. NMVM-të dhe startup-et e interesuara do të ndihmohen në gjetjen e partneriteteve për konsorcium dhe përgatitjen e dokumenteve të aplikimit. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) si koordinator i projektit "Enterprise Europe Network-ALBANIA" për periudhën 2022–2025 (42 muaj), do të mundësojë integrimin ndërkombëtar të NMVM-ve dhe rritje të konkurrueshmërisë së tyre. Objektivat që synohen janë:*<br>*- Forcimi i inovacionit duke shfrytëzuar potencialin e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar;*<br>*- Nxitja e lidhjeve dhe integrimit ndërkombëtar të ekosistemit të inovacionit;*<br>*- Përmirësimi i aksesit në financë, duke siguruar akses të barabartë për gra dhe burra.*<br>*Aktiviteti: Mbështetje për NMVM-të dhe bizneset startup për të marrë pjesë në programet e BE-së (Programin e Tregut të Përbashkët 2021–2027) në periudhën 2025–2027.*<br>*Institucionet përgjegjëse: MEKI, AIDA dhe Agjencia Startup Albania.* |

**Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara**

| **Treguesit** | **Baza bazë (viti 2024)** | **Vlera e synuar** | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **2025** | **2026** | **2027** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Numri i NMVM-ve që kanë aplikuar me sukses për programet evropiane | | 2 | 3 | 5 |

| | |
|---|---|
| **Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të *startup*-eve** | Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të *startup*-eve konsiderohet të jetë një element premtues për të mbështetur rritjen dhe ndërkombëtarizimin e *startup*-eve dhe NVM-ve të reja. Në të njëjtën kohë, ekspozimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi me organizatat e tjera të *startup*-eve kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të organizatave lokale mbështetëse dhe zhvillimin e një mjedisi të favorshëm sipërmarrës në vend.<br>Në këtë kuadër, fokusi kryesor i këtij veprimi prioritar është lidhja e *startup*-eve Shqiptare me mentorët e diasporës dhe zhvillimi i një iniciative rajonale për *startup*-et. Ky veprim prioritar mbështetet në aktivitetet ekzistuese të mbështetura nga donatorët (p.sh. nën Programin BE për Inovacionin) dhe plotëson iniciativat në nivel rajonal në kuadër të Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal (2021–2024)<br>Për të shfrytëzuar përvojën, rrjetet dhe burimet e diasporës, programet e dedikuara të mentorimit do të shkallëzohen. Rrjeti i mentorëve do të shtrihet në mënyrë sistematike, duke përfshirë, gjithashtu, gra të suksesshme në biznes për të mbështetur gratë sipërmarrëse. Rrjeti i mentorëve do të shtrihet në mënyrë sistematike, duke përfshirë, gjithashtu, gra të suksesshme në biznes për të mbështetur gratë sipërmarrëse. Në bazë të eksperiencës së përftuar nga marrëdhëniet bilaterale të mentorimit do të vlerësohet mundësia për grupe të rregullta mentorimi.<br>Gjithashtu, do të organizohen aktivitete (virtuale) ndërlidhëse/prezantuese për të forcuar lidhjet dhe për t'i dhënë sipërmarrësve shqiptarë mundësinë të gjejnë mentorë/investitorë me eksperiencë ndërkombëtare. Këto aktivitete do të plotësohen me masa komunikimi të shënjestruara për të informuar diasporën mbi zhvillimin e komunitetit të *startup*-eve, bashkëpunimet përkatëse dhe mundësitë për investim.<br>Në bazë të vlerësimit të nevojave dhe interesave të *startup*-eve lokale dhe organizatave mbështetëse, zhvillimi i një iniciative rajonale për *stratup*-et përbën komponentin e dytë të këtij veprimi. Për hartimin e kësaj iniciative do të merren në konsideratë shembuj të praktikës së mirë ndërkombëtare (p.sh. EuroLncNet ose *Startup* Alpe-Adria). Qëllimi është integrimi i organizatave të *startup*-eve jo vetëm brenda rajonit, por, gjithashtu, nga shtetet anëtare të BE-së zgjerimi i rrjetit të bashkëpunimit dhe përfitimi nga eksperiencat përkatëse lidhur me shfrytëzimin e programeve të financuara nga BE-ja.<br>Midis të tjerash, parashikohen aktivitetet e mëposhtme bashkëpunuese:<br>- Zhvillimi i studimeve për hyrjen në treg dhe prezantimi i strategjive për *startup*-et me organizatat partnere;<br>- Sigurimi i mbështetjes për hyrjen në treg (paketa shërbimesh të |

| | |
|---|---|
| | ofruara nga organizatat partnere për *startup*-et që kërkojnë të testojnë modelin e tyre të biznesit në nivel ndërkombëtar, p.sh. hapësira për zyra falas, shërbime këshillimi dhe mundësi për ndërlidhje);<br>- Prezantimi i një programi të përbashkët përshpejtimi.<br>- Hapi i parë për të përgatitur aktorët shqiptarë për pjesëmarrje në iniciativën rajonale, do të jetë mbështetja e bashkëpunimeve bilaterale. |
| **Nisma për përmirësimin e zinxhirit të vlerave me bazë konkurrencën** | Zhvillimi dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerave në vend dhe në nivel rajonal, si dhe integrimi në zinxhirin e vlerave ndërkombëtare luan një rol kritik në rrugën e dëshiruar për zhvillim. Për të rritur gradualisht veprimtaritë inovative dhe për të shpalosur plotësisht potencialet e specializimit inteligjent është e nevojshme të eksplorohen mënyra të reja për t'u përqendruar dhe për të bashkëpunuar në zinxhirët e vlerave duke përfshirë të gjithë aktorët.<br>Shqipëria aktualisht po zhvillon një strategji për specializimin inteligjent. Përvoja ndërkombëtare tregon se procesi i hartimit të strategjisë dhe qasja e tij lidhur me pjesëmarrjen sigurojnë një mundësi premtuese për zhvillimin e përbashkët të ideve për projekte bashkëpunuese për rritjen e kapaciteteve. Megjithatë, në shumë raste, mungesa e mekanizmave financiarë për zhvillimin e këtyre ideve dhe zbatimin e tyre ka rezultuar një sfidë e vështirë.<br>Duke marrë në konsideratë "mësimet e nxjerra" si dhe përvojën praktike në nivel ndërkombëtar, si p.sh. programin gjerman "WIR - Transformim përmes inovacionit në rajon", fokusi kryesor i këtij veprimi prioritar është të hartojë dhe zbatojë një skemë mbështetëse të dedikuar, e cila ofron grante për konsorciumet, institucionet e arsimit të lartë për projekte bashkëpunuese për rritjen e kapaciteteve.<br>Iniciativa e bazuar në konkurrencë do të strukturohet në disa faza, me qëllim përqendrimin e burimeve në zinxhirët e vlerave dhe projektet më premtuese, dhe në të njëjtën kohë rritjen e ndërgjegjësimit mbi potencialin e inovacionit në përgjithësi:<br>- Pas thirrjes për propozime, konsorciumet e interesuara dorëzojnë aplikimet e tyre së bashku me një plan të projektidesë së tyre (p.sh. për përparimin drejt një zinxhiri qarkullues vlerash). Theks i veçantë do të vendoset mbi idetë e zhvilluara në kontekstin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent. Megjithatë, mund të paraqiten dhe ide të tjera.<br>- Juria do të përzgjedhë 20 konsorciume për fazën e konceptit. Secila nga konsorciumet e përzgjedhura do të marrë një grant prej 50 mijë euro për zhvillimin e një koncepti zhvillimi. Kostot e pranueshme përfshijnë aktivitetet ndërlidhëse dhe *workshop*-et, kërkimet e tregut dhe studimet e fizibilitetit.<br>- Juria do të vlerësojë konceptet zhvilluese dhe do të zgjedhë 10 konsorciume për fazën e zbatimit. Grante deri në 200 mijë euro do të jepen për zbatimin e koncepteve për një periudhë fillestare prej dy vjetësh. Kostot e pranueshme lidhen me aktivitetet e kërkim-zhvillimit dhe pajisjeve, trajnimeve dhe promovimit.<br>- Në bazë të vlerësimit të rezultateve do të shqyrtohen potencialet |

| | |
|---|---|
| | dhe fizibiliteti i një programi zhvillimi klaster, me qëllim zhvillimin e iniciativës. |
| **Rritje e aksesit në financë** | Kushtet aktuale - veçanërisht në kontekstin e krizës së COVID-19 - janë sfiduese për NVM-të, si shtylla kurrizore e ekonomisë shqiptare. Përmirësimi i aksesit në financë konsiderohet me rëndësi kritike për forcimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve, duke mbështetur rimëkëmbien. Është e nevojshme të rritet efektiviteti i skemave ekzistuese të granteve për NVM-të dhe të prezantohen dhe promovohen mjete dhe instrumente të reja financiare.<br>Ky veprim prioritar bazohet në dhe plotëson iniciativat ekzistuese të mbështetura nga donatorët, si Programi i BERZH-it për Mbështetjen e Agrobiznesit Shqiptar, Fondi Evropian për Evropën Juglindore dhe Programi Italo-Shqiptar për zhvillimin e NVM-ve në Shqipëri. BERZH po mbështet, gjithashtu, kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse të të gjitha skemave ekzistuese për mbështetjen e NVM-ve dhe zhvillimin e një platforme informative që detajon mundësitë e disponuueshme për financim, të cilat janë pjesë e PRE 2020–2022.<br>Në këtë kuadër, ky veprim prioritar përfshin masat e parashtruara më poshtë. Theks i veçantë do të vendoset në mbështetjen e grave sipërmarrëse dhe sipërmarrjeve që drejtohen nga gratë.<br>- Krijimi i një portali informacioni për aksesin në financë për NVM-të në AIDA: Portali ofron një përmbledhje të mundësive të financimit në dispozicion për të gjitha instrumentet e tregut financiar të ofruara nga institucionet shtetërore ose donatorët.<br>- Ridisenjimi i skemës ekzistuese të granteve për NVM-të: Kjo përfshin krijimin e një Fondi të Vetëm për Zhvillimin e NVM-ve, i cili kombinon skemat ekzistuese. Fondi i ri do të lejojë më shumë fleksibilitet, në lidhje me qëllimet e financimit. Shuma maksimale e granteve për projekt do të rritet për të përmirësuar tërheqjen dhe ndikimin e Fondit.<br>- Ristrukturimi i proceseve të aplikimit për grante dhe administrimi: Proceset e aplikimit *online* do të futen për të zgjeruar gamën e aplikuesve duke ua bërë më të lehtë procedurën e aplikimit NVM-ve jashtë Tiranës.<br>- Prezantimi i mjeteve dhe instrumenteve shtesë financiare: Bazuar në përvojën ndërkombëtare, do të hartohet një skemë e garancisë shtetërore. Karakteristikat kryesore do të specifikohen, p.sh. kriteret e pranimit, kolaterali/tarifat dhe korniza institucionale.<br>- Hartimi i një ligji të ri për NVM-të<br>- Prezantimi i skemave mbështetëse shtesë, të tilla si garancitë e kredive. Do të krijohet instrumenti i garancisë prej 50 milionë euro për manifakturën në rastet e ndryshimit të porosive për të përballuar kostot e ndërrimit dhe kalimit në linja prodhimi të reja *(switching costs)*.<br>- Krijimi i një kuadri ligjor dhe rregullator të favorshëm për financimin *crowdfunding* nga AMF-ja – Autoriteti i Mbikëqyrjes |

| | |
|---|---|
| | Financiare në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë.<br>- Me mbështetjen e projektit *"EU for Innovation",* një program pilot do të iniciohet për krijimin e një rrjeti engjëjsh biznesi. |
| **Program për aftësitë sipërmarrëse për NVM-të** | Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përbëjnë pjesën kryesore të bizneseve në Shqipëri. Ato janë thelbësore për krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e produktivitetit, zhvillimin dhe konkurrueshmërinë. Aftësia e NVM-ve për të shtuar vlerë, për të hapur vende pune dhe nxitu inovacionin varet nga aftësitë e kapitalit njerëzor. Cilësia e aftësive menaxheriale është veçanërisht e rëndësishme për NVM-të, të cilat duhet të jenë në gjendje të përshtaten me shpejtësi me zhvillimin e tregjeve dhe ndryshimin e kushteve - me burime të kufizuara.<br>Kjo masë reflekton rekomandimet e Indeksit të Politikave për NVM-të të OECD-së, i cili thekson nevojën për të zgjeruar ofrimin e trajnimeve për NVM-të dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe ofruesve të trajnimeve.<br>Në këtë kuadër dhe në përpos mbështetjes financiare, ky veprim prioritar fokusohet në zhvillimin dhe zbatimin e një programi për aftësitë sipërmarrëse për NVM-të, duke përfshirë dhënien e asistencës teknike, trajnimeve dhe masat e tjera për zhvillimin e kapaciteteve. Për pronarët, menaxherët dhe punonjësit e NVM-ve të interesuara do të ofrohen shërbime këshillimi, udhëzime dhe trajnime sipas nevojave. Programet e trajnimit dhe trajnimit do të përqendrohen në aftësitë e biznesit, duke përfshirë tema nga fusha të ndryshme, si menaxhimi i përgjithshëm i biznesit dhe qeverisja e suksesshme e korporatave, menaxhimi i inovacionit, sfidat dhe mundësitë e transformimit të gjelbër dhe digjital ose përfitimet e standardeve për të rritur eksportet. Për më tepër, arsimimi i NVM-ve do të stimulohet përmes përdorimit të mediave vizive dhe sociale dhe do të promovohen shembuj të praktikave të mira.<br>Planifikohet që AIDA të koordinojë skemën, e cila përfshin për shembull zhvillimin e programeve/planeve të trajnimit si dhe masat e komunikimit, materiale informative të shënjestruara për NVM-të dhe detyra monitorimi. Personeli i ri për sektorin e trajnimit, i parashikuar në veprimin prioritar 2.1, do të marrë përsipër këtë funksion Në ofrimin e trajnimeve do të përfshihen një sërë partnerësh, si dhe shoqatat e biznesit dhe ofruesit privatë të trajnimeve. Për zbatimin e programit të trajnimeve do të sigurohen fondet e nevojshme.<br>Gjatë fazës së hartimit të programit do të merren në konsideratë faktorët përkatës për suksesin e praktikave të mira ndërkombëtare, veçanërisht ato që lidhen me formatet digjitale dhe specifikat e grupeve të synuara. Gjithashtu, do të vlerësohen mekanizmat e ndryshëm financiarë dhe zbatues me mbështetje nga donatorët<br>Ky program do të përdorë në mënyrë të veçantë sinergjitë me veprimet e tjera prioritare, të tilla si vlerësimi periodik i nevojave për trajnim dhe programi për zhvillimin e forcës së punës. Vlerësimi i nevojave për trajnim do të ndihmojë në përshtatjen e shërbimeve që ofrohen për mbështetjen biznesit me nevojat e NVM-ve, sektorin e |

| | |
|---|---|
| | tyre, fazën e zhvillimit dhe përvojën e tyre në treg. Gjithashtu, ky veprim plotëson zhvillimin e aftësive të punonjësve përmes programit për zhvillimin e forcës së punës.<br>Programi do të përdorë veçanërisht sinergjitë me veprime të tjera prioritare siç janë vlerësimi i rregullt i nevojave për trajnim dhe programi i zhvillimit të fuqisë punëtore. |

**Objektivi specifik 1.3: Zhvillimi i kapitalit njerëzor**

Në përputhje me parimet e Strategjisë për NVM-të dhe Agjendën për Aftësi të BE-së, SZHBI-ja e re thekson rëndësinë strategjike që ka zhvillimi i aftësive për sa i përket NVM-ve, investitorëve të mëdhenj dhe *startup*-eve. Zhvillimi i aftësive dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës kanë rëndësi thelbësore për një rritje, produktivitet dhe invovacion të qëndrueshëm. Vetëm me aftësitë e duhura do të mundet Shqipëria të forcojë pozicionin e saj në konkurrueshmërinë dhe zinxhirët e vlerave ndërkombëtare dhe të ketë një rimëkëmbje ekonomike të qëndrueshme pas krizës së pandemisë.

Veprimtaritë arsimore dhe ato të rritjes së aftësive janë thelbësore për bizneset në mënyrë që ato të jenë në gjendje të përballojnë transformimin e zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, tregun e vetëm, specializimin inteligjent, si dhe transformimin e gjelbër dhe digjital. Në një mjedis konkurrues të ndryshueshëm, si *startup*-et ashtu dhe NVM-të e krijuara shpesh vihen në sfidë nga mungesa e punonjësve të aftë. Ata shpesh nuk kanë të njëjtat burime si kompanitë e mëdha për të investuar për trajnimin e punonjësve të tyre. Në të njëjtën kohë, baza e aftësive ka mjaft rëndësi në vendimin e investitorëve mbi vendndodhjen e biznesit, veçanërisht nga grupet e synuara bizneset e të cilave bazohen në njohuri dhe teknologji

Duke marrë në konsideratë situatën aktuale dhe burimet e disponueshme, është e rëndësishme që zhvillimi i kapitalit njerëzor të vendoset në të njëjtin kontekst me fushat e tjera të ndërhyrjes dhe të ndiqet një qasje largpamëse dhe bashkëpunuese. Në këtë kontekst, veprimet në këtë fushë të ndërhyrjes synojnë arritjen e objektivave dhe rezultateve të pritshme që shfaqen në figurën më poshtë, duke plotësuar dhe specifikuar objektivin e përcaktuar të politikës.

**Objektivat specifikë dhe rezultatet e pritshme[53] të fushës së ndërhyrjes "Zhvillimi i kapitalit njerëzor"**




[53] Gjithashtu, ësh reg
veprim prioritar, p.sh. 100 NVM punësojnë talente përtej kohëzgjatjes së projekteve për mbështetjen e inovacionit, 25 kompani përfitojnë në vit nga ofrimi i trajnimeve të personalizuara, nën programin e zhvillimit të fuqisë punëtore. TKP-të detajohen në fishat e veprimeve në aneks.

Inteligjenca e shëndoshë e aftësive formon pikën e nisjes për të garantuar ofrimin e arsimit dhe formimit modern dhe dinamik, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe ato shoqërore. Në bazë të inteligjencës së aftësive së azhurnuar dhe lehtësisht të aksesueshme, nevojiten përpjekje të bashkërenduara për të asistuar NVM-të në identifikimin e masave të duhura për rritjen e aftësive, për të zgjeruar ofertën e trajnimeve dhe për të ecur me hapin e transformimeve dhe ndryshimeve në një mjedis konkurrues. Kjo përfshin forcimin e lidhjeve ndërmjet aktorëve të spirales së trefishtë përmes eksplorimit të qasjeve të reja për të promovuar bashkëpunimin dhe lëvizshmërinë ndërmjet mjedisit akademik dhe biznesit.

Në këtë kontekst, ka, gjithashtu, një potencial premtues për të shfrytëzuar sinergjitë në pikën e lidhjes ndërmjet zhvillimit ë kapitalit njerëzor dhe fushave të ndryshme të ndërhyrjes së SZHBI-së për sa i përket:

- Përqendrimit në nevojat e investitorëve dhe përfshirjes së tyre në masat e zhvillimit të aftësive në të njëjtën kohë;
- Nxitjes së të mësuarit sipërmarrës dhe intensifikimit të bashkëpunimit midis sipërmarrësve dhe institucioneve arsimore dhe trajnuese;
- Integrimit të zhvillimit të aftësive në masat mbështetëse për NVM-të dhe iniciativat për përmirësimin e zinxhirëve premtues të vlerave në kontekstin e specializimit inteligjent.

Në këtë kontekst, tabela nr. 13 paraqet një panoramë të veprimeve prioritare të parashikuara në këtë fushë të ndërhyrjes të SZHBI-së 2021–2027. Detaje të mëtejshme (objektivat dhe TKP-të, institucionet përgjegjëse dhe burimet e nevojshme) gjenden në aneksin nr. 1.

ANEKS NR. 8
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M 1.2.7 – Transferimi i teknologjisë, qeverisja e S3 dhe rritja e kapacitetit absorbues**
**Objektivat:**

Ngritja dhe funksionimi i "Qendrës së Transferimit të Teknologjisë dhe Komercializimit të Teknologjisë" si urë lidhëse mes kërkimit shkencor dhe nevojave të tregut.

Rritja e konkurrueshmërisë në industrisë vendase në ekosistemet prioritare (*Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), Energjia e pastër, eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmi*) përmes ndërthurjes me teknologjitë e pastra dhe të digjitalizuara, duke lehtësuar integrimin e tyre në zinxhirët evropianë të vlerës.

**Përshkrimi:** Masa synon krijimin dhe funksionimin e "Qendrës së Transferimit të Teknologjisë dhe Komercializimit të Teknologjisë" si urë lidhëse mes kërkimit shkencor dhe nevojave të tregut. Në kuadër të S3, kjo qendër nuk do të funksionojë në mënyrë të izoluar, pasi fokusi i saj në ekosistemin e "Energjisë së pastër" do të jetë i orientuar drejt transferimit të teknologjive që përmirësojnë konsumin dhe eficiencën e energjisë në proceset prodhuese të industrive të tjera.

Përmes një modeli të ri, "Qendra për Transferimin e Teknologjisë dhe Komercializimit" do të mundësojë funksionimin e një ure lidhëse midis kërkimit shkencor dhe nevojave tregtare të *startup*-eve e NMVM-ve. Një synim strategjik i kësaj qendre do të jetë edhe rritja e kapaciteteve për absorbimin e fondeve të Bashkimit Evropian, duke aplikuar në programe të avancuara evropiane, si dhe promovimin e bashkëpunimeve të qëndrueshme ndër rajonale.

Duke integruar burimet e DIU-së dhe qendrave të specializuara me politikat kombëtare të koordinuara nga "*Innovation4Albania*", kjo masë synon arritjen e një avantazhi konkurrues të qëndrueshëm, kalimin nga kërkimi shkencor te komercializimi i teknologjisë dhe integrimin e plotë të sipërmarrjes shqiptare në zinxhirët e vlerës të Bashkimit Evropian.

Për më tepër, duke qenë se matja e produktivitetit real kërkon të dhëna të detajuara dhe të harmonizuara, MEI do të bashkëpunojë ngushtë me INSTAT-in për të lehtësuar transmetimin e të dhënave të detajuara mbi vlerën e shtuar dhe statistikat strukturore të ndërmarrjeve (SBS) drejt Eurostat-it. Për monitorimin e efekteve të kësaj mase, produktiviteti i ndërmarrjeve të mbështetura do të matet në nivel mikro përmes raporteve vjetore të performancës, që do të administrohen nga vetë Qendra e Transferimit të Teknologjisë (TTO).

**Aktivitetet:**

| **Aktiviteti** | **Afati** | **Institucionet** |
|---|---|---|
| 1. Ngritja dhe funksionimi i "Qendrës për Transferimin e Teknologjisë dhe Komercializimit të Teknologjisë" | 2027–2030 | MEI, Agjencia *"Innovation4Albania"* |
| 2. Aplikimi në fondet e Programit të Tregut të Përbashkët të Bashkimit Evropian | 2027–2030 | MEI, Agjencia *"Innovation4Albania"* |
| 3. Ndërgjegjësimi i zgjidhjeve dhe siguria kibernetike industriale për bizneset | 2027–2030 | MEI, Agjencia *"Innovation4Albania"* |
| 4.Koordinimi me INSTAT-in për përmirësimin e raportimit dhe transmetimit të të dhënave të detajuara të Vlerës së Shtuar (VA) dhe Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve (SBS) drejt Eurostatit | 2027–2029 | MEI, INSTAT |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| **Treguesi** | **Baza** | **Synimi i ndërmjetëm** | **Synimi 2030** |
|---|---|---|---|
| Projekte kërkimore të komercializuara përmes Qendrës së Transferimit | 0 | 5 kumulativë | 20 kumulativë |
| Rritja mesatare e produktivitetit të ndërmarrjeve të mbështetura (vlera e shtuar për punonjës në nivel ndërmarrjeje) | N/A | Matja e parë (2029) | ≥ 30% (Raportet vjetore të vetëdeklarimit të ndërmarrjeve të mbështetura pranë TTO) |
| Ndërmarrje të ekosistemeve S3, që kanë adoptuar teknologji të pastra/qarkulluese përmes mbështetjes së TTO-së. | 0 | 10 | 15 |

ANEKS NR. 9
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M1.2.9 – Instrumente financiare për modernizimin dhe transformimin industrial të ndërmarrjeve**

**Objektivat:**

-Lehtësimi i aksesit në kredi për NMVM-të, që investojnë në modernizim teknologjik, digjitalizim, eficiencë energjetike dhe zgjerim të kapaciteteve prodhuese me fokus eksportin.

-Reduktimi i pengesave të kolateralit dhe nxitja e kreditimit bankar në sektorët prioritarë përmes skemave të garancisë sovrane (40–70%) dhe partneriteteve me institucionet financiare ndërkombëtare (IFI).

-Harmonizimi i linjave buxhetore dhe fondeve për inovacionin dhe tranzicionin e gjelbër në një instrument të vetëm të unifikuar, duke rritur transparencën dhe kapacitetin obsorbues të ndërmarrjeve nëpërmjet asistencës teknike.

**Përshkrimi:** Kjo masë përfaqëson një reformë strukturore në ekosistemin e financimit të biznesit në Shqipëri, duke synuar kalimin strategjik nga mbështetja e fragmentuar përmes granteve drejt instrumenteve të avancuara të ndarjes së riskut që aktivizojnë kapitalin privat. Programi "Dyfisho sipërmarrjen tënde" konsolidon mbështetjen për modernizimin dhe transformimin teknologjik të NVM-ve, duke adresuar pengesën kryesore të kreditimit: mungesën e kolateralit dhe kapacitetin e kufizuar të vlerësimit të investimeve.

Në zbatim të vendimit nr. 518, datë 30.6.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 463, datë 31.7.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e skemës së veçantë të garancisë shtetërore të huas për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë", kjo masë zgjeron eksperiencën e suksesshme të garancisë sovrane bujqësore në gjithë sektorët prioritarë të ekonomisë, duke ofruar garanci shtetërore (në nivele 40–70%) për huat bankare. Instrumenti mundëson lidhjen e financimit me rezultate të matshme ekonomike: rritje të produktivitetit, modernizim të proceseve prodhuese, digjitalizim, përmbushje të standardeve ndërkombëtare dhe rritje të kapaciteteve eksportuese. Për të garantuar efektivitetin e absorbimit të kapitalit, masa shoqërohet me një komponent të rëndësishëm, atë të asistencës teknike (grant), e cila ndihmon ndërmarrjet në *investment-readiness* – nga analiza e nevojave financiare deri tek formulimi i planeve të biznesit. Përmes kësaj ndërhyrjeje, MEI krijon urën lidhëse ndërmjet burimeve financiare dhe objektivave strategjikë të ndërlidhjes së industrisë vendase në zinxhirët e vlerës të Bashkimit Evropian. Fokusi do të jetë mbështetja e ndërmarrjeve, pjesë e ekosistemeve prioritare (*Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), Energjia e pastër, eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmi*).

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Operacionalizimi i garancisë "Dyfisho ndërmarrjen" (VKM 518/2026) dhe lançimi i thirrjeve | 2026–2027 | MEI, MF, BSH |
| 2. Gatishmëria për investime dhe edukimi financiar për NVM-të | 2026–2027 | AIDA |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Investime private të mobilizuara përmes instrumenteve | 0 EUR (2025) | ≥ 500 mln EUR kum. (2028) | ≥ 2mld EUR kum. |
| Ndërmarrje prodhuese me hua të garantuara për modernizim | 0 (2025) | 45 kum. (2028) | 110 kum. |

ANEKS NR. 10

*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M 1.2.11 – Krijimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit (FSHI): Instrumenti sovran i bashkinvestimit për rritjen e konkurrueshmërisë dhe ndërmarrjet me rritje të lartë (*scale-up*)**

**Objektivat:**

-Krijimi dhe zbatimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit (FSHI), një mjet sovran i financimit të përzier që kombinon grantet e pakthyeshme me bashkinvestimin në kapital, për të adresuar hendekun e financimit, me të cilin përballen *startup*-et dhe ndërmarrjet novatore shqiptare në fazën e rritjes ("*Scale-Up*").

-Përmirësimi i aksesit në kapitalin e rritjes për ndërmarrjet me potencial të lartë, duke mbështetur kalimin e tyre nga mbështetja në fazat e hershme drejt rritjes së qëndrueshme dhe integrimit në zinxhirët e vlerës evropiane.

-Aktivizimi i investimeve private paralelisht me kapitalin publik, duke operuar në përputhje me rregullat për ndihmën shtetërore.

-Ndërtimi i kapaciteteve institucionale për një model të qëndrueshëm dhe të orientuar nga tregu për financimin e inovacionit, të harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian për mjetet e investimit kolektiv.

**Përshkrimi:** Ndërmarrjet shqiptare që e kanë kaluar fazën e "*startup*"-it përballen me një hendek financimi të dokumentuar si: aksesi i kufizuar në kapitalin e rritjes pengon aftësinë e tyre për të shkallëzuar prodhimin, për të adoptuar teknologji të avancuara dhe për t'u zgjeruar në tregjet ndërkombëtare. Duke u mbështetur në përvojën e shpërndarjes së 12 milionë eurove në formë grantesh gjatë tri viteve të fundit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), nëpërmjet agjencisë "*Innovation4Albania*", do të projektojë dhe do të krijojë Fondin Shqiptar të Inovacionit (FSHI).

FSHI është konceptuar si një instrument i financimit të përzier, që kombinon një dritare grantesh, të përqendruar te *startup*-et dhe komercializimi i kërkimit, me një dritare investimi në kapital, duke u mundësuar ndërmarrjeve të përparojnë nga mbështetja e fazave të hershme drejt financimit për rritje (*Scale-Up*). Dritarja e kapitalit do të operojë mbi baza bashkinvestimi paralelisht me investitorët privatë, në kushte tregu, në mënyrë që kapitali publik të aktivizojë dhe jo të zëvendësojë investimin privat. Fondi do të qeveriset nga një strukturë menaxhuese e ngjashme me fondet e konsoliduara që operojnë në BE, duke ndarë mbikëqyrjen strategjike nga vendimmarrja për investimet, për të siguruar që vendimet të merren mbi baza meritokracie dhe të jenë të izoluara nga ndikimi politik, në përputhje me standardet që kërkohen nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe rregullat e Bashkimit Evropian për ndihmën shtetërore.

Kapitalizimi i saktë, vlerat e investimeve, përparësitë sektoriale dhe parametrat operativë të Fondit do të përcaktohen gjatë fazës së projektimit (aktiviteti 1 më poshtë), duke u bazuar në vlerësimin e ekosistemit dhe punën e standardizimit (*benchmarking*), që është kryer tashmë.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Projektimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit: struktura ligjore, modeli i qeverisjes, strategjia e kapitalizimit dhe dritaret e investimit. | 2026–2027 | MEI (Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit), Ministria e Financave, Agjencia "*Innovation4Albania*" |
| 2. Hartimi i bazës ligjore, licencimi dhe kapitalizimi i Fondit | 2027–2030 | MEI (Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit), Ministria e Financave, AFSA (Autoriteti i Mbikëqyrjes |

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| | | Financiare), institucionet financiare ndërkombëtare |
| 3. Lançimi i dritareve të granteve dhe bashkinvestimit në kapital të Fondit. | | Shoqëria Menaxhuese e FSHI-së (AIF), Agjencia "*Innovation4Albania*" |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2027 |
|---|---|---|---|
| Fondi Shqiptar i Inovacionit i projektuar, i krijuar me një bazë ligjore dhe i kapitalizuar | I pakrijuar (2026) | Fondi i themeluar ligjërisht (2027) | Plotësisht funksional, të dyja dritaret të vëna në zbatim |
| Ndërmarrje të mbështetura përmes granteve dhe/ose dritareve të investimit në kapital të Fondit | 0 (2026) | Për t'u përcaktuar gjatë fazës së projektimit të Fondit | Për t'u përcaktuar gjatë fazës së projektimit të Fondit |
| Kapital privat i mobilizuar paralelisht me investimin publik | 0 € (2026) | - | Për t'u përcaktuar gjatë fazës së projektimit të Fondit |

ANEKS NR. 11
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M 1.2.12 – Përmirësimi i mjedisit rregullator për NMVM-të: Implementimi i "SME Test" dhe kuadri për pagesat e vonuara**

**Objektivat:**

- Integrimi i detyrueshëm i testit të NMVM-ve (SME Test) me metodologji sasiore brenda procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA), me qëllim parandalimin e barrierave administrative dhe kostove të tepërta për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme gjatë hartimit të legjislacionit të ri;
- Harmonizimi i kuadrit rregullator me Direktivën 2011/7/BE për luftën e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare;
- Garantimi i mekanizmave efektivë të monitorimit dhe zbatimit të afateve kontraktuale, me qëllim mbrojtjen e likuiditetit të ndërmarrjeve prodhuese në transaksionet tregtare.

**Përshkrimi:** Kjo masë synon transformimin e mjedisit rregullator për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri, duke integruar në mënyrë të detyrueshme testin e NMVM-ve (*SME Test*) me metodologji sasiore brenda sistemit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA). Ky instrument, i cili vjen si përgjigje direkte ndaj gjetjeve të raportit të OECD-së 2026, do të shoqërohet me trajnimin e dedikuar të administratës publike dhe do të pilotohet në të gjitha aktet normative me ndikim të lartë industrial për të parandaluar mbingarkesat administrative. Paralelisht, masa garanton përafrimin legjislativ me direktivën 2011/7/BE përmes amendimit të ligjit nr.48/2014, brenda vitit 2026, për krijimin e një klime biznesi më të besueshme dhe konkurruese, e cila nxit marrëdhënie të qëndrueshme B2B dhe forcon besimin e investitorëve në ekonominë shqiptare.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Metodologjia SME Test, integrimi në RIA, trajnimi dhe pilotimi | 2026–2028 | MEI, Kryeministria (Dep. RIA) |
| 2. Tabela e përputhshmërisë me 2011/7/BE, drafti i ligjit 48/2014, miratimi | 2026–2027 | MEI |
| 3. Pyetësori, ndërmjetësimi pilot dhe fushata e ndërgjegjësimit | 2026–2030 | MEI, Dhoma e Ndërmjetësimit, AIDA |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Akte të reja me ndikim mbi industrinë/NVM-të me SME Test sasior | 0% (2025) | 50% (2027) | 100% |
| Përafrimi me direktivën 2011/7/BE | Tabela (2026) | Ligji i miratuar (2027) | Zbatim i monitoruar |
| Koha mesatare e pagesës B2B në sektorët prodhues | Pyetësori 2026 | -10% (2029) | -20% |

ANEKS NR. 12
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M 1.2.13 – Programi kombëtar i zhvillimit të klasterave industriale dhe integrimi në zinxhirët e IHD-ve**

**Objektivat:**

-Krijimi dhe funksionimi i klasterave në ekosistemet prioritare (Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), Energjia e pastër, eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmi) për të rritur volumin dhe kapacitetet teknike të ndërmarrjeve vendase (NMVM), duke i transformuar ato nga prodhues të thjeshtë me kosto të ulët në partnerë të besueshëm dhe të gatshëm për t'u integruar në zinxhirët e furnizimit të investitorëve të huaj.

-Zbatimi i një sistemi nxitës për investitorët e huaj (IHD), që kushtëzon stimujt me rezultate të matshme në integrimin lokal, duke prioritizuar projektet, që garantojnë transferim të njohurive, zhvillim të rrjetit të furnizuesve vendas dhe bashkëpunim në projekte inovative e teknologjike me klasterat ekzistues.

-Ndërtimi i një strukture të qëndrueshme menaxheriale për klasterat vendas, përmes programeve të trajnimit dhe certifikimit të menaxherëve, për të rritur konkurrueshmërinë e ekosistemeve industriale shqiptare.

**Përshkrimi:** Masa synon krijimin dhe funksionimin e klasterave si instrumente të politikës së investimeve të huaja direkte (IHD-ve). Qëllimi është transformimi industrial nga një destinacion për "kosto të ulët" në një destinacion për "vlerë të integruar", ku investitorët e huaj nuk operojnë në izolim, por si pjesë e një ekosistemi vendas. Kjo masë shërben si urë lidhëse midis prodhimit vendas dhe zinxhirëve të vlerës ndërkombëtare. Masa synon formalizimin dhe fuqizimin e menaxhimit të klasterave në ekosistemet prioritarë, për t'i bërë ata "të gatshëm për tregun". Kjo rrit volumet dhe kapacitetet teknike të ofertës vendase, duke krijuar një zinxhir furnizimi të konsoliduar që u përgjigjet kërkesave specifike të investitorëve të mëdhenj në vendin tonë. Masa synon formalizimin dhe fuqizimin e menaxhimit së

klasterave të NMVM-ve, me synim arritjen e volumit dhe kapaciteteve teknike të kërkuara nga investitorët e huaj. Masa synon konsolidimin e ofertës vendase dhe përmirësimin e lidhjeve të biznesit mes ndërmarrjeve vendase dhe industrive të mëdha.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Kuadri Operacional Kombëtar për Klasterat (udhërrëfyesi me faza, mbështetja e shkallëzuar, kriteret e daljes) + përshtatja e stimujve për IHD-të | 2026–2027 | MEI, AIDA |
| 2. Fondi për krijimin dhe zhvillimin e Klasterave | 2027–2030 | AIDA, MEI |
| 3. Platforma e Lidhjes IHD–NVM: *checklist* blerësi, *mock audits* me ritestim 30-ditor, regjistri publik i furnizuesve gati, ndërmjetësimi i porosive të provës | 2027–2030 | AIDA |
| 4. Regjistrimi në ECCP dhe pjesëmarrja në ESCP-S3/Euroclusters | 2027–2030 | AIDA, MEI |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Vlera e kontratave të reja të furnizimit NVM–IHD të lidhura përmes programit | 0 EUR (2025) | ≥ 5 mln EUR kum. (2028) | ≥ 25 mln EUR kum. |
| NVM me status "gatishmëri furnizimi" të certifikuara | 0 (2025) | 25 (2028) | 90 |
| Klastera të regjistruar në ECCP/partneritete evropiane | 0 (2025) | 3 në ECCP (2028) | ≥ 5; ≥ 2 në ESCP-S3 |

Tabela 13. Masat në fushën e ndërhyrjes "Zhvillimi i kapitalit njerëzor"

| Veprimet prioritare | Përshkrim përmbledhës |
|---|---|
| **Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues** | Si *startup*-et ashtu dhe NVM-të e krijuara shpesh përballen me sfida nga mungesa e punonjësve të aftë, veçanërisht për pozicione pune që kërkojnë më shumë aftësi. Në bazë të rekomandimeve të Planit të Veprimit të Spirales së Trefishtë do të zhvillohet një skemë mbështetëse për të rritur bazën e aftësive dhe për të eksploruar qasje të reja për promovimin e bashkëpunimit dhe mobilitetit ndërmjet shkollës dhe bizneseve. Kjo skemë do të ofrojë mbështetje financiare për punësimin e talenteve të kualifikuara në K&ZH dhe projekte inovacioni, dhe mbulon dy komponentë: **1. Asistencë për NVM-të që punësojnë të sapodiplomuarit e talentuar për projekte inovacioni:**<br>Të sapodiplomuarit do të punësohen për detyra në fushën e kërkimit dhe zhvillimit, zhvillimit/përmirësimit të produkteve |

dhe proceseve të reja, kërkim tregu dhe zhvillimi biznesi për inovacionin.

Kjo skemë do të ofrojë subvencion page që mbulon deri në 50% të pagës bruto si dhe shpenzimet që lidhen me punën (si p.sh. trajnimet) e një të sapodiplomuari nga një NVM për të punuar në projekte inovacioni, për një periudhë deri në 18 muaj. Kontributi maksimal do të arrijë vlerën 4,500 euro për një person (25 euro në muaj).

Të sapodiplomuarit do të punësohen përsëri dhe për herë të parë. I sapodiplomuari nuk duhet të zëvendësojë një pozicion ekzistues.

**2. Asistencë për studentët doktorantë:**

Programi i doktoraturës industriale është projekt kërkimi dhe program PHD i fokusuar tek industria dhe zhvillohet bashkërisht nga një kompani e sektorit privat, një kandidat për PhD industriale dhe një institucion të arsimit të lartë. Kandidati për PhD industriale punësohet nga kompania dhe në të njëjtën kohë regjistrohet në institucionet e arsimit të lartë dhe punon për të njëjtin projekt në të dy vendet. Kandidati duhet ta shpenzojë të gjithë kohën e punës duke punuar mbi projektin dhe nuk mund të kryejë detyra të tjera. Kompania merr një subvencion page për pagesën e kandidatit (p.sh. deri në 50% të pagës së plotë bruto/deri në 200 euro në muaj) për një periudhë deri në tre vjet. Institucionet e arsimit të lartë marrin një subvencion për mbikëqyrjen, pajisjet dhe shpenzime të tjera për arsimimin e kandidatit (p.sh. deri në 2,000 euro në vit).

Për koordinimin e skemës nevojitet një pozicion shtesë për AIDA-n, e cila do të mbështesë, gjithashtu, zbatimin e skemës së mbështetjes së sipërmarrjes (veprimi prioritar 2.1). Gjatë fazës së hartimit, do të vlerësohet nëse është e nevojshme të ndryshohet kuadri ligjor/rregullator. Bazuar në vlerësimet e përvojës së fituar, programi mund të zgjerohet në grupe të mëtejshme të synuara.

Prezantimi do të shoqërohet me një sërë masash komunikimi. Promovimi do të përshtatet sipas grupeve të synuara (NVM-të, institucionet e arsimit të lartë, të diplomuarit/doktorantët) dhe do të përfshijë aktivitete dhe njoftime në botimet e bashkimit të dhomave të tregtisë dhe industrisë dhe shoqatave të biznesit, institucionet e arsimit të lartësi dhe në materialet e orientimit në karrierë dhe informacionet e shërbimeve të punësimit (p.sh. broshura, udhëzime).

Projektimi dhe zbatimi i një skeme mbështetëse që përfshin:

- Asistencë për NVM-të që punësojnë të sapodiplomuarit për projekte inovacioni.

- Asistencë për studentët doktorantë që janë punësuar në NVM dhe në të njëjtën kohë janë regjistruar në institucionet e arsimit të lartë, të cilët punojnë për një projekt të përbashkët kërkimi.

| | |
|---|---|
| | - Do të krijohen programet “Inovacion dhe ekselencë në manifakturë” dhe “Inovacion dhe ekselencë në IT” për trajnime në inovacion, disenjim, marketing, kërkim dhe zhvillim nëpërmjet mbulimit të kostove të trajnimit 100%. Kostot do të rimbursohen 50% direkt dhe 50% si 2-fish i tatimit të zbritshëm ndaj shoqërive ku është i punësuar përfituesi. Kostot e këtyre programeve do të përcaktohen gjatë përgatitjes së politikave fiskale në vijim. |
| | |
| ***Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në reformat e sistemit të VET-së*** | *Ky veprim adreson nevojën për sensibilizimin dhe përfshirjen e bizneseve në prezantimin e modelit të dyfishtë të VET-së. Zhvillimi i tryezave të rrumbullakëta me agjenci shtetërore dhe shoqatat e biznesit do të zhvillohen për të paraqitur dhe diskutuar tiparet kryesore të modelit të dyfishtë të VET-së. Bazuar në këto konsultime do të identifikohen nevojat kryesore të bizneseve. Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në procesin e integrimit më të fuqishëm të aftësive të ekonomisë digjitale, të gjelbër në sistemin e VET-së përbën një aktivitet të rëndësishëm që përfshin identifikimin e nevojave të bizneseve, bazuar në studimet e kërkesave për aftësi dhe integrimin e bizneseve në grupet e punës.*<br>*Konsultime të mëtejshme do të zhvillohen për të analizuar gjetjet dhe për të përgatitur rishikimin e kurrikulave ekzistuese apo të zhvillimit të kurrikulave të reja.*<br>*Pajisja e bizneseve me aftësitë e nevojshme për transformimin digjital dhe të gjelbër.*<br>*Nxitja e lidhjeve të forta ndërmjet institucioneve arsimore dhe bizneseve.*<br><br>***Aktiviteti:*** *Ndërgjegjësimi dhe përfshirja e bizneseve në prezantimin e modelit të VET-së në periudhën 2025–2027.*<br>***Institucionet përgjegjëse:*** *MEKI dhe AKPA* |

***Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara***

| ***Treguesit*** | ***Baza bazë (viti 2024)*** | ***Vlera e synuar*** | | |
|---|---|---|---|---|
| | | ***2025*** | ***2026*** | ***2027*** |
| *Numri i aktiviteteve, në të cilat prezantohen/diskutohet me bizneset modeli i VET-së.* | | *5* | *5* | |
| *Nr. i kurrikulave të rishikuara/të reja me* | | *5* | *5* | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *përfshirjen e bizneseve në studimet dhe konsultime.* | | | | |
| **Sistemi i parashikimit të nevojave për aftësi** | Zhvillimi i aftësive dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës kanë rëndësi thelbësore për një rritje, produktivitet dhe invovacion të qëndrueshëm. Vetëm me aftësitë e duhura do të mundet Shqipëria të forcojë pozicionin e saj në konkurrencën dhe zinxhirët e vlerave ndërkombëtare dhe të ketë një rimëkëmbje ekonomike të qëndrueshme pas krizës së pandemisë. Inteligjenca e shëndoshë e aftësive formon pikën e nisjes për të garantuar ofrimin e arsimit dhe formimit modern dhe dinamik në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe ato shoqërore.<br>Në zbatim të kërkesave të *"Small Business Act"* do të hartohet një sistem parashikimi, për të kryer parashikimin periodik afatmesëm/gjatë të nevojave (për pesë vitet e ardhshme) për aftësi.<br>Në bashkëpunim me partnerët dhe ekspertët ndërkombëtarë dhe bazuar në praktikën e mirë ndërkombëtare do të zhvillohet një sistem i besueshëm. Ky sistem do të ndërtohet bazuar në vlerësimin e nevojave për aftësi në Shqipëri. Do të kombinohen instrumente/metoda të ndryshme, duke marrë në konsideratë informacione sasiore dhe cilësore për të arritur rezultate të konsoliduara, të tilla si: sondazhe mbi aftësitë punëdhënës-punëmarrës, gjurmimi i të sapodiplomuarve, grupe fokusi/ekspertësh, forume për evidentimin e aftësive dhe konsorciume sipas sektorëve.<br>Të gjitha palët e interesit si NVM-të, institucionet arsimore, shërbimet e punësimit dhe shoqatat e biznesit dhe ministritë përkatëse do të angazhohen për të garantuar që vlerësimi i aftësive dhe ushtrimet përgatitore të ofrojnë informacion në një format dhe nivel që përputhet me objektivat e politikës dhe të bëhet pjesë e veprimit politik.<br>Sistemi i zhvilluar do të përdoret për të kryer parashikime të nevojave për trajnim çdo 2–3 vjet, duke forcuar kapacitetet dhe infrastrukturën për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit. Përveç parashikimit të përgjithshëm të nevojave, do të integrohen dhe parashikime të tjera tematike, duke u fokusuar për shembull në digjitalizimin, specializimin inteligjent, të mësuarit gjatë gjithë jetës apo rajone/industri specifike. Raportet e gjeneruara do të lejojnë nxjerrjen e konkluzioneve dhe kryerjen e rregullimeve, p.sh., në programet dhe kurrikulat arsimore, për t'i përshtatur ato me kërkesat e ardhshme të tregut të punës. | | | |
| **Vlerësim periodik i nevojave për trajnim** | Bizneset shqiptare shprehen se pengesa kryesore në mjedisin e biznesit është fuqia punëtore e patrajnuar si duhet. Për shkak të përmasave të tyre të vogla, veçanërisht NVM-të e kanë të vështirë të plotësojnë nevojat e tyre për arsim dhe trajnim dhe nuk kanë burime për identifikimin e nevojave dhe për të | | | |

| | |
|---|---|
| | investuar në trajnime. Megjithatë, veprimtaritë arsimore dhe ato të rritjes së aftësive janë thelbësore për bizneset, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të përballojnë transformimin e zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, tregun e vetëm, specializimin inteligjent, si dhe transformimin e gjelbër dhe digjital. Sipas raporteve të fundit, trajnimet aktuale nuk i plotësojnë nevojat e bizneseve.<br>Në këtë kuadër, ky veprim prioritar fokusohet në vlerësimin periodik të nevojave për trajnim (VNT), i plotësuar shërbime mbështetëse për NVM-të, të cilat do të zhvillohen në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë.<br>Ky vlerësim do të evidentojë nevojat afatshkurtra për trajnim, duke përfshirë nevojat e sipërmarrësve dhe punonjësve të tyre. Do të bazohet në studimet kombëtare për bizneset, raste studimi dhe konsultime të mëtejshme me komunitetin e biznesit/palët e interesit dhe do të mbështetet në studimet e fundit mbi nevojat për trajnim të kryer nga AIDA. Rezultatet do të shërbejnë si bazë për vendimmarrësit për të mundësuar përputhjen e trajnimeve të ofruara me kërkesat e NVM-ve dhe për të zhvilluar struktura mbështetëse të shënjestruara.<br>Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë do të prezantohen shërbime të tjera për NVM-të, për t'i mbështetur ato në identifikimin e nevojave të brendshme dhe në gjetjen e ofertave të përshtatshme për trajnim, duke plotësuar vlerësimin e nevojave për trajnim. Në këtë kontekst, parashikohet një pozicion shtesë brenda AIDA-s, i cili do të jetë pika kryesore e kontaktit për bizneset, dhe do të ofrojë shërbime informacioni dhe këshillimi. Përveç asistencës bilaterale, AIDA do të organizojë *workshop*-e dhe *webinar*-e me mbështetjen e ekspertëve të jashtëm dhe partnerëve të tjerë si dhe shoqatat e biznesit, p.sh., mbi metodologjitë dhe përfitimet e biznesit nga analiza e nevojave për trajnim. Për zbatimin e analizës së brendshme të nevojave për trajnim do të përgatiten lista dhe manuale të cilat do të publikohen *online*. Gjithashtu, do të ndërtohet një platformë *online*. Ajo do të sigurojë informacion mbi ofertat specifike në nivel rajonal ose në nivel industrie (duke përfshirë kontaktet) dhe do të promovojë aktivitete dhe histori suksesi. |

## 5. Metodologjia

Siç është shpjeguar në nënkapitullin 2, kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike të këtij dokumenti, përputhet plotësisht me dokumentet strategjikë në nivel ndërkombëtar e kombëtar të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave duke bërë që vizioni, objektivat strategjikë dhe specifikë të parashikuar të përputhen plotësisht me këto dokumente strategjike.

Nisma për hartimin e këtij dokumenti strategjik u ndërmor nga autoriteti kryesor përgjegjës, pra Ministria përgjegjëse për ekonominë e cila punoi ngushtësisht me Grupin Ndërinstitucional të Punës të përbërë nga përfaqësuese dhe përfaqësues të ministrive kryesore

të linjës. Mbështetja dhe orientimi bazuar te raporti i vlerësimit të zbatimit të SZHBI 2021–2027 ka qenë tepër ndihmuese. Gjithashtu vlen të përmendet dhe mbështetja e veçantë e ofruar nga Projekti *Proseed*, përmes një grupi ekspertësh, të cilët lehtësuan punën e GNP-së në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri te kostimi dhe përgatitja e pasaportës së treguesve.

Gjatë punës për përgatitjen e dokumentit janë realizuar një sërë konsultimesh me aktorë dhe bashkëpunëtorë të rëndësishëm në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore (kryesisht me nëpunësët/nëpunësit e nxitjes së biznesit dhe investimeve në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore, akademia, organizatat e shoqërisë civile, si dhe me komunitetin e organizatave ndërkombëtare, të cilët kanë në fokus çështjet e zhvillimit të biznesit dhe tërheqjes së biznesit).

Gjithashtu, ky dokument do të publikohet për konsultim publik.

## PJESA II – QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT PRIORITARE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË

"SZHBI 2021 – 2027" përbëhet nga qëllimi kryesor si vijon:

"Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës."

Arritja e këtij qëllimi kërkon përpjekje të gjithanshme nga të gjitha ministritë dhe institucionet që zbatojnë politika, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e biznesit dhe tërheqjen e investimeve. Një nevojë e domosdoshme dhe e vazhdueshme është gjetja e mekanizmave të duhur dhe të përshtatshëm që sigurojnë një bashkëpunim të fortë dhe efektiv ndërinstitucional si në drejtimin horizontal ashtu dhe atë vertikal.

Bashkëpunimi me akademinë, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, kanë, gjithashtu, rëndësi themelore, pasi ato mund të ndikojnë ndjeshëm në ndërgjegjësimin rreth zhvillimit të biznesit dhe investimeve, si dhe ofrimin e ekspertizës për zhvillimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për biznesin.

**Politika I**

**Qëllimi Strategjik I - Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës.**

Për arritjen e këtij qëllimi, janë përcaktuar tri fusha për ndërhyrje dhe objektivat përkatës të politikës, të cilët përmblidhen në paraqitjen si më poshtë:

**Vizioni, fushat e ndërhyrjes dhe objektivat e politikës për SZHBI-në e re**

**Vizioni (objektiva zhvillimi gjithëpërfshirës):**
Një ekonomi shqiptare konkurruese, e nxitur nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe më cilësore, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron transformimi digjital dhe transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, me theksin mbi zhvillimin e qëndrueshëm, integrimin evropian dhe atë rajonal

**Fushat subjekt i ndërhyrjeve dhe objektivat e politikës:**

| Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi | Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni | Zhvillimi i kapitalit njerëzor |
|---|---|---|
| Shpalosja e plotë e potencialit investues për zhvillim ekonomik dhe nxitja e integrimit në tregjet dhe zinxhirin e vlerave ndërkombëtare | Zhvillimi i një ekosistemi dinamik dhe të qëndrueshëm për sipërmarrjen dhe inovacionin | Eksplorimi i mënyrave të reja për të nxitur zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues |

***Treguesit kryesorë të impaktit nën këtë qëllim strategjik janë:***

- Fluksi e IHD-ve në raport me PBB-së;
- Volumi i tërhequr i investimeve;
- Vende pune të reja të krijuara nga zbatimi i projekteve të investimeve;
- Nr. i klientëve të kujdesit ndaj investitorëve;
- Volumi i riinvestimeve;
- Finalizimi i vlerësimit dhe udhëzuesi i reformës për programin TEDA;
- Numri i rezidentëve aktivë në zonën e zgjedhur;
- Eksportet e mallrave dhe shërbimeve në raport me PBB-së;
- Rezultati në Indeksin e Politikave të NMVM-ve – integrimi i NVM-ve në zinxhirët e vlerës globale;
- Ndërmarrjet vendëse, që marrin pjesë në programin e zhvillimit të furnitorëve;
- Vëllimi i nënkontratave të mundësuara nga programi i zhvillimit të furnizuesve;
- Zhvillimi i strategjisë së eksportit;
- Numri i përfituesve të iniciativës për zhvillimin e biznesit elektronik;
- Zgjidhje për biznesin elektronik/tregtinë elektronike të miratuara nga përfituesit e iniciativës për zhvillimin e tregtisë elektronike;
- Angazhimi i Programit *"Connect Albania",* ku ndërmjetësit e investimit të huaj janë nga diaspora;
- Numri i *startup*-ve;
- Pjesëmarrësit në trajnime në skemën e mbështetjes së sipërmarrjes bazuar në konkurrencë;
- Bizneset e reja të regjistruara nga pjesëmarrësit e skemës së mbështetjes së sipërmarrjes të bazuar në konkurrencë;
- Fillimi i Programit të *startup*-eve dhe Inovacionit dhe Agjencisë së *startup;*
- Vende të reja të punës të krijuara nga *startup*-et inovative;
- Numri i *startup*-ve që marrin pjesë në nismën e mentorimit të diasporës;
- Numri i organizatave mbështetëse që bashkëpunojnë me qendra ndërkombëtare;
- Rezultati në Indeksin Global të Konkurrueshmërisë – aftësitë për inovacion;
- Rezultati në Indeksin e Politikave të NMVM-ve - Shërbimet mbështetëse për NMVM-të;
- Numri i konsorciumeve të mbështetur në fazën e zbatimit të iniciativës së zbatimit të zinxhirit të vlerës së bazuar në konkurrencë;
- Numri i vendeve të reja të punës të krijuara nga përfituesit e iniciativës për ngritjen e zinxhirit të vlerës së bazuar në konkurrencë;
- Numri i përfituesve të Fondit të Zhvillimit të NVM-ve;
- Pjesa e grave sipërmarrëse/bizneseve të drejtuara nga gratë mbështetur nga Fondi për Zhvillimin e NMVM-ve;
- Numri i trajnimeve të ofruara, në kuadër të programit të aftësive të ndërmarrjeve për NMVM-të;
- Numri i pjesëmarrësve në trajnime të dhëna në programin e aftësive të ndërmarrjeve për NVMM-të;
- PBB-ja për person të punësuar;

- Numri i përfituesve në skemën e mbështetjes për zhvillimin bashkëpunues të kapitalit njerëzor;
- Numri i NMVM-ve që marrin pjesë në skemën e mbështetjes për zhvillimin bashkëpunues të kapitalit njerëzor;
- Numri i investitorëve/NMVM-ve të mbështetura përmes programit të zhvillimit të fuqisë punëtore;
- Numri i pjesëmarrësve në trajnime të dhëna në programin e zhvillimit të fuqisë punëtore;
- Rezultati në Indeksin e Politikave të NMVM-ve – aftësitë e ndërmarrjes;
- Numri raporteve të parashikimit të nevojave për aftësim;
- Numri i vlerësimeve të trajnimeve të nevojshme.

Për arritjen e këtij qëllimi strategjik, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këto **tre objektiva specifikë:**

| | |
|---|---|
| **Objektivi specifik I.1** | **Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi. Shpalosja e plotë e potencialit investues për zhvillim ekonomik dhe nxitja e integrimit në tregjet dhe zinxhirin e vlerave ndërkombëtare.** |
| **Objektivi specifik I.2** | **Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni. Zhvillimi i një ekosistemi dinamik dhe të qëndrueshëm për sipërmarrjen dhe inovacionin.** |
| **Objektivi specifik I.3** | **Zhvillimi i kapitalit njerëzor. Eksplorimi i mënyrave të reja për të nxitur zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues.** |

Përmbushja e këtyre objektivave do të sjellë një përmirësim të dukshëm në zhvillimin e biznesit dhe investimeve.

Zinxhiri i vlerave ndërkombëtare ka hyrë në një periudhë transformimi, e cila pritet të vazhdojë gjatë të gjithë këtij dhjetëvjeçari. Pavarësisht disa sfidave, ky transformim shpalos mundësi të reja zhvillimi. Shqipëria është e pozicionuar mirë dhe është e vendosur të përfitojë nga këto mundësi.

Kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19 nuk përbën vetëm një sfidë të madhe për ekonominë botërore dhe atë shqiptare. Ajo, gjithashtu, po përshpejton një sërë tendencash madhore, duke ndikuar fuqishëm konfigurimin e zinxhirit të vlerave ndërkombëtare. Transformimi pritet të vazhdojë, i nxitur nga:

- Ndryshimet teknologjike, p.sh., transformimi digjital dhe prodhimi me teknologji të avancuar;
- Tendencat botërore të qeverisjes ekonomike;
- Tendencat e qëndrueshmërisë.
- Me qëllim rritjen e rezistencës ndaj rreziqeve në të ardhmen, kompanitë po ndryshojnë burimin e sigurimit të produkteve dhe vendndodhjen e veprimtarisë. Pavarësisht sfidave të ndryshme, të tilla si ngushtimi i hapësirave për investime efikase, transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare do të shpalosë, gjithashtu, mundësi të mëdha për zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe riindustrializimin e qëndrueshëm në të ardhmen, duke përfshirë:

**- Tërheqjen e projekteve në vendet e afërta:** investitorët që operojnë në vendet e BE-së pritet që të përqendrojnë më shumë aktivitete në afërsi të vendit të tyre të origjinës,

veçanërisht në zinxhirin e vlerave, që lidhen me teknologjinë e lartë, si pajisjet elektronike, makineritë dhe pajisjet që krijojnë mundësi për zhvillimin e industrive dhe tregjeve të reja.

**- Përfitim nga diversifikimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare:** Ndër të tjera, në industri me teknologji të ulët si ajo e tekstileve dhe e modës, por edhe në industri shërbimesh me vlerë më të lartë, shërbimet e biznesit, të teknologjisë së informacionit dhe ato financiare, kompanitë e mëdha ka të ngjarë të diversifikojnë aktivitetet e tyre dhe zinxhirët e furnizimit, duke adoptuar zgjidhje digjitale. Përveç mundësive për investime të reja, ky trend ofron mundësi të mira për integrimin e NVM-ve lokale dhe sipërmarrësve në zinxhirin e vlerave ndërkombëtare.

**- Ndërtimi i zinxhirit rajonal të vlerave:** Një tendencë tjetër e pritshme është një rritje e përsëritjes së zinxhirit të vlerave në nivel rajonal. Kjo tendencë luan një rol të rëndësishëm për industritë e përpunimit në rajon, duke ofruar, ndër të tjera, perspektiva të reja për zhvillimin e zinxhirit të vlerave në sektorin e agropërpunimit.

**- Shfrytëzimi i mundësive që lidhen me kalimin në ekonominë e gjelbër dhe zinxhirë vlerash më të qëndrueshëm dhe qarkullues:** Kompanitë do të ndryshojnë gjithnjë e më shumë zinxhirët e furnizimit, si përgjigje ndaj kërkesës së konsumatorit dhe qeverisë për procese më të qëndrueshme. Pavarësisht sfidave që paraqiten, veçanërisht në lidhje me nevojën e NVM-ve për t'u përshtatur me kërkesat e reja, kalimi në ekonominë e gjelbër siguron, gjithashtu, mundësi premtuese për investime dhe inovacion në të gjithë sektorët e industrisë. Ndërtimi i zinxhirëve qarkullues të vlerave dhe zhvendosja drejt një ekonomike qarkulluese siguron ndikime pozitive mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Rezultate e analizës së fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve të cilat jepen të përmbledhura në tabelën 14, si dhe diskutimet në grupet e punës, konsultimet me palët e interesit dhe intervistat me ekspertë, tregojnë se ekzistojnë parakushtet për të përfituar nga transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare.

ANEKS NR. 13
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

**M 1.3.6 – Paketa kombëtare e aftësive të gjelbra dhe digjitale në industri (*Green & Digital Upskilling)***

**Objektivat:**

-Përshtatja e kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional (AFP) dhe arsimit të lartë me nevojat specifike dhe dinamikat e zhvillimit të ekosistemeve prioritarë industriale.

-Implementimi i programeve të dedikuara të trajnim-kualifikimit për stafin teknik të ndërmarrjeve prodhuese, me fokus të veçantë në automatizimin e proceseve, menaxhimin e mbetjeve industriale (ekonomia qarkulluese) dhe auditimin e eficiencës energjetike.

-Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet ofruesve të arsimit dhe sipërmarrjeve private përmes konsolidimit të skemave të arsimit dual dhe sistemeve të të nxënit të bazuar në punë.

**Përshkrimi:** Masa synon adresimin e aktiviteteve ndaj sfidave të kapitalit njerëzor në industri, duke zgjeruar sistemin ekzistues të parashikimit të nevojave me module të inteligjencës sektoriale sipas ekosistemeve prioritare (*Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), Energjia e pastër, eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmi*). Përmes një bashkëpunimi të strukturuar ndërmjet universiteteve, qendrave të formimit profesional dhe industrisë, do të zhvillohen programe të dedikuara të rikualifikimit dhe ngritjes së aftësive për teknikët në sektorin e manifakturës, me fokus të veçantë në automatizim, menaxhimin e mbetjeve dhe auditimin e energjisë.

Ky proces do të mbështetet nga modernizimi i kurrikulave të AFP-së dhe arsimit të lartë, ngritja e partneriteteve të drejtuara nga vetë industria dhe funksionalizimi i një platforme digjitale të aftësive.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| Analiza e aftësive sektoriale sipas ekosistemeve prioritare | 2026–2030 | MEI, MAS, institucionet e arsimit të lartë |
| Programet e rikualifikimit për teknikët e fabrikave (me universitetet/QFP-të) në ekosistemet industriale | 2026–2030 | MEI, AKPA, INSTAT |
| Modernizimi i kurrikulave AFP/arsim i lartë për profilet industriale | 2026–2029 | MAS, AKPA, MEI |
| Platforma digjitale e aftësive | 2026–2027 | AKSHI, MEI, AKPA |

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

| Treguesi | Baza | Synimi i ndërmjetëm | Synimi 2030 |
|---|---|---|---|
| Punonjës të trajnuar në aftësi të gjelbra/digjitale (≥40% gra) | 0 (2025) | 1 000 kum. (2028) | 3 000 kum. |
| Ndërmarrje që raportojnë vështirësi në gjetjen e aftësive | Matja 2026 | -10 pp (2028) | -20 pp |
| Kurrikula të modernizuara për profilet e ekosistemeve prioritare | 0 (2025) | 5 (2028) | 10 |

Tabela 14. Analiza e fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve kyçe

| Fuqitë | Dobësitë |
|---|---|

| | |
|---|---|
| - Vendndodhja e afërt me BE-në dhe afërsia dhe aksesi në tregjet e mëdha bazuar në MTL-të<br>- Kosto operacionale konkurruese<br>- E pasur në vlera dhe burime natyrore<br>- Negociatat për aderimin në BE dhe integrimi në tregjet rajonale në kuadër të Zonës Rajonale Ekonomike<br>- Regjim i liberalizuar për tregtinë dhe investimet dhe mbështetje specifike për projektet e investimeve strategjike<br>- Mjedis i larmishëm i kompanive, numri në rritje i vlerës së shtuar të NVM-ve<br>- Biznese që ofrojnë mjedis optimal/raste suksesi në fushën e kërkimit dhe mjedisit të biznesit<br>- Shërbime me një ndalesë (*one-stop-shop*), p.sh. për regjistrimin, digjitalizimi i shërbimeve qeveritare<br>- Novacioni, sipërmarrja dhe aftësitë (digjitale) janë përfshirë në agjendën e politikave, përmirësimi i paketës së politikave<br>- Progres në reformat kurrikulare (të bazuara në kompetenca) në fushën e arsimit dhe formimit<br>- Popullsi në moshë të re, njohuri të gjuhëve të huaja dhe numër i madh i të diplomuarve në institucionet e arsimit të lartë<br>- Shkallë e lartë punësimi dhe kënaqësisë së bizneseve me aftësitë e fuqisë punëtore | - Mangësi në infrastrukturën e transportit dhe mungesa e një portofoli të fushave të investimit i orientuar drejt nevojave<br>- Shkallë e ulët e eksporteve dhe diversifikimit në shportat e eksportit me teknologji të ulët<br>- Numër i lartë i ndërmarrjeve të vogla me kapacitete të kufizuara për përthithjen/prezantimin e inovacionit, bazë e ngushtë furnizimi<br>- Treg i vogël lokal, nivel i ulët specializimi dhe mungesë e "masës kritike" për një sërë instrumentesh politike<br>- Vështirësi për akses në financë për NVM-të dhe *startup*-et<br>- Fazë e hershme për ekosistemin e inovacionit dhe sipërmarrjes me mbështetje/burim financimi të kufizuar dhe mungesë bashkëpunimi ndërmjet aktorëve<br>- Nivel i ulët i shpenzimeve për K&ZH, botime SHTI<br>- Emigracion i vazhdueshëm<br>- Punësim informal, papunësi e të rinjve, pjesëmarrje e ulët e grave<br>- Vështirësi nga ana e bizneseve për të rekrutuar staf të ri me kualifikimet e duhura<br>- Mospërputhje e aftësive, mangësi në sistemin e arsimit dhe formimit (veçanërisht aftësitë praktike)<br>- Produktivitet i ulët, pjesërisht i shkaktuar nga transformimi i ngadaltë drejt veprimtarive me produktivitet më të lartë. |
| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| - Proceset e integrimit në nivel rajonal dhe të BE-së<br>- Përmirësimi i aksesit në tregje<br>- Sigurim i bashkëpunimit premtues dhe mundësive të financimit për disa fusha të politikës<br>- Rritja e tërheqjes së Shqipërisë si destinacion për investime dhe *startup*-e<br>- Mundësi për investime dhe eksporte në kontekstin e transformimit të zinxhirit të vlerave ndërkombëtare (p.sh., mundësi për tërheqjen e projekteve në vendet e afërta)<br>- Efekti *spill-over* nga projektet e IHD-ve që mbështesin transferimin e inovacionit dhe | - Ngadalësimi i procesit të integrimit në BE dhe rajon, çka dobëson vrullin edhe kufizon mundësitë e financimit dhe bashkëpunimit<br>- Paqëndrueshmëria politike në rajon<br>- Rënia e IHD-ve që kërkojnë eficiencë<br>- Ndërprerje serioze e shkaktuar nga kriza e COVID-19, që ndikon në zinxhirët e vlerave ndërkombëtare, tregtinë dhe fluksin e investimeve, si dhe konkurrueshmërinë e NVM-ve (p.sh. burimet për rritjen e aftësive)<br>- Rritje e proteksionizmit në nivel ndërkombëtar<br>- Ndikim i ulët i projekteve të investimit në ekonominë rajonale si pasojë e ndërlidhjeve |

| | |
|---|---|
| zhvillimin e aftësive<br>- Angazhimi i ndërmjetësve nga diaspora në programin “Connect Albania” në investimet e huaja<br>- Zgjidhjet digjitale për përmirësimin e aksesit në tregje për NVM-të dhe zgjerimin e masave për promovimin/ lehtësimin e investimeve dhe eksportit<br>- Potencialet për inovacion dhe rritje lidhur me specializimin inteligjent, si dhe transformimin digjital dhe të gjelbër<br>- Përdorimi i njohurive dhe i burimeve të diasporës për zhvillimin e mëtejshëm të ekosistemit të *startup*-eve dhe inovacionit<br>- Shpalosja e plotë e potencialeve sipërmarrëse dhe të fuqisë punëtore (p.sh. duke mbajtur talentet, promovuar aftësitë sipërmarrëse të grave) | të kufizuara dhe fokusit në vende pune cilësore<br>- Rritja e konkurrencës nga destinacione të tjera investimi<br>- Sfidat e NVM-ve për përshtatjen e modeleve dhe proceseve të tyre të biznesit në kontekstin e transformimin të gjelbër dhe atij digjital<br>- Nivel i lartë i largimit të trurit çka kufizon potencialin për sipërmarrje, inovacion dhe rekrutim |

- Ekzistojnë disa dobësi të natyrës strukturore, që duhen adresuar, p.sh.:
- Mangësitë në infrastrukturën e transportit dhe mungesa e një portofoli të fushave të investimit i orientuar drejt nevojave;
- Faza e hershme në të cilën ndodhet ekosistemi i inovacionit dhe i sipërmarrjes, me lidhje të dobëta;
- Niveli i ulët i specializimit dhe numri i madh i bizneseve të vogla me orientim të kufizuar drejt eksportit dhe inovacionit;
- Vështirësi në aksesin në financë;
- Mospërputhje e aftësive;
- Nivel i lartë i largimit të trurit.

Në të njëjtën kohë, pozicioni konkurrues i Shqipërisë është përmirësuar ndjeshëm duke marrë në konsideratë proceset integruese në nivel rajonal dhe të BE-së. Të dyja këto procese sigurojnë, gjithashtu, bashkëpunime premtuese dhe mundësi financimi me qëllim nxitjen e zhvillimit, në nivel rajonal dhe integrimit në zinxhirin e vlerave ndërkombëtare, duke u bazuar në fuqitë e Shqipërisë, p.sh.:

- Pozicioni gjeografik strategjik dhe aksesi në tregjet kyçe;
- Kosto operacionale konkurruese;
- E pasur në vlera dhe burime natyrore;
- Populsi në moshë të re me njohuri të gjuhëve të huaja dhe numër i madh i të diplomuarve në institucionet e arsimit të lartë.

Transformimi i zinxhirit të vlerave përbën një trend që ka nisur në dekadën e fundit dhe do të vazhdojë deri në fund të kësaj dekade. Është një proces i gjatë dhe komplek, i cili kërkon një qasje strategjike dhe afatgjatë. Përmes kësaj strategjie, Qeveria Shqiptare po e ofron këtë qasje.

Shfrytëzimi i mundësive kërkon një qasje të targetuar dhe koherente:

- Përqendrimi në zinxhirët e vlerave që ofrojnë mundësitë më të mëdha, duke marrë në konsideratë procesin e transformimit;
- Shpalosja e plotë e potencialit investues për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm;

- Vendosja e theksit në zhvillimin e ekosistemeve dinamike industriale, inovative dhe sipërmarrëse;
- Rritja e efektivitetit të skemave mbështetëse për sipërmarrësit dhe NVM-të, si shtylla e ekonomisë shqiptare;
- Zhvillimi përmes rrugëve më inovative dhe të bazuara në njohuri, me në fokus rritjen e cilësisë dhe të punësimit;
- Eksplorimi i mënyrave të reja për të nxitur zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues.

Më poshtë, paraqitet një përmbledhje e objektivave, rezultateve, masave dhe indikatorëve matës të strategjisë.

**Objektivi specifik I.1. "Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi"**, janë parashikuar:

**Rezultatet e arritshme:**

i. Rritja e fluksit të investimeve nga 7.6 në 9% të PBB-së;

ii. Rritja e totalit të eksportit të mallrave dhe shërbimeve nga 31.5% në 36% të PBB-së;

iii. Rritja e vlerësimit në Indeksin e Politikave për NVM-të (integrimi i NVM-ve në zinxhirin e vlerave globale) nga 1.1 në 3.1.

| Masa: | Treguesit: |
|---|---|
| Promovimi/lehtësimi sistematik i investimeve të synuara | - 7 fushata specifike të targetimit për grupet e synuara<br>- 51 projekte tërheqëse të investimeve<br>- 127,500 mijë euro volumi i investimeve<br>- krijimi i 15,300 vende pune të reja |
| Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme | - 300 klientë të *after-care* (investitorët ekzistues)<br>- 20 memorandume mirëkuptimi të nënshkruara me bashki/partnerë<br>- 160 projekte të riinvestimit<br>- 320,000 mijë EUR vëllimi i riinvestimit<br>- 16,000 vende pune të krijuara nga investitorët ekzistues |
| Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve | - finalizimi i vlerësimit, udhëzuesit të reformës dhe konceptit të zhvillimit (deri në vitin 2022)<br>- 30 ha tokë e zhvilluar/20 ha e përdorur nga investitorët në zonën e zgjedhur<br>- 20 rezident aktivë në zonën e zgjedhur<br>- 3,000 vende pune të reja të krijuara në zonën e zgjedhur |
| Programi i zhvillimit të ofruesve | - pjesëmarrje e 30 investitorëve deri më 2027<br>- pjesëmarrje e 150 bizneseve lokale deri më 2027<br>- lehtësimi i nënkontratave me vlerë 75 milionë euro deri më 2027 |
| Strategjia e eksportit | - Strategjia e eksportit e zhvilluar deri në vitin 2022 |
| Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik | - 300 biznese përfituese (2022-2024)<br>- 75 zgjidhje për biznesin elektronik/tregtinë elektronike të miratuara nga përfituesit<br>- 15% rritje në eksportet e bizneseve përfituesve |

**Objektivi specifik I.2. "Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni"**, janë parashikuar:

**Rezultatet e arritshme:**

I. Rritja e dendësisë së *startup*-eve nga 88 në 132 (*startup*-e për një milionë banorë)

II. Rritja e vlerësimit në Indeksin e Konkurrueshmërisë Globale (aftësitë inovative) nga 29.8 në 34

III. Rritja e vlerësimit në Indeksin e Politikave për NVM-të (shërbimet mbështetëse për NVM-të) nga 3.6 në 4.4

| **Masa:** | **Treguesit:** |
|---|---|
| Skema e mbështetjes së sipërmarrjes së bazuar në konkurrencë | - 360 NMVM që marrin pjesë në CoSolve-19<br>- 150 pjesëmarrës në trajnime çdo vit (të paktën 40% femra)<br>- 30 grante çdo vit (të paktën 40% ndaj grave |
| Forcimi i ekosistemit të *startup*-eve | - funksionimi i Agjencisë së *startup*-eve<br>- regjistruar 375 biznese *startup* inovative<br>- shkalla e mbijetesës prej 65% pas 5 vitesh<br>- 3,000 vende pune të krijuara nga bizneset *startup* |
| Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të *startup*-eve | - 30 biznese *startup* shqiptare dhe 25 mentorë të diasporës që marrin pjesë<br>- 12 organizata mbështetëse shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare<br>- 25 biznese *startup* shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare |
| Nisma për ngritjen e zinxhirit të vlerës së bazuar në konkurrencë | - 40 aplikime/20 konsorciume të zgjedhura për fazën e konceptit më 2022<br>- 10 konsorciume të mbështetura në fazën e zbatimit 2023-2024<br>- 15% rritje në të ardhurat e NVM-ve pjesëmarrëse në vitet 2023 dhe 2027<br>- 50 vende të reja pune të krijuara nga përfituesit deri më 2023 dhe 2027 |
| Rritja e aksesit në financë | - 60 përfitues të Fondit të Zhvillimit të NVM-ve çdo vit (2022-2027)<br>- 30% përfitues e sipërmarrëse gra/biznese të drejtuara nga gratë (2022-2027)<br>- 180 vende pune të reja të krijuara nga përfituesit e Fondit çdo vit (2022-2027)<br>- hartuar një kornizë ligjore dhe nënligjore për NVM-të (deri më 2021)<br>- VKM për skemën e garancisë shtetërore e hartuar (deri në vitin 2023)<br>- hartuar korniza ligjore për financimin e investimeve *crowdfunding*<br>- krijimi i një rrjeti të engjëjve të biznesit |
| Programi i aftësive të ndërmarrjeve për NVM-të | - 12 trajnime çdo vit.<br>- 300 pjesëmarrës në trajnime çdo vit. |

**Objektivi specifik I.3. "Zhvillimi i kapitalit njerëzor"**, janë parashikuar:

**Rezultatet e arritshme:**

I. Rritje e PBB-së për person të punësuar nga 34,600 në 37,000 (në vitin 2017, PPP konstante në $)

II. Rritje e përqindjes së punësimeve në profesione që kërkojnë njohuri të thelluara nga 17.5% në 19.5%

III. Rritje e vlerësimit në Indeksin e Politikave për NVM-të (aftësitë sipërmarrëse) nga 4.3 në 3.9

| Masa: | Treguesit: |
|---|---|
| Skema e mbështetjes për zhvillimin bashkëpunues të kapitalit njerëzor | - 150 përfitues (të paktën 40% gra)<br>- 100 NVM që punësojnë studentë dhe kandidatë PhD |
| Programi i zhvillimit të forcës së punës për dhe me NVM-të dhe investitorët | - 20 memorandume mirëkuptimi me partnerët<br>- 10 investitorë/NVM të mbështetur çdo vit (2021-2023),<br>- 25 investitorë/NVM të mbështetur çdo vit (2024-2027)<br>- 40 pjesëmarrës në trajnime çdo vit (2021-2023),<br>- 175 pjesëmarrës çdo vit (2024-2027) |
| Sistemi i parashikimit të nevojave të aftësive | - Sistemi i parashikimit i zhvilluar/implementuar (deri në vitin 2022)<br>- 3 raporte parashikimi |
| Vlerësime të rregullta të nevojave për trajnim | - 1 vlerësim i nevojave për trajnim çdo vit<br>- 250 SME të asistuara çdo vit. |

III. PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

**Përgjegjësia e institucioneve**

Për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021–2027, do të angazhohen një tërësi institucionesh, duke filluar nga ministritë e linjës, institucionet e varësisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, akademia, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Strategjia përcakton Ministrinë përgjegjëse për ekonominë si institucionin përgjegjës kryesor të raportimit për progresin e saj edhe pse pjesa më e madhe e veprimtarive do të kërkojë bashkëpunim ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe akademinë. Institucionet përgjegjëse për çdo masë sipas objektivave specifikë dhe fushave të politikës janë të përcaktuara në aneksin 1 të këtij dokumenti.

**Llogaridhënia, monitorimi dhe raportimi**

**Llogaridhënia**

Kuadri monitorues do të ushqejë orientimin e politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e burimeve të vendit. Ai do të furnizojë me raporte monitoruese dhe vlerësuese Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), për sektorin e biznesit dhe të investimeve, në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, të cilat monitorojnë reformat sektoriale në Shqipëri në përputhje me prioritetet e qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), procesin e anëtarësimit në BE dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Përqasja dhe rishikimi i dokumentit strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM-së nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS”.

**Monitorimi**

Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit do të paraqitet në mënyrë periodike edhe në GMIP/KDS për "Konkurrueshmërinë dhe investimet". *Ministrisa përgjegjëse për ekonominë* do të udhëzojë dhe mbështesë, gjithashtu, organizatat e biznesit dhe organet e vetëqeverisjes vendore në zbërthimin e Planit të Veprimit në plane të zbatueshme në nivelin vendor, e në mënyrë të veçantë në përgatitjen e planeve përkatëse në përputhje dhe me parimet e aktit të biznesit të vogël (*Small Business Act*).

Gjatë punës së përditshme, përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit qëndron te nëpunëset/nëpunësit e nxitjes së biznesit dhe investimeve dhe strukturat vendore të politikave mbështetëse për zhvillimin e biznesit dhe investimeve.

Ministria përgjegjëse për ekonominë ka rol koordinues dhe raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit vjetor. Organizatat e shoqërisë civile luajnë, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin rreth problemeve në zbatimin dhe në mbështetjen e proceseve të mbledhjes së të dhënave, ofrimit të shërbimeve dhe zbatimit të legjislacionit e politikave në tërësi për avancimin drejt nxitjes së biznesit.

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky dokument konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tij me qëllim përmbushjen e objektivave në mënyrë sa më efektive.

Më konkretisht do të ndërmerren këto masa:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;
- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe rreziqet si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e raporteve vjetore të Komisionit Evropian për Shqipërinë, konkluzionet e përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë dhe dokumenteve të tjera ndërkombëtare;
- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- monitorimi do të kryhet bazuar në raporte vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioriteteve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikat e vendit të lidhura me avancimin drejt zhvillimit të biznesit dhe investimeve.

**Vlerësimi**

Për shkak të kohëzgjatjes shtatëvjeçare të zbatimit të strategjisë dhe përputhjes së saj me OZHQ-të, është menduar që përveç monitorimeve vjetore të zbatimit të kësaj strategjie, të ketë edhe një proces vlerësimi të përgjithshëm në vitin e katërt të zbatimit të saj. Bazuar mbi këtë vlerësim mund të ndryshohen/hiqen (nëse janë realizuar plotësisht) dhe shtohen jo vetëm veprime e masa, por edhe objektiva specifikë nën qëllimet strategjike bazë të dokumentit.

**Raportimi**

Të gjitha institucionet e ngarkuara me zbatimin e SBZHI 2021–2027 do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe njëvjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në këtë strategji dhe të zbërthyera në planin e saj të veprimit, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

*Ministria përgjegjëse për ekonominë* do të jetë institucioni udhëheqës, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6-mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatin Teknik Ndërinstitucional.

ANEKS NR. 14
*(Shtuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

**Objektiv:**

- Plotësimi i pozicioneve vakante në strukturat përgjegjëse për politikën industriale dhe mbështetjen e NVM-ve (MEI dhe AIDA), bazuar në afate të detajuara kohore, për të siguruar mbulimin e funksioneve të reja të planifikuara në këtë strategji.
- Zbatimi i një programi trajnimesh për strukturën e ngarkuar për politikat industriale dhe NMVM-të, përmes instrumenteve të asistencës teknike (si TAIEX etj).

Sipas vlerësimit institucional dhe administrativ të kapitullit 20 (IAGA), struktura aktuale e MEI-t përfshin Drejtorinë e Analizës së Strategjive Ekonomike (10 punonjës) dhe Drejtorinë e Simulimit dhe Vëzhgimit (7 punonjës), në Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Analizës Ekonomike, si dhe 31 punonjës në tri drejtori të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave për Zhvillimin Ekonomik, Promovimin e Biznesit dhe Tregtisë. IAGA-ja identifikon si boshllëqe kryesore nivelin e ulët të bashkërendimit të brendshëm dhe ndërinstitucional, si dhe burimet e pamjaftueshme për mbështetjen e konkurrueshmërisë industriale, gjetje që kjo masë synon t'i adresojë drejtpërdrejt. Iniciativa synon që ky plan kapacitetesh të mbështesë zbatimin e koordinuar të të gjitha masave mbështetëse për industrinë dhe NVM-të (ekosistemet prioritare (*Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), Energjia e pastër, eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmi*), IHD, instrumentet financiare, reziliencën (qëndrueshmërinë), tranzicioni i gjelbër/digjital), në lidhje me planin e veprimit dhe mekanizmin e vetëm ndërinstitucional, pa dublikuar planet ekzistuese të kapaciteteve në strategji.

Për të garantuar zbatimin efektiv të politikave të reja industriale, strategjia parashikon hartimin e një plani gjithëpërfshirës për forcimin e kapaciteteve institucionale. Ky proces përfshin vlerësimin dhe plotësimin e vakancave në strukturat përgjegjëse, me një objektiv ambicioz për të arritur 80% të stafit deri në vitin 2027 dhe 100% deri në vitin 2028. Për të siguruar forcimin e kapaciteteve, do të implementohet një program disavjeçar trajnimi në fusha si politikat industriale të Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore, mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit, si dhe menaxhimi i fondeve të Bashkimit Evropian.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| Kryerja e një vlerësimi të nevojave për trajnim (TNA), sipas rekomandimit të vlerësimit institucional dhe administrativ të kapitullit 20 (IAGA), si bazë për hartimin e programit të trajnimeve. | T1–T2 2026 | MEI, AIDA, DAP |
| Funksionimi i sekretariatit teknik dhe përditësimi i përshkrimeve të punës | 2026–2027 | MEI, DAP |

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| Vlerësimi i vakancave dhe miratimi i planit të plotësimit (numra, afate, buxhet) | T1–T2 2026 | MEI, AIDA, DAP |
| Programi disavjeçar i trajnimeve (TAIEX/*twinning*/SIGMA) | 2026–2030 | MEI, DAP |
| Plotësimi i vendeve vakante në Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Analizës Ekonomike dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave për Zhvillimin Ekonomik, sipas boshllëqeve të identifikuara nga IAGA | 2026–2030 | MEI, DAP |

**Lidhur me operacionalizimin e Mekanizmit të vetëm ndërinstitucional, strategjia do të synojë:**

- krijimin e një mekanizmi të vetëm bashkërendues për monitorimin e strategjisë në bashkëpunim me përfaqësuesit e industrisë dhe NVM-të;
- implementimin e një arkitekture administrative të qartë, të mbështetur nga një sekretariat teknik permanent, që siguron ndjekjen e një kalendari aktivitetesh, përmbushjen e produkteve dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale;
- publikimin e raportit vjetor mbi ecurinë e strategjisë;
- forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe koordinuese të Sekretariatit Teknik (aktualisht Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MEI) dhe përditësimi i përbërjes institucionale të grupit ndërinstitucional të ngritur me urdhrin nr. 214, datë 13.12.2023, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027 dhe planit të saj të veprimit", në përputhje me riorganizimin e strukturës qeveritare dhe funksionet e reja të kësaj strategjie.

Monitorimi i strategjive kombëtare shpesh përballet me sfida që lidhen me fragmentimin e të dhënave dhe mungesën e një koordinimi të ngushtë ndërinstitucional. Masa synon të adresojë këtë sfidë, duke e shndërruar monitorimin e strategjisë nga një detyrim administrativ në një Sistem të Inteligjencës Ekonomike. Pjesa kryesore e kësaj reforme është krijimi i grupit ndërministror të punës, një mekanizëm i nivelit të lartë që do të kryesohet nga zëvendësministri përgjegjës për ekonominë në MEI. Ky komitet nuk do të jetë thjesht një forum diskutimi, por një qendër vendimmarrjeje, që bashkon përfaqësuesit më të lartë të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Mjedisit dhe AIDA-s, së bashku me përfaqësues të sektorit privat dhe akademisë. Ky mekanizëm shërben si struktura koordinuese qendrore për të gjitha masat mbështetëse të reja (ekosistemet prioritare (Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), energjia e pastër, metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmi), IHD, instrumentet financiare, rritja e kapaciteteve, rezilienca (qëndrueshmëria) e zinxhirëve të furnizimit, tranzicioni i gjelbër dhe digjital), duke garantuar zbatimin e njësuar të planit të veprimit të BIDS pa dublikime institucionale. Strategjia njeh dhe formalizon rolin strategjik të rrjetit diplomatik në shërbim të zhvillimit ekonomik. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) në zbatimin e BIDS 2030 përfshihet si institucion bashkëpunues në mekanizmin ndërministror të koordinimit dhe në masat që lidhen me tërheqjen e investimeve të huaja direkte, ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve shqiptare dhe promovimin e eksporteve në tregjet e huaja. Roli i MEPJ-së është konceptuar si promovues, lehtësues dhe ndërlidhës nëpërmjet diplomacisë ekonomike (misioneve diplomatike dhe pikave të kontaktit jashtë vendit), duke mbështetur AIDA-n dhe MEI-n në identifikimin e tregjeve potenciale dhe lidhjen e bizneseve shqiptare me rrjetet ndërkombëtare. Ky rol ushtrohet brenda mandatit zyrtar të MEPJ-së, pa i

ngarkuar kësaj ministrie përgjegjësi direkte zbatuese sektoriale apo detyrime financiare buxhetore, të cilat mbeten përgjegjësi e institucioneve zbatuese.

Gjithashtu, sipas vlerësimit institucional dhe administrativ të kapitullit 20 (IAGA), rekomandohet që qeverisja e përhershme e Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3) të integrohet dhe formalizohet brenda grupit ndërinstitucional ekzistues (urdhri nr. 214, datë 13.12.2023, i Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2021-2027 dhe planit të saj të veprimit"), dhe që ky i fundit të harmonizohet me IPMG-në për konkurrueshmërinë dhe Investimet, në përputhje me qasjen gjithë-qeveritare të rekomanduar nga IAGA, për të shmangur krijimin e strukturave paralele apo dokumenteve të reja të pakoordinuara.

Strategjia synon gjithashtu në krijimin e sekretariatit teknik, i cili do të jetë si një "Njësi e Analizës dhe Monitorimit të Politikave". Ky sekretariat nuk do të mjaftohet me hartimin e raporteve vjetore, por do të shërbejë si qendra kryesore analitike e strategjisë. Përmes integrimit të të dhënave nga burime të ndryshme (dogana, QKB, tatime etj.), Sekretariati do të gjenerojë analiza parashikuese mbi ecurinë e masave dhe raportime mbi zbatimin e tyre. Ky sistem monitorimi do të ngrihet përmes rishikimit të urdhrit nr. 214, datë 13.12.2023, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2021–2027 dhe planit të saj të veprimit", brenda vitit 2027.

**Aktivitetet:**

| Aktiviteti | Afati | Institucionet |
|---|---|---|
| 1. Projekturdhri i Kryeministrit për përditësimin e urdhrit nr. 214, datë 13.12.2023, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2021-2027 dhe planit të saj të veprimit" (përbërja institucionale sipas strukturës së re qeveritare - MEI) dhe forcimin e mandatit të grupit ndërinstitucional ekzistues | T4 2026 – T1 2027 | MEI (Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik), Kryeministria |
| 2. Forcimi i kapaciteteve të sekretariatit teknik (staf shtesë dhe trajnim i dedikuar) dhe riaktivizimi/rregullimi i mbledhjeve periodike të grupit ndërinstitucional sipas urdhrit nr. 214, datë 13.12.2023, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2021–2027 dhe planit të saj të veprimit", | 2026–2027 | MEI |
| 3. Raportimi: gjashtëmujor te kabineti i KM + raporti vjetor publik + GMIP/IPSIS | Nga 2027 | Sekretariati, të gjitha institucionet përgjegjëse |

## IV. PJESA IV: ANALIZA BUXHETORE

### 1.1 Analiza e buxhetit për zbatimin e SZHBI 2021–2027

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen e kostove indikative dhe burimeve financiare që financojnë masat e Strategjisë të Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027. Efektet financiare janë përllogaritur për çdo masë bazuar në aktivitetet që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të zbatimit të kësaj strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet

respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e një pjesë të masave.

Kostimi i Strategjisë është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikës së planifikimit buxhetor, me qëllim përcaktimin e kostos shtesë për zbatimin e Strategjisë dhe hendekut financiar në raport me fondet buxhetore të planifikuara në PBA 2021–2023, në Programin Buxhetor 04130 "Mbështetje për zhvillim ekonomik", dhe nga financimi i donatorëve. Përllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS-ja, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse. Kostot buxhetore të Strategjisë janë të planifikuara në Programin Buxhetor 04130 "Mbështetje për zhvillim ekonomik", në të cilin përfshihet edhe institucioni i AIDA-s për implementimin e aktiviteteve përkatëse të Strategjisë.

Procesi i kostimit është mbështetur në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu Programi Buxhetor Afatmesëm 2021–2023 dhe propozimet sipas tavaneve të reja në kuadër të hartimit të PBA 2022–2024, si dhe konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira, si dhe kostot historike nga zbatimi i strategjisë pararendëse. Plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë.

Kostoja e përgjithshme, e përllogaritur për zbatimin e SBZHI 2021–2027, është **9,605,535,640 lekë** ose **78,093,786 euro**. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 123 lekë për 1 euro. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 7 viteve të zbatimit të SZHBI 2021–2027.

| Qëllimi I Politikës | Tipologjia e kostos | Kostoja Totale 2021-2027 | Kostot e Planifikuara PBA 2021-2027 Buxheti dhe Donatoret | Hendeku Financiar 2021-2037 |
|---|---|---|---|---|
| **P1 Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës.** | Korente | 9,605,251,360 | 8,914,680,908 | ***690,570,452*** |
| | Kapitale | 284,280 | 284,280 | |
| **TOTALI [Leke]** | | **9,605,535,640** | **8,914,965,188** | ***690,570,452*** |
| **TOTALI [Euro]** | | **78,093,786** | **72,479,392** | ***5,614,394*** |
| ***1 euro 123 Leke*** | | | | |

Financimi i planit të veprimit të zbatimit të kësaj Strategjie do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit, fondet e NJVV-së dhe mbështetja financiare e donatorëve mbeten burimet kryesore. Për periudhën 2021–2027, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 71% të financimit të nevojshëm, 22% pritet të financohet nga donator të huaj, ndërsa 7% është hendek financiar.




Kostot korente zënë thuajse 100% të shpenzimeve totale.

Strategjia do të rishikohet pas 4 vitesh (në vitin 2025) për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform nevojave dhe programeve buxhetore afatmesme 2026–2027, të çdo institucioni.

Fondet buxhetore, të cilat përbëjnë kryesisht 71% të kostimit të strategjisë për përbëhet nga:

- Skema e garancisë shtetërore për manifakturën;
- Grantet vjetore për SME-të;
- Krijimi i Agjencisë përgjegjëse për *startup*;
- Krijimi i një sektori trajnimi pranë AIDA;

- Shtimi me 2 specialistë të zinxhirit të vlerës tek AIDA;
- Fonde për ofrimin e trajnimeve nga AIDA;
- Financimi i huaj, i cili përbën 22 % të kostimit të strategjisë përbëhet nga:
- Komisioni Evropian nëpërmjet Projektit të IPA II "EU for Innovation" dhe projektit të IPA III "*EU for innovation*" *second phase*.

Në vitin 2021–2022 Projekti i IPA II "EU for Innovation" do të financojë aktivitete që lidhen me:

- Vitin 2021, kostot e zbatimit të projektit në shumën 2.81 mln euro (i detajuar në 2,392,690 euro mbështetje teknike, si edhe grant për *startup*-et dhe organizatat e inovacionit në Shqipëri në shumën 425,000 euro);
- Në vitin 2022, kostoja e zbatimit është rreth 236,000 euro, e cila lidhet me mbështetjen teknike (trajnime, *matchmaking events* etj.).
- IPA III "*EU for innovation*" *second phase*. Ky propozim nga *Ministria përgjegjëse për ekonominë* vjen si rezultat i nevojës për të vijuar me mbështetjen e fazës së dytë të projektit "*EU for innovation*" – faza e parë, financuar nga fondet e IPA II. Bazuar në kërkesat e Komisionit Evropian për IPA III, KKIPA ka koordinuar procesin e indentifikimit me përfituesit potencialë (institucionet qendrore), e më tej ka vijuar me përcjelljen e 53 fishave të veprimit për mbështetje nga IPA 2021 e 2022 në shtator 2020, të cilat kaluan fazën e relevancës strategjike deri në muajin dhjetor 2020. Një nga propozimet që kaluan këtë fazë dhe për të cilën u hartua edhe Dokumenti Përkatës i Veprimit (AD) është "*EU for Innovation*" - *phase 2*, me kosto indikative *10 milionë euro* – potenciale për t'u financuar nga programi IPA 2021. Aktualisht AD-ja, e hartuar nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në *Ministrinë përgjegjëse për ekonominë*, është objekt i një vlerësimi final nga Komisioni Evropian dhe priten komentet përkatëse. Projekti "*EU for Innovation*" *– second Phase*, është parashikuar të zbatohet për periudhën 2023–2026 (periudhë katërvjeçare). Alokimi i shumave për periudhën referuese, në tabelën e kostimit është bërë në mënyrë të barabartë për çdo vit (2.5 mln euro).

Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në *Ministrinë përgjegjëse për ekonominë*, më 15 shkurt 2021, hartoi dhe dërgoi Dokumentin e Veprimit/*Action Document* (AD) nëpërmjet MEPJ-së dhe Delegacionit të Komisionit Evropian,

- Projekti i Qeverisë Gjermane ProSEED.

Projekti i PROSEED-it, që prej shkurtit të vitit 2021, po zbaton Instrumentin Këshillimor që ofron *trajnime dhe shërbime këshillimi* për NMVM-të, me mundësi edhe për të marrë grante të vogla, me qëllim për tu përshtatur në situatën e krijuar nga COVID-19. Instrumenti këshillimor me titullin "CoSolve 19" është një iniciativë e përbashkët e programeve dypalëshe të bashkëpunimit gjermano-shqiptar për zhvillim: "Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, promovimi i punësimit edukimi dhe trajnimi profesional" (ProSEED) dhe zhvillimi i qëndrueshëm rural (SRD). Qëllimi i këtij instrumenti është mbështetja e NMVM-ve të prekura rëndë nga pasojat e krizës së COVID-19 në Shqipëri, për të ruajtur punësimin dhe pse jo edhe për ta rritur atë. Në realizimin e kësaj iniciative, ProSEED dhe SRD synojnë të japin një kontribut të rëndësishëm për NMVM-të në Shqipëri në sektorët e bujqësisë, turizmit, apo sektorë të tjerë. Projekti do të zbatohet për periudhën 2021–2022 në shumën gjithsej 534.9 mln lekë. Në strategji kostimi i këtij fondi është ndarë në mënyrë të barabartë për vitin 2021 dhe 2022 respektivisht 267.45 mln lekë.

**- Banka Botërore**

Banka Botërore do të asistojë AIDA me asistencë teknike për realizmin e masës 1.6 "Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik", e cila do të përqendrohet në:

- Fushata ndërgjegjësuese të organizuara nga AIDA-s për të inkurajuar më shumë NVMM për të filluar tregtinë elektronike;
- Publikimi në faqen e internetit të AIDA-s i mjetit digjital të vetëvlerësimit për NVM-të;
- Publikimi në faqen e internetit të AIDA-s i një udhëzuesi se si të ndihmohen NVM-të që të fillojnë tregtinë elektronike;
- Trajnime mbi tregtisë elektronike të ofruara nga AIDA për të ndihmuar NVM-të të fillojnë tregtinë elektronike;
- Partnerët tanë për zhvillim janë të mirëpritur për të kontribuar në realizimin e aktiviteteve të përcaktuara për këtë masë.
- BERZH

BERZH-i ka asistuar *Ministria përgjegjëse për ekonominë* dhe AIDA në krijimin e një portali elektronik për aksesin në financë të SME-ve, projekti i cili do të mbështetë gjatë gjithë vitit 2021.

Masat për të cilat kërkohet mbështetja e partnerëve tanë për zhvillim, në masën 7% të kostimit, janë:
- Promovimi /lehtësimi sistematik i investimeve të synuara;
- Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve;
- Programi i zhvillimit të ofruesve;
- Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të *startup*-eve;
- Nisma për përmirësimin e zinxhirit të vlerave me bazë konkurrencën;
- Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues;
- Program për zhvillimin e fuqisë punëtore për dhe me NVM-të dhe investitorët;
- Sistemi i parashikimit të nevojave për aftësi.

Në fazën e hartimit të draftstrategjisë, gjatë takimeve të zhvilluara më përfaqësues të Ministrisë së Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik në Gjermani, në periudhën 12–23 prill, më 2021 u organizua një mision për vlerësimin e nevojave për mbështetje nëpërmjet programit të PROSEED 2. Në datën 11 maj, misioni prezantoi në *Ministrinë përgjegjëse për ekonominë* se rezultatet kryesore do të jenë si vijon:
- Përmirësimi i ofertës me fuqi punëtore të kualifikuar;
- Përmirësimi i aftësisë konkurruese të NMVM-ve dhe kapacitetin e tyre për krijimin e vendeve të punës;
- Integrimin e digjitalizimit dhe ekonomisë gjelbër.

**- Fusha e ndërhyrjes 1: Arsimi dhe aftësimi profesional**

Outputi: Përmirësimi i ofertës të punës së kualifikuar

Masat e mbështetjes:

1. Mbështetje për arsimin dhe aftësimit profesional;
2. Trajnimin e personelit dhe forcimin e kapaciteteve të arsimit dhe aftësimit profesional;
3. Zbatimi i "*digital road map*";
4. Projekt pilot për zhvillimin e aftësive në sektorët "*green*".

**- Zona e ndërhyrjes 2: Zhvillimi i sektorit privat**

Outputi: Përmirësimi i biznesit dhe sistemit të mbështetjes për NVMM-të, duke marrë parasysh transformimin digjital dhe elementet e biznesit të gjelbër.

Masat e mbështetjes:

1. Zbatimi i disa aktiviteteve të Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, si p.sh.: programi i ofruesve të furnizimit, tërheqja e investimeve (AIDA) 2021–2027;
2. Forcimin e shërbimeve mbështetëse për biznesin, duke përdorur trajnerët dhe rrjetin e këshilluesve;
3. Digjitalizimin e proceseve të biznesit të NMVM-ve (në biznes dhe në menaxhim);

4. Fushata ndërgjegjësimi për digjitalizimin dhe ekonominë e gjelbër.

**- Fusha e ndërhyrjes 3: Mbështetja për zhvillimin e politikave**

Outputi: Mbështetja e *Ministrisë përgjegjëse për ekonominë*, AKPA-së dhe AIDA-s në fushat e zgjedhura të politikave për të përmirësuar politikat për krijimin e vendeve të punës dhe punësimit

Masat e mbështetjes:

1. Analizë sektoriale për arsimin dhe aftësimin profesional;
2. Mbështetje për monitorimin e SZHBI 2021–2027;
3. Mbështetje për zhvillimin e politikave në digjitalizim dhe ekonominë e gjelbër.

ANEKS NR. 15

**FORMATI I PLANIT TË VEPRIMIT, I PËRMBLEDHUR**

*(Ndryshuar me VKM nr. 501, datë 10.9.2025; rinumërtuar dhe ndryshuar me VKM nr. 616, datë 30.7.2026)*

| |
|---|
| **PLANI I VEPRIMIT NË ZBATIM TË DOKUMENTIT STRATEGJIK (2021–2030)** |
| **I. QËLLIMI STRATEGJIK:** "Një ekonomi shqiptare konkurruese, e nxitur nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe më cilësore, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron transformimi digjital dhe transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, me theksin mbi zhvillimin e qëndrueshëm, integrimin evropian dhe atë rajonal" |
| **II. QËLLIMI I POLITIKËS:** Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës |
| **III. PROGRAMI BUXHETOR:** Programi buxhetor i MEI 04130 "Mbështetje për zhvillimin ekonomik" |

| **Nr.** | **Objektivi specifik, produkti, Masa** | **Produkti** | **Institucionet përgjegjëse** | | **Afati i zbatimit** | | **Totali 2021–2030** | | | | **Komente** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | **Kostoja indikative** | **Burimi i financimit** | | **Hendeku financiar** | |
| | | | **Institucioni udhëheqës** | **Institucion kontribues** | **Afati i fillimit** | **Afati i mbarimit** | | **Buxheti i shtetit Programi 04130 "Mbështetje për zhvillimin ekonomik"** | **Financimi i huaj** | | |
| **1.1** | Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi | - Rritja e fluksit të investimeve nga 7.6 në9% të PBB-së;<br>- Rritja e totalit të eksportit të mallrave dhe shërbimeve nga 31.5% në 36% të PBB-së;<br>- Rritja e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (integrimi iNVM-ve në zinxhirin e vlerave globale) nga 1.1 në 3.1. | AIDA | Ministri përgjegjëspër ekonominë,MEPJ, MIE, MTM, MBZHR, BDHTI dhe shoqatat e biznesit | TM1-2021 | TM4-2027 | 152,706,415 | 66,882,383 | 1,601,100 | (84,222,932) | Ishte |
| **1.1** | Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi | - Rritja e fluksit të investimeve nga 7.6 në 9% të PBB-së;<br>- Rritja e totalit të eksportit të mallrave dhe shërbimeve | Ministri përgjegjëspër ekonominë | AIDA, ministritë e linjës dhe shoqatat e biznesit | 2026 | 2030 | 322,850,604 | 230,323,706 | 63,126,334 | (29,400,564) | Bëhet |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nga 31.5% në 36% të PBB-së;<br>- Rritja e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (integrimi iNVM-ve në zinxhirin e vlerave globale) nga 1.1 në 3.1. | | | | | | | | | |
| **1.1.1** | Promovimi/lehtësimi sistematik i investimeve të synuara | - 7 fushata specifike të targetimit për grupet e synuara;<br>- 51 projekte tërheqësetë investimeve;<br>- 127,500 mijë euro volumi i investimeve;<br>- Krijimi i 15,300 vendeve pune të reja. | AIDA | Ministri përgjegjëspër ekonominë,MEPJ, MIE, MTM, MBZHR, BDHTI dheshoqatat e biznesit | TM1-2021 | TM4-2027 | 30,824,970 | 16,301,130 | - | (14,523,840) | Ishte |
| **1.1.1** | Promovimi/lehtësimi sistematik i investimeve të synuara | - 7 fushata specifike të targetimit për grupet e synuara;<br>- 51 projekte tërheqësetë investimeve;<br>- 127,500 mijë euro volumi i investimeve;<br>- Krijimi i 15,300 vendeve pune të reja. | AIDA | Ministri përgjegjëspër ekonominë,MEPJ, MIE, MTM, MBZHR, BDHTI dheshoqatat e biznesit | TM1-2026 | TM4 2030 | 28,698,780 | 14,174,940 | - | (14,523,840) | Bëhet |
| **1.1.2** | Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme | - 300 klientë të *after-care* (investitorët ekzistues);<br>- 20 memorandume mirëkuptimi të nënshkruara me bashki/partner;<br>- 160 projekte të riinvestimit;<br>-320,000 mijë EUR vëllimi i riinvestimit;<br>- 16,000 vende pune të krijuara nga investitorët ekzistues. | AIDA | AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë, bashkitë, dhomatdhe shoqatat etregtisë | TM1-2022 | TM4-2027 | - | - | - | - | Masë ekzistuese |
| **1.1.3** | Vlerësimi dhe reforma eprogramit të TEDA-ve | - Finalizimi i vlerësimit, udhëzuesit të reformës dhe konceptit të zhvillimit (deri në vitin 2022);<br>- 30 ha tokë e zhvilluar/20 ha e përdorur nga | Ministri përgjegjës përekonominë | Ministri përgjegjëspër ekonominë, Korporata Shqiptare e Investimeve | Vlerësimi dhe koncepti i zhvillimit (2021) zbatimi | Vlerësimi dhe koncepti i zhvillimit 2022) zbatimi | 11,876,724 | - | - | (11,876,724) | Masë ekzistuese |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | investitorët në zonën e zgjedhur;<br>- 20 rezident aktivë në zonën e zgjedhur;<br>- 3,000 vende pune të reja, të krijuara në zonën e zgjedhur. | | | dhe koncepti i zhvillimit (2022 | dhe koncepti i zhvillimit (2027) | | | | | |
| | Programi i zhvillimit të ofruesve | - Pjesëmarrje e 30 investitorëve deri në2027;<br>- Pjesëmarrje e 150 bizneseve lokale deri më 2027;<br>- Lehtësimi i nënkontratave me vlerë75 milionë euro deri më2027. | AIDA | AIDA, ministripërgjegjës për ekonominë | Faza pilot (2021) zbatimi i programit (faza pilot (2023) | Faza pilot (2024) zbatimi i programit (2027) | 62,013,581 | 7,261,253 | - | (54,752,328) | Masë e hequr (në rishikimin e 2025) |
| **1.1.4** | Programi i ekonomisë qarkulluese industriale dhe parqet ekoindustriale | - Riorientimi i 30% të mbetjeve industriale nga landfilli drejt riciklimit deri në vitin 2029, me synim final prej ≥ 50%;<br>- Rritja e nivelit të ujit industrial të ricikluar në ndërmarrjet e asistuara TCLF në 20% deri në vitin 2029, me synim final prej ≥ 40%;<br>- Zbatimi i protokolleve qarkulluese ose planeve të gjelbra në 15 NVM deri në vitin 2028, me synim final prej 40 NVM;<br>- Arritja e një përqindjeje prej 30% të ndërmarrjeve në parqet pilot sipas standardeve EIP deri në vitin 2028, me synim final prej 60%. | Ministri përgjegjës përekonominë | Korporata Shqiptare e Investimeve, AIDA | TM1-2026 | TM4-2030 | 46,908,000 | - | 46,908,000 | - | Masë e re |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.1.5** | Përgatitja e industrisë për tregun e gjelbër në tregun e përbashkët (MRV, Gatishmëria CBAM dhe eficienca e energjisë në prodhim) | - Ndërmarrje industriale dhe eksportuese të mbështetura për zbatimin e kërkesave MRVA dhe gatishmëri CBAM: Vlera bazë prej 0 në vitin 2025, me një synim të ndërmjetëm prej 25 ndërmarrjesh deri në vitin 2028, duke synuar një objektiv final prej 60 ndërmarrjesh deri në vitin 2030;<br>- Kapaciteti i ri i vetëprodhimit nga burimet e rinovueshme të energjisë (BRE) i ndërmarrjeve (MW): Vlera bazë do të përcaktohet nga ERE në vitin 2026; synimet e ndërmjetme do të vendosen sipas pasaportës përkatëse të projektit, ndërsa objekti final i vitit 2030 do të përcaktohet në koordinim me MIE/ERE;<br>- Intensiteti energjetik i industrisë përpunuese: Vlera bazë e monitoruar përmes INSTAT/Eurostat (2025), duke synuar një reduktim prej -5% deri në vitin 2028 (synimi i ndërmjetëm) dhe një reduktim final prej -10% deri në vitin 2030. | Ministria e Mjedisit | Ministria e Mjedisit, MEI, MIE, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia e Eficiencës së Energjisë, Enti Rregullator i Energjisë. | TM1-2026 | TM4-2030 | - | - | - | - | Masë e re |
| **1.1.6** | Standardet, certifikimi dhe gatishmëria për tregun e vetëm (me modul ndërkombëtarizimi) | - Certifikimi CE/ISO i fituar nga 25% e ndërmarrje përmes programit deri në vitin 2028, me synim final prej 50% e ndërmarrjeve kumulative;<br>- rritja e eksporteve drejt | Ministri përgjegjës përekonominë | Komiteti Ndërministror për Integrimin Ekonomik të Sipërmarrjes, Ekipi Kombëtar për hartimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të programit. | TM4-2026 | TM4-2030 | 144,840,000 | 144,840,000 | - | - | Masë e re |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Bashkimit Evropian për ndërmarrjet e mbështetura me +10% deri në vitin 2028, me synim final prej +25%.<br>- | | | | | | | | | |
| **1.1.7** | Iniciativa e zhvillimit tëbiznesit elektronik | - 300 biznese përfituese (2022–2024);<br>- 75 zgjidhje për biznesin elektronik/tregtinë elektronike të miratuaranga përfituesit;<br>- 15% rritje në eksportet e biznesevepërfituesve. | Ministri përgjegjës përekonominë | Ministri përgjegjëspër ekonominë,AIDA | TM2-2022 | TM3-2024 | 47,801,100 | 43,200,000 | 1,601,100 | (3,000,000) | Masë ekzistuese |
| **1.1.8** | Digjitalizimi industrial dhe aksesi në AI/EuroHPC | - Integrimi i zgjidhjeve digjitale/AI në 35 NVM prodhuese përmes skemës deri në vitin 2028, me synim final prej 90 NVM-sh kumulative;<br>- Shfrytëzimi i 200,000 *core hours* të kapacitetit EuroHPC deri në vitin 2028, me synim final prej 1,000,000 *core hours* kumulative;<br>- Arritja e rritjes së produktivitetit në ndërmarrjet e mbështetura 24 muaj pas ndërhyrjes, me një synim final prej ≥ 30% duke filluar nga matja e parë në vitin 2029. | Ministri përgjegjës përekonominë | AKSHI, DIU | TM4-2026 | TM4-2030 | 37,200,000 | 22,582,766 | 14,617,234 | - | Masë e re |
| **1.1.9** | Vlerësimi i modelit të diplomacisë ekonomike | Vlerësimi i modelit ekzistues të diplomacisë ekonomike dhe identifikimi i opsioneve të reformës në periudhën 2025–2027 | MEPJ | Ministri përgjegjës për ekonominë, AIDA | TM4-2026 | TM4-2030 | 5,538,000 | 5,538,000 | - | - | Masë ekzistuese |
| **1.1.10** | 1.1.10 Lehtësimi i veprimtarisë industriale ndërkufitare dhe logjistika | - Reduktimi i kohës mesatare të kalimit kufitar (TRS) me 15% deri në vitin 2028, me synim final prej -30%; | Ministri përgjegjës për ekonominë | DPT, AIDA | TM2-2026 | TM4-2030 | - | - | - | - | Masë e re |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | - Rritja e numrit të operatorëve me status AEO me +50% deri në vitin 2028, me synim final dyfishimin e numrit aktual;<br>- Përpunimi digjital i 50% të dokumentacionit tregtar deri në vitin 2028, me synim final prej ≥ 80%. | | | | | | | | | |
| **1.1.11** | Rezilienca (qëndrueshmëria) e zinxhirëve të furnizimit dhe diversifikimi i inputeve | - Reduktimi i indeksit të përqendrimit të importeve për inputet kritike me 5% deri në vitin 2028, me synim final prej -10%;<br>- Diversifikimi i furnizimit me mbështetje për 30 ndërmarrje kumulative deri në vitin 2028, me synim final prej 80 ndërmarrjesh kumulative. | Ministri përgjegjës për ekonominë | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AIDA, DPD, INSTAT, DPT | TM4-2026 | TM4-2030 | - | - | - | - | Masë e re |
| **1.1.12** | Përditësimi i ligjit të investimeve dhe thjeshtimi i procedurave për projektet industriale | Miratim brenda 2027 i projekligjit<br>Zbatimi i ligjit | Ministri përgjegjës për ekonominë | AIDA, ministritë e linjës | TM4-2027 | TM4-2030 | - | - | - | - | Masë e re |
| **1.2** | Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni | 100% pas hyrjes në fuqi | 100% | Ministri përgjegjëspër ekonominë,MIE, MTM, MZHBR, Agjencia "*Innovation4Albania*", ministri i Shtetitpër Mbrojtjen eSipërmarrjes, inkubatorët, përshpejtuesit dheorganizatat e mbështetjes sëmëtejshme | TM2-2021 | TM4-2027 | 9,271,689,226 | 6,699,318,082 | 2,147,163,624 | (425,207,520) | Ishte |
| **1.2** | Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni | ≥ 15 mln EUR (2028) | ≥ 50 mln EUR kum. | AIDA,MIE, Ministria e Mjedisit,MZHBR, Agjencia "*Innovation4Albania*", inkubatorët, përshpejtuesit dheorganizatat e mbështetjes së biznesit. | 2026 | 2030 | 6,468,034,366 | 5,534,341,342 | 40,135,008 | (893,558,016) | Bëhet |
| **1.2.1** | Skema për | - 360 NMVM që marrin | AIDA | AIDA, ministri | TM1- | TM4- | 675,601,114 | 140,698,714 | 534,902,400 | - | Masë e |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | mbështetjen e sipërmarrjes me bazëkonkurrencën | pjesë në CoSolve-19;<br>- 150 pjesëmarrës në trajnime çdo vit (të paktën 40% femra);<br>- 30 grante çdo vit (të paktën 40% ndaj grave). | | përgjegjës për ekonominë | 2021 | 2025 | | | | | përfunduar |
| **1.2.2** | Lidhja mes NMVM-ve dhe *startup*-eve | - Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese me *startup*-e dhe biznese NMVM në periudhën 2025–2027. | AIDA dhe Agjencia "*Innovation4Albania*" | Ministri përgjegjës për ekonominë | 2025 | 2030 | 5, 760, 000 | 5, 760, 000 | - | - | Masë ekzistuese |
| **1.2.3** | Fuqizimi i ekosistemit të *startup*-eve | - Funksionimi i Agjencisë së *startup*-eve;<br>- Regjistruar 375 biznese *startup* inovative;<br>- Shkalla e mbijetesësprej 65% pas 5 vjetësh 3,000 vende pune të krijuara nga bizneset *startup.* | Ministri përgjegjës përekonominë | Agjencia "*Innovation4Albania*", ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, inkubatorët, përshpejtuesit dheorganizatat e mbështetjes së mëtejshme | TM1-2021 | TM4-2027 | 1,663,476,624 | 59,802,624 | 1,603,674,000 | - | Masë e përfunduar |
| **1.2.4** | Aksesi në programet e Bashkimit Evropian në fushën e biznesit | - Mbështetje për NMVM-të dhe bizneset *startup* për të marrë pjesë në programet e Bashkimit Evropian (Programin e Tregut të Përbashkët 2021–2027). | AIDA dhe Agjencia "*Innovation4Albania*" | AIDA | 2025 | 2027 | 36,516,000 | - | 36,516,000 | - | Masë ekzistuese |
| **1.2.5** | Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të *startup*-eve | - 30 biznese *startup* shqiptare dhe 25 mentorë të diasporës qëmarrin pjesë;<br>- 12 organizata mbështetëse shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare<br>- 25 biznese *startup;*<br>- shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare. | Ministri përgjegjës përekonominë | Ministri përgjegjëspër ekonominë, AIDA, Agjencia e Diasporës dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia "*Innovation4Albania*" | 2025 | 2030 | 47,577,024 | - | 3,619,008 | (43,958,016) | Masë ekzistuese |
| **1.2.6** | Nisma për përmirësimin e zinxhirit të vlerave me bazë konkurrencën | - 40 aplikime/20 konsorciume të zgjedhura për fazën ekonceptit më 2022<br>10 konsorciume të mbështetura në fazën e zbatimit 2023–2024; | AKKSHI | AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë, MASR etj. dhe organizata të tjera mbështetëse | TM1-2022 | TM4-2024 | 367,200,000 | - | - | (367,200,000) | Masë ekzistuese |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | - 15% rritje në të ardhurat e NVM-ve pjesëmarrëse në vitet2023 dhe 2027;<br>- 50 vende të reja punetë krijuara nga përfituesit deri në 2023dhe 2027. | | | | | | | | | |
| **1.2.7** | Transferimi i teknologjisë, qeverisja e S3 dhe kapaciteti absorbues | - Ndërmarrje që përdorin shërbimet e zgjerimit/transferimit/DIH: 0 (2025) \| 80 kum. (2028) \| 200 kum;<br>- Pjesa e ndërmarrjeve industriale me veprimtari inovacioni: 41.6% (2024) \| 45% (2028) \| ≥ 50%;<br>- Projekte industri–kërkim të bashkëfinancuara: 0 (2025) \| 15 kum. (2028) \| 40 kum. | Ministri përgjegjës përekonominë | Agjencia *"Innovation4Albania"*, AKKSHI, akademia dhe shoqatat e biznesit. | 2026 | 2030 | 24,000,000 | 24,000,000 | - | - | Masë e re |
| **1.2.8** | Rritje e aksesit në financëpër NMVM-të | - 60 përfitues të Fondittë Zhvillimit të NVM- ve çdo vit (2022–2027);<br>- 30% përfitues e sipërmarrëse gra /biznese të drejtuara nga gratë (2022–2027);<br>- 180 vende pune të rejatë krijuara nga përfituesit e Fondit çdovit (2022–2027);<br>- Hartuar një kornizë ligjore dhe nënligjore për NVM-të (deri në 2021);<br>- VKM për skemën e garancisë shtetërore ehartuar (deri në vitin 2023);<br>- Hartuar korniza ligjorepër financimin e investimeve *crowdfunding;*<br>- Krijimi i një rrjeti të engjëjve të biznesit. | Ministri përgjegjës përekonominë | AIDA | TM1-2026 | TM4-2030 | 449,441,100 | 449,441,100 | - | - | Masë ekzistuese |
| **1.2.9** | Instrumente financiare për | - Investime private të mobilizuara përmes | Ministri përgjegjës përekonominë | AIDA | TM1-2026 | TM4-2030 | 5,024,000,002 | 5,024,000,002 | - | - | Masë e re |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | modernizimin dhe përshtatjen e ndërmarrjeve | instrumenteve: 0 EUR (2025) \| ≥ 15 mln EUR kum. (2028) \| ≥ 50 mln EUR kum;<br>- Ndërmarrje prodhuese me hua të garantuara për modernizim: 0 (2025) \| 45 kum. (2028) \| 110 kum. | | | | | | | | | |
| **1.2.10** | Program për aftësitë sipërmarrëse për NVM-të | - 12 trajnime çdo vit;<br>- 300 pjesëmarrës në trajnime çdo vit. | AIDA | Ministri përgjegjëspër ekonominë,AKPA, BDHTI dhe shoqatat ebiznesit | TM1-2022 | TM4-2030 | 31,140,240 | 31,140,240 | - | - | Masë ekzistuese |
| **1.2.11** | Krijimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit (FSHI): Instrumenti Sovran i Bashkinvestimit për Rritjen e Konkurrueshmërisë dhe Ndërmarrjet me Rritje të Lartë (*Scale-Up*) | - Fondi i krijuar ligjërisht (2027). | MEI | Ministria e Financave, Agjencia "*Innovation4Albania*",, AMF | 2027 | 2030 | 482,400,000 | - | - | 482,400,000 | Masë e re |
| **1.2.12** | Mjedisi rregullator për NVM-të: SME Test dhe pagesat e vonuara | - Akte të reja me ndikim mbi industrinë/NVM-të me SME Test: 0% (2025) \| 50% (2027) \| 100%;<br>- Përafrimi me Direktivën 2011/7/BE: Tabela (2026) \| Ligji i miratuar (2027) \| Zbatim i monitoruar;<br>- Koha mesatare e pagesës B2B në sektorët prodhues: Pyetësori 2026 \| -10% (2029) \| -20%. | Ministri përgjegjës për ekonominë | AIDA, ministritë e linjës, BDHTI<br>dhe shoqatat e biznesit | TM1-2022 | TM4-2030 | - | - | - | - | Masë e re |
| **1.2.13** | Programi kombëtar i zhvillimit të klasterave industriale dhe integrimi në zinxhirët e IHD-ve | - Gjenerimi i vlerës së kontratave të reja të furnizimit NVM–IHD prej ≥ 5 milionë EUR (kumulative) deri në vitin 2028, me synim final prej ≥ 25 milionë EUR (kumulative);<br>- Certifikimi i 25 NVM-ve me status "gatishmëri furnizimi" në laboratorët e | Ministri përgjegjës përekonominë | AIDA | TM1-2026 | TM4-2030 | 7,309,210 | 7,309,210 | - | - | Masë e re |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përbashkët deri në vitin 2028, me synim final prej 90 NVM;<br>- Formalizimi i 3 klasterave me menaxhim sipas ECEI deri në vitin 2028 (prej të cilëve 1 me Bronze Label), me synim final prej ≥ 5 klasterash, nga të cilët ≥ 3 të vetëfinancuar;<br>- Regjistrimi i 3 klasterave në ECCP deri në vitin 2028, me synim final prej ≥ 5 klasterash të regjistruar dhe ≥ 2 në ESCP-S3. | | | | | | | | | |
| **1.3** | Zhvillimi i kapitalit njerëzor | - Rritje e PBB-së për person të punësuar nga34,600 në 37,000 (në vitin 2017, PPPkonstante në $);<br>- Rritje e përqindjes së punësimeve në profesione që kërkojnënjohuri të thelluara nga17.5% në 19.5%;<br>- Rritje e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (aftësitë sipërmarrëse) nga 4.3 në 3.9. | Ministri përgjegjës përekonominë | AIDA, MASR,AKKSHI | TM1-2021 | TM4-2027 | 181,140,000 | 37,700,000 | - | (142,440,000) | Ishte |
| **1.3** | Zhvillimi i kapitalit njerëzor | - Rritje e PBB-së për person të punësuar nga34,600 në 37,000 (në vitin 2017, PPP konstante në $);<br>- Rritje e përqindjes së punësimeve në profesione që kërkojnënjohuri të thelluara nga17.5% në 19.5%;<br>- Rritje e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (aftësitë | Ministri përgjegjës përekonominë | AIDA, AKPA, AKAFP, MASR,AKKSHI | 2026 | 2030 | 98,640,000 | 98,640,000 | - | (98,640,000) | Bëhet |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sipërmarrëse) nga 4.3;<br>- në 3.9. | | | | | | | | | |
| | Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues | - 150 përfitues (tëpaktën 40% gra);<br>- 100 NVM që punësojnë talente përtej kohëzgjatjes së mbështetjes. | AIDA | Ministri përgjegjëspër ekonominë, MASR, AKKSHI | TM2-2023 | TM4-2027 | 108,000,000 | - | - | (108,000,000) | Ishte |
| **1.3.1** | Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues | - 150 përfitues (të paktën 40% gra)<br>- 100 NVM që<br>- punësojnë talente përtej kohëzgjatjes së mbështetjes | AIDA | Ministri përgjegjëspër ekonominë, MASR, AKKSHI | TM2-2026 | TM4-2030 | 86,640,000 | - | - | (86,640,000) | Bëhet |
| **1.3.2** | Program për zhvillimin e fuqisë punëtore për dhe me NVM-të dhe investitorët | - 20 memorandume mirëkuptimi me partnerët;<br>- 10 investitorë/NVMtë mbështetur çdo vit (2021–2023), 25 investitorë/NVM të mbështetur çdo vit (2024–2027);<br>- 40 pjesëmarrës në trajnime çdo vit (2021–2023), 175 pjesëmarrës<br>çdo vit (2024–2027). | AIDA | Ministri përgjegjës për ekonominë, MEPJ, AKPA, bashkitë, qendrat e formimit, dhomat dhe shoqatat e tregtisë | TM4-2021 | TM4-2027 | 60,900,000 | - | - | (60,900,000 ) | Masë e hequr |
| **1.3.3** | Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në reformat e sistemit të VET-es | - Ndërgjegjësimi dhe përfshirja e bizneseve në prezantimin e modelit të VET-ës në periudhën 2025–2027. | Ministri përgjegjës për poltikat e punësimit | Ministri përgjegjës për ekonominë | 2026 | 2027 | - | - | - | - | Masë ekzistuese |
| **1.3.4** | Sistemi i parashikimit të nevojave për aftësi | - Sistemi i parashikimit i zhvilluar/implementuar (deri në vitin 2022);<br>- 3 raporte parashikimi. | AKPA | AKAFPK,<br>ministri përgjegjëspër ekonominë, MASR, BDHTI dhe shoqatat e biznesit, sektoriprivat | TM3-2021 | TM4-2027 | 12,240,000 | - | - | (12,240,000) | Masë ekzistuese |
| **1.3.5** | Vlerësim periodik i nevojave për trajnim | - 1 vlerësim i nevojavepër trajnim çdo vit;<br>- 250 SME të asistuara çdo vit. | AIDA | AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë, AKPA, BDHTI<br>dhe shoqatat ebiznesit. | TM4-2021 | TM-2027 | - | - | - | - | Masë ekzistuese |
| **1.3.6** | Paketa kombëtare e aftësive të gjelbra dhe digjitale në industri (*Green &* | - Punonjës të trajnuar në aftësi të gjelbra/Digjitale (≥40% gra): 0 (2025) \| 1,000 kum. (2028) \| 3,000 kum; | MEI | AKPA, AIDA, akademia, shoqatat e biznesit | TM4-2026 | TM-2030 | - | - | - | - | Masë e re |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Digital Upskilling*) | - Ndërmarrje që raportojnë vështirësi në gjetjen e aftësive: Matja 2026 \| -10 pp (2028) \| -20 pp;<br>- Kurrikula të modernizuara për profilet e ekosistemeve: 0 (2025) \| 5 (2028) \| 10. | | | | | | | | | |